

Doracak për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2024

Botimi i dytë i plotësuar



Doracak për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2024

Botimi i dytë i plotësuar

Impressum

Titulli:

Doracak për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2024
Botimi i dytë i plotësuar

Botues :

Daniel Braun, Përfaqësues zyrtar i Fondacionit Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë së Veriut
Marko Troshanovski, Kryetar i Institutit për demokraci „Societas Civilis“ – Shkup

Autorë:

Joana Treneska
Tome Smilevski
Gjorgji Haxhi Vasilev
Ana Sofeska

Bashkërendimi:

Davor Pasoski, Menaxher programi, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Disejni dhe përgatitja:

Vinsent Grafika DOO Shkup

Publikimi mund të merret falas në:

www.izbornaarhiva.mk
<https://www.kas.de/en/web/nordmazedonien/home>
<http://www.idscs.org.mk>

I shprehim mirënjohje Programit për mbështetjen zgjedhore të bashkëpunimit Zviceran në Maqedoninë e Veriut, të zbatuar nga Fondacioni ndërkombëtar për sisteme zgjedhore (IFES), për mbështetjen dhe bashkëpunimin në përgatitjen e këtij publikimi.

Vërejtje:

Fondacioni Konrad Adenauer dhe Instituti për Demokraci “Societas Civilis” - Shkup nuk janë përgjegjës për faktet dhe pikëpamjet e shprehura në publikim. Ato përfaqësojnë pikëpamjet personale të autorit.
Ky publikim është vetëm për qëllime informative dhe informacioni në të nuk mund të përdoret në fushatat zgjedhore.

Përmbajtja

Hyrje në zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut 5

Përgatitjet për zgjedhjet parlamentare.....	17
Ndryshimet e fundit në legjislacionin zgjedhor	20
Komisioni shtetëror i zgjedhjeve.....	21
Financimi i partive politike.....	22
Mediat publike.....	23

1. Historiku i zgjedhjeve parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut (1990 - 2020) 25

2. Sistemi zgjedhor maqedonas për zgjedhjet parlamentare 33

3. Njësitë zgjedhore 41

4. Pasqyrë e pjesëmarrësve në zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2020 49

Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë dhe koalicioni „Për të ardhmen evropiane“ ...	52
VMRO-DPMNE dhe koalicioni “Maqedonia Jote”.....	57
Bashkimi Demokratik për Integrim dhe koalicioni „Fronti evropian“	62
Coalition “Vredi”	66
Partia politike E majta - Levica.....	70
Avaja – Mjaft më!.....	73
Partia politike Demokratët.....	73
Partia politike E djathta.....	74
Partia politike Maqedonia e Bashkuar.....	75
Lëvizja ZNAM (E di) – Për Maqedoninë Tonë.....	75
Era e tretë Maqedonase / Listat e Pavarura Maqedonase – Sovranët.....	76
Opsioni i reformës së rindërtimit të Maqedonisë – Partia e punës.....	77
Partia politike Alternativa e Re	77
Partia politike Rodina Maqedoni.. ..	78
Partia Jote	79
Opsioni qytetar për Maqedoninë dhe koalicioni „Trimërisht për Maqedoninë“	79
Grup zgjedhësish Gjyla Çeliku.....	80

**5. Zgjedhjet parlamentare në Republika e Maqedonisë së Veriut 2024 -
Rezultatet, fushata, vlerësime** **81**

Hyrje.....	83
Fushata zgjedhore.....	85
Financimi i fushatës zgjedhore.....	91
Mediat.....	94
Rezultatet e zgjedhjeve të rregullta parlamentare në 2024.....	101
Mbrojtja e të drejtës zgjedhore.....	105
Vlerësimi i zgjedhjeve nga vëzhguesit.....	107
Vlerësimi i zgjedhjeve nga partitë politike.....	113
Konkluzione.....	117

**6. Arkivi zgjedhor i zgjedhjeve në Republikën Maqedonisë së Veriut
nga viti 1990 e deri më sot** **125**

Hyrje

Hyrje në zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Zgjedhjet parlamentare, të njëmbëdhjeta me radhë, në Republikën e Maqedonisë së Veriut do të mbahen më 8 maj të vitit 2024. Zgjedhjet parlamentare u shpallën me datë 14.2.2024, kur kryetari i Kuvendit, Jovan Mitrevski, në pajtim me detyrimet kushtetuese dhe ligjore, e nënshkroi vendimin për shpalljen e zgjedhjeve për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.¹ Sipas vendimit, zgjedhjet e rregullta parlamentare do të mbahen më 8 maj 2024 (e mërkurë), njëkohësisht me rrethin e dytë të mundshëm të zgjedhjeve presidenciale, që domethënë se do të hasen përputhje të fushatave parazgjedhore për zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale. Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut zgjidhen 120 deputetë sipas modelit proporcional, me ç' rast territori i vendit është i ndarë në gjashtë njësi zgjedhore të përcaktuara me Kodin zgjedhor dhe në secilën zgjidhen nga 20 deputetë.²

Më 14 shkurt, KSHZ e miratoi kalendarin e afateve për kryerjen e veprimeve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.³ Sipas parashikimeve ligjore, qeveria teknike për zbatimin e zgjedhjeve u zgjodh më 28 janar të këtij viti, 100 ditë para zgjedhjeve.⁴

Pas disa muaj përplasjesh politike lidhur me miratimin e ndryshimeve kushtetuese dhe kërkesave të intensifikuara të opozitës për zgjedhje të jashtëzakonshme parlamentare, marrëveshja politike për mbajtjen e zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare u arrit më 4 dhjetor të vitit 2023 në takimin e liderëve të partive politike të përfaqësuara në Kuvend. Partitë politike arritën marrëveshje me konsensus të gjerë që zgjedhjet parlamentare të mbahen më 8 maj (e mërkurë), së bashku me

1 Vendim përshpalljen e zgjedhjeve <https://drive.google.com/file/d/1XP6jrSKDr-BVIDuMAwCjQBGak88qbx2g/view> (vizita e fundit 07.04.2024)

2 Kodi zgjedhor parashikon se mund të zgjidhen deri në 123 deputetë, me atë që tre deputetë plotësues mund të zgjidhen nga qytetarët maqedonas të cilët janë në punë të përkohshme ose në qëndrim jashtë kufijve të vendit (votimi i diasporës), në qoftë se kandidatët e fitojnë numrin e nevojshëm të votave. Meqë numri i personave të paraqitur për votim jashtë kufijve shtetërorë për zgjedhjet parlamentare në vitin 2024 (2.605) është më i vogël se pragu i votave të nevojshme për t'u fituar mandati (5.355), votimi jashtë shtetit nuk do të organizohet për këto zgjedhje, me çka parlamenti në mandatin e ardhëm do të ketë 120 deputetë.

3 Afati i kalendarit për kryerjen e veprimeve zgjedhore https://drive.google.com/file/d/1yt9v5sJARjR2_FqqebBM6xv7Ucuwze5w/view (vizita e fundit 07.04.2024)

4 Zgjedhjet janë shpallur – kandidatët janë ende „të fshehtë“ <https://www.dw.com/mk/jovan-mitreski-gi-raspisa-izborite-i-povika-na-fer-i-demokratski-izboren-proces/a-68254138> (vizita e fundit 07.04.2024)

rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale. Paraprakisht, më 24 prill, gjithashtu të mërkurën, do të mbahet rrethi i parë i zgjedhjeve presidenciale. Data 8 maj u zgjodh për t'u mundësuar që zgjedhjet parlamentare të mbahen në terminin e tyre të rregullt, ndërsa presidencialet të përfundojnë deri në mbarimin e mandatit të kryetarit të tanishëm, Stevo Pendarovski, më 12 maj.

Përveç datave të zgjedhjeve, liderët e LSDM-së, Dimitar Kovaçevski, dhe VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickovski, theksuan se në takimin e liderëve ka pasur konsensus të gjerë për pranimin e vërejtjeve për Kodin zgjedhor nga OSBE/ODIHR. Në takimin e liderëve nuk u arrit marrëveshja për ndryshimet kushtetuese.⁵

Sipas ligjit, më 28 janar, gjegjësisht 100 ditë para zgjedhjeve, u formua qeveria teknike (e a.sh. Qevria e Përzhinos). Kryeministri, Dimitar Kovaçevski, dhe kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi, më 25 janar i dorëzuan dorëheqjet. Koordinatorin e grupit të deputetëve të LSDM-së, Jovan Mitrevski, më 26 janar u zgjodh kryetar i ri i Kuvendit maqedonas. Për zgjedhjen e tij votuan 65 deputetë, ndërsa 40 ishin kundër.⁶

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut më 28 janar me 65 vota „pro“ dhe tre „kundër“ votoi qeverinë teknike në krye me kryeministrin e parë shqiptar, Talat Xhaferi, nga BDI.⁷ Kryeministri Talat Xhaferi theksoi se nuk do të ndryshohet politika tashmë e etabluar e Qeverisë aktuale, si në planin e brendshëm, ashtu edhe në atë të jashtëm dhe theksoi se nuk do të lejohet cenimi i procesit zgjedhor.⁸ Lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, theksoi se bëhet fjalë për një ditë historike, ndërsa BDI-ja zgjedhjen e kremtuan me kollare të kuqe në të cilat shkruan kryeministër – shqiptar – 28.01.2024.⁹

Detyra kryesore e kësaj qeverie është që të organizojë zgjedhje parlamentare korrekte dhe demokratike. Partia më e madhe opozitare VMRO-DPMNE, edhe pse i propozoi kandidatët e vet në Qeveri, nuk votoi për zgjedhjen e saj, sepse nuk ishte e pajtimit që Qeverinë ta udhëheqë Talat Xhaferi. Sipas përvojës së deritashme me

5 U arrit marrëveshje për zgjedhjet: Më 24 prill presidenciale, ndërsa më 8 maj parlamentare me rreth të dytë presidenciale <https://360stepeni.mk/postignat-dogovor-za-izborite-na-24-april-pretседателски-a-na-8-maj-parlamentarni-so-vtor-krug-pretседателски/> (vizita e fundit 07.04.2024 година)

6 Jovan Mitreski është kryetar i ri i kuvendit maqedonas <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32793109.html> - (vizita e fundit 07.04.2024)

7 U zgjodh qeveria teknike në krye me Xhaferin <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32795231.html> (vizita e fundit 07.04.2024)

8 Xhaferi: Politika tashmë e etabluar e qeverisë nuk do të ndryshohet <https://makfax.com.mk/makedonija/%D1%9F%D0%B0%D1%84%D0%B5%D1%80%D0%B8-%D0%B7%D0%B0%D1%86%D1%80%D1%82%D0%B0%D0%BD%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%BF%D0%BE%D0%BB%D0%B8%D1%82%D0%B8-%D0%BA%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%B4%D0%BE%D1%81%D0%B5%D0%B3%D0%B0/> (vizita e fundit 07.04.2024)

9 BDI e kremton zgjedhjen e Xhaferit për kryeministër teknik me kollare të kuqe <https://360stepeni.mk/dui-go-slavi-izborot-na-dhaferi-za-tehnicki-premier-so-tsaveni-vratovrski/> (vizita e fundit 07.04.2024)

qeveritë teknike, ky manovër politik ndodh për herë të dytë duke pasur parasysh se në vitin 2016 LSDM-ja, edhe pse i propozoi ministrat, e lëshoi seancën dhe nuk votoi për Qeverinë teknike të udhëhequr nga Emill Dimitriev nga VMRO-DPMNE.¹⁰

Në qeverinë teknike zv/kryeministër i parë dhe zv/kryeministër për çështje evropiane është zgjedhur Bojan Mariçiq, i cili vjen në vendin e Artan Grubit, i cili mbetet të jetë ministër i sistemit politik dhe marrëdhënieve ndërmjet bashkësive.

Opozitës i takuan vendet ministrore në Ministrinë e punëve të brendshme dhe në Ministrinë e punës dhe politikës sociale, si dhe pozitat zëvendësministrore plotësuese në Ministrinë e financave, Ministrinë e shoqërisë informatike dhe administratës dhe Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave. Nga radhët e VMRO-DPMNE-së në këto vende u zgjodhën Pançe Toshkovski, ministër teknik i punëve të brendshme dhe Gjoko Vellkovski, ministër i punës dhe politikës sociale. Zëvendësministrat shtesë u zgjodhën Elena Petrova për financa, Stefan Andonovski për shoqëri informatike dhe administratë dhe Cvetan Tripunovski për bujqësi, pylltari dhe ekonomi të ujërave.¹¹

Pas mosmarrëveshjeve në Aleancën për Shqiptarët (AA), për shkak të kandidaturës presidenciale të Arben Taravarit dhe bashkëngjijtes së krahut të Taravarit në opozitën e bashkuar shqiptare „Vlen“, me propozimin e kryeministrit teknik Talat Xhaferi, më 9 shkurt u shkarkuan ministrat e shëndetësisë dhe shoqërisë informatike dhe administratës Fatmir Mexhiti dhe Azir Aliu¹², e më parë në seancën qeveritare u shkarkuan edhe drejtorët e krahut të Taravarit.

Krahu i udhëhequr nga Ziadin Sela më 28 mars vendosi në zgjedhjet e ardhme t'i bashkëngjitet „Frontit evropian“ të udhëhequr nga BDI. Lidhur me kontestin juridik se kush është kryetar legjitim i partisë, Gjykata në Tetovë mori vendim që vulat e partisë Aleanca për Shqiptarët t'i jepen krahut të Ziadin Selës, për të cilën gjë Arban Taravari njoftoi se do të parashtojë ankesë kundër këtij vendimi.¹³

Kryeministri Xhaferi dhe ministrat në qeverinë teknike, do të mbajnë postet edhe pas zgjedhjeve më 8 maj, deri në formimin e qeverisë së re. Mandati i zëvendësmin-

10 Në vitin 2016 LSDM nuk votoi për Qeverinë teknike <https://alsat.mk/mk/vo-2016-godina-sdsm-ne-glasashe-za-tehnickkata-vlada/> (vizita e fundit 07.04.2024)

11 Kuvendi i Maqedonisë së Veriut e zgjodhi Qeverinë kalimtare që do ta udhëheqë Talat Xhaferi <https://vlada.mk/node/35835> (vizita e fundit 07.04.2024)

12 U shkarkuan ministrat Mexhiti dhe Aliu <https://sdk.mk/index.php/makedonija/razresheni-ministrите-medhiti-i-aliu/> (vizita e fundit 07.04.2024)

13 Gjyqi në Tetovë ka vendosur që Sela t'i marrë vulat e Aleancës për Shqiptarët, Taravari paralajmëron ankesë <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32888402.html> (vizita e fundit 07.04.2024)

istrave plotësues mbaron me shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve. Qeveria e udhëhequr nga Talat Xhaferi është qeveria e tretë teknike, pas qeverisë së Emill Dimitrievit në vitin 2016 dhe Oliver Spasovskit në vitin 2020.

Periudha para arritjes së marrëveshjes politike për mbajtjen e zgjedhjeve u shënuar me polarizimin politik ndërmjet pushtetit dhe opozitës lidhur me miratimin e ndryshimeve kushtetuese me qëllim të vazhdimin të proceseve eurointegruese të shtetit, por edhe me kërkesat e vazhdueshme të opozitës për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme. Opozitarja VMRO-DPMNE mbajti qëndrimin se nuk do të votojë për ndryshimet kushtetuese, duke theksuar se kur do të vijë në pushtet do të sigurojë marrëveshje më të mirë me Bullgarinë.

Në kontekstin e zgjedhjeve, në janar të vitit 2022, VMRO-DMNE-ja vepronte ndryshe me kërkesën e saj për shfuqizimin e konceptit „Qeveria e Përzahinos“. Partia opozitare shprehu gatishmëri për të hequr dorë nga 100 ditët e qeverisë teknike me qëllim të mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme dhe grupi parlamentar i VMRO-DMNE-së inicio propozim ndryshime për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Qeveri. Shumica qeveritare vazhdimisht i refuzonte kërkesat për zgjedhje të parakohshme parlamentare, ndërsa koalicioni qeveritar kontestoi mënyrën e propozimit të kësaj zgjidhjeje me anë të kushtëzimit për zgjedhje parlamentare. Koordinator i atëherëshëm i grupit parlamentar të LSDM-së, Jovan Mitreski, theksoi se për shfuqizimin e Qeverisë teknike nevojitet pëlqimi i të gjitha partive politike, e jo vetëm nga një parti dhe bëri thirrje për marrëveshje politike për zgjedhje të rregullta. Në BDI vlerësuan se nuk është mirë që në mënyrë të njëanshme të propozohet zgjidhja për shfuqizimin e Qeverisë teknike, por për një zgjidhje të këtillë nevojitet konsensus i gjerë, siç ishte rasti i sjelljes së saj, gjegjësisht nënshkrimin të marrëveshjes së Përzahinos në vitin 2015.¹⁴ Propozimi i VMRO-DPMNE-së për shfuqizimin e qeverisë teknike në 100 ditë para zgjedhjeve, e njohur si Qeveria e Përzahinos, nuk u miratua në Kuvend.¹⁵

Kryeministri Kovačevski në mars të vitit 2023 theksoi se zgjedhjet do të mbahen në terminin e rregullt në vitin 2024 dhe ishte i vendosur se do të respektohet marrëveshja e koalicionit që e arritën kryeministri i mëparshëm Zoran Zaev dhe lideri

14 VMRO-DPMNE kërkon që të shfuqizohet Qeveria e Përzahinos dhe zgjedhje të parakohshme, LSDM dhe BDI thonë se kjo gjë do të dakordohet para zgjedhjeve në vitin 2024 <https://sdk.mk/index.php/makedonija/vmro-dpmne-bara-da-se-ukine-przhinskata-vlada-i-predvremeni-izbori-sdsm-i-dui-velat-deka-toa-ke-se-dogovori-pred-izborite-vo-2024-godina/> (vizita e fundit më 07.04.2024)

15 Propozimi i VMRO-DPMNE-së për shfuqizimin e Qeverisë së Përzahinos nuk kaloi në Kuvend https://sdk.mk.translate.google/index.php/makedonija/predlogot-na-vmro-dpmne-za-ukinuvane-na-przhinskata-vlada-ne-pomina-vo-sobranieto/?_x_tr_sl=mk&_x_tr_tl=en&_x_tr_hl=en&_x_tr_pto=sc (vizita e fundit më 07.04.2024)

i BDI-së Ali Ahmeti në vitin 2020 për kryeministrin e parë shqiptar si kryeministër teknik në 100 ditët e fundit të mandatit të Qeverisë aktuale.¹⁶

Për arritjen e marrëveshjes lidhur me këto tema të rëndësishme politike, Kryetarët e LSDM-së dhe VMRO-DPMNE-së, Dimitar Kovaçevski dhe Hristijan Mickovski, më 6 qershor të vitit 2023 mbajtën takim liderësh, i cili mbaroi pa marrëveshje konkrete.¹⁷

Lidhur me ndryshimet kushtetuese, Kovaçevski në takimin e liderëve propozoi që të votohen bashkërisht, e në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare të përmendet se do të vlejné pas Konferencës së dytë ndërqeveritare me BE-në, përdërisa Mickovski kërkoi që ndryshimet kushtetuese të vlejné në përfundimin e procesit të negociatave me BE-në, gjegjësisht kur do të fillojë ratifikimi në vendet anëtare të BE-së.

Për t'u siguruar shumica e nevojshme e dy të tretave, kryeministri Kovaçevski propozoi koalicionin e gjerë në të cilin do të hynin të gjitha partitë të cilat janë për integrimin evropian të vendit. Kovaçevski doli me propozim konkret që në Qeveri të hyjë edhe VMRO-DPMNE, ndërsa LSDM t'ua lëshojë 5 vende ministore, pasi që të votohet hapja e Kushtetutës me shumicë prej dy të tretave.¹⁸ Mickovski theksoi se hyrja eventuale në koalicionin e gjerë qeveritar do të ishte e pranueshme për VMRO-DPMNE-në, por BDI-ja të mos jetë pjesë e Qeverisë së këtyllë.

Lidhur me zgjedhjet e parakohshme parlamentare, Kovaçevski propozoi mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme pas votimit të ndryshimeve kushtetuese dhe hapjes së dy-tre kapitujve të negociatave për anëtarësim në BE, përdërisa Mickovski theksoi se ndryshimet kushtetuese nuk mund të kalojnë në këtë përbërje parlamentare dhe kërkoi shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme në afat sa më të shkurtër të mundshëm.¹⁹

16 Kovaçevski kundër qeverisë teknike dhe zgjedhjeve të parakohshme <https://www.dw.com/mk/kovacevski-protiv-tehnicka-vlada-i-predvremeni-izbori-mickovski-samo-za-izbori/a-65011414> (vizita e fundit më 07.04.2024)

17 Takim liderësh Kovaçevski- Mickovski, propozime ka, marrëveshje nuk ka <https://www.slobodnaevropa.mk/a/%D0%BB%D0%B8%D0%B4%D0%B5%D1%80%D1%81%D0%BA%D0%B8-%D1%81%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%B1%D0%B8---%D1%80%D0%B5%D1%88%D0%B5%D0%BD%D0%B8%D0%B5%D0%B8%D0%BB%D0%B8-%D0%B2%D0%BB%D0%B5%D0%B7-%D0%B2%D0%BE-%D1%9C%D0%BE%D1%80%D1%81%D0%BE%D0%BA%D0%B0%D0%BA/32445902.html> (përqasja e fundit më 07.04.2024)

18 Deri në ndryshimet kushtetuese me një qeveri pa BDI-në? <https://www.dw.com/mk/liderska-sredba-siroka-vlada-bez-dui-pet-ministri-za-vmrodpmne-garancii-od-eu/a-65847609> vizita e fundit më 09.04.2024)

19 Qeveri e gjerë për ndryshime kushtetuese pa BDI? <https://www.slobodnaevropa.mk/a/%D1%88%D0%B8%D1%80%D0%BE%D0%BA%D0%B0-%D0%B2%D0%BB%D0%B0%D0%B4%D0%B0-%D0%B7%D0%B0-%D1%83%D1%81%D1%82%D0%B0%D0%B2%D0%BD%D0%B8-%D0%B8%D0%B7%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D0%B8-%D0%B1%D0%B5%D0%B7-%D0%B4%D1%83%D0%B8-/32448927.html> (vizita e fundit më 07.04.2024)

Pas mbledhjes së liderëve vazhduan mosmarrëveshjet politike mes pushtetit dhe opozitës lidhur me temat kryesore politike të takimit të liderëve. Për këto arsye, lideri VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickovski, më 8 korrik 2023 theksoi se i tërheqin të gjitha ofertat për arritjen e konsensusit me pushtetin rreth ndryshimeve kushtetuese dhe se do të bisedojnë vetëm për zgjedhjet e parakohshme. Në LSDM njoftuan se në dy javët e ardhme amendamentet kushtetuese do të shqyrtohen nga qeveria, do të shpallen publikisht dhe do të dorëzohen në Kuvend, për të cilën gjë do të fillojë procedura kuvendare për to.²⁰

Si përgjigje e kërkesave të VMRO-DPMNE-së, ministrat dhe funksionarët e BDI-së më 30 korrik të vitit 2023 ia dorëzuan dorëheqjet kryeministrit Dimitar Kovaçevski, të cilat do të hynin në fuqi me votimin e ndryshimeve kushtetuese. Vendimin për dorëheqjet e kushtëzuara të pesë ministrave ua kumtoi lideri i BDI-së, Ali Ahmeti. Në LSDM vlerësuan se me këtë lëvizje të partnerit të tyre të koalicionit në Qeveri janë përmbushur të gjitha kushtet që VMRO-DPMNE të votojë për ndryshimet kushtetuese. Në VMRO-DPMNE kërkuan që dorëheqjet e ministrave të BDI-së të jenë të parevokueshme dhe pastaj të organizohen zgjedhjet e shpejta të parakohshme parlamentare, sepse çdo gjë tjetër është zvarritje dhe është në kundërshtim me vullnetin e qytetarëve.²¹

Në kushtet e polarizimit të theksuar politik mes pushtetit dhe opozitës, ndryshimet kushtetuese hynë në procedurën kuvendare, meqë në 18 korrik kaluan në seancën qeveritare.²² Pa marrë parasysh faktit që për miratimin e tyre nuk u arrit konsensusi mes pushtetit dhe opozitës, më 18 gusht filloi seanca kuvendare e 123-të në të cilën kishte vetëm një pikë në rendin e ditës – Propozimi për fillimin e ndryshimit të Kushtetutës. Shtatëdhjetë deputetë, nga 119 të pranishëm, votuan „pro“ miratimit të rendit të ditës, kundër ishin 47 deputetë, ndërsa të përmbajtur nuk kishte.²³ Seanca zgjati më pak se tre orë dhe pas mbarimit të disa diskutimeve nuk kishte votim. Kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi, e ndërpreu seancën dhe theksoi se votimi do të caktohet më tutje. Kryeparlamentari Xhaferi paralajmëroi më herët se votimi do të bëhet kur do të ketë kushte për këtë gjë, gjegjësisht kur do të sigurohet shumica e dy të tretave.²⁴

20 Do të bisedojë vetëm për zgjedhjet – VMRO-DPMNE i tërheq të gjitha ofertat për konsensus për ndryshimet kushtetuese <https://telma.com.mk/2023/07/08/kje-razgovara-samo-za-izbori-vmro-dpmne-gi-povlekuva-site-ponudi-za-konsenzus-za-ustavnite-izmeni/> (vizita e fundit më 07.04.2024)

21 Ministrat e BDI-së deponuan dorëheqje të kushtëzuara, VMRO-DPMNE kërkon që ato të jenë të parevokueshme <https://telma.com.mk/2023/07/30/ministrite-na-dui-deponiraa-usloveni-ostavki-vmro-dpmne-bara-tie-da-bidat-neotpoviklivi/> (vizita e fundit më 07.04.2024)

22 Ndryshimet kushtetuese kaluan në seancën qeveritare, radhën e ka Kuvendi <https://360stepeni.mk/ustavnite-izmeni-pominaa-na-vladina-sednitsa-na-red-e-sobraniето/> (vizita e fundit më 07.04.2024)

23 Filloi seanca për ndryshimet kushtetuese – 70 deputetë votuan për rendin e ditës <https://360stepeni.mk/pochna-sednitsata-za-ustavni-izmeni-70-pratenitsi-glasaa-za-dnevniot-red/> (vizita e fundit më 07.04.2024)

24 Debat i shkurtër për ndryshimet kushtetuese, për votim do të pritet <https://www.slobodnaevropa.mk/a/kusa-debata-za-ustavnite-izmeni-za-glasanje-kje-se-cheka-/32554063.html> (vizita e fundit më 07.04.2024)

Meqenëse u bë e qartë se shumica qeveritare nuk do të mund të sigurojë shumicën e dy të tretave në këtë përbërje parlamentare, konfrontimet politike me opozitën vazhduan dhe sërish u aktualizua tema për zgjedhjet e parakohshme. Në tetor të vitit 2023, VMRO-DPMNE-ja hoqi dorë nga presioni për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme dhe pranoi të marrë pjesë në grupet e punës të cilat do të duhet ta caktojnë datën për mbajtjen e zgjedhjeve në vitin 2024. Duke i vlerësuar zgjedhjet si jashtëzakonisht të rëndësishme për shtetin, Mickovski propozoi që rrethi i dytë i zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare të mbahet ditën e njëjtë, gjegjësisht më 8 maj 2024.²⁵ Marrëveshja politike për mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale është arritur në takimin liderësh ndërmjet kryetarëve të të gjitha partive politike parlamentare më 4 dhjetor ²⁶.

Në periudhën parazgjedhore, partitë politike i promovuan listat zgjedhore dhe bartësit e tyre, ndërsa i prezantuan edhe programet për zgjedhjet e ardhme parlamentare. KSHZ më 3 prill informoi se në kuadër të afatit të përcaktuar ligjor, përfundimisht më 2 prill 2024 deri në orën 24, kanë arritur 17 kandidatura për deputetë:²⁷

Partitë politike dhe koalicionet	Njësitë zgjedhore
LSDM („Koalicioni për të ardhmen evropiane“)	NjZ1, NjZ2, NjZ3, NjZ4, NjZ5, NjZ6
VMRO-DPMNE (Koalicioni „Maqedonia jote“)	NjZ1, NjZ2, NjZ3, NjZ4, NjZ5, NjZ6
ZNAM – Për Maqedoninë tonë	NjZ1, NjZ2, NjZ3, NjZ4, NjZ5, NjZ6
Rodina	NjZ1, NjZ2, NjZ3, NjZ4, NjZ5, NjZ6
Avaja	NjZ3, NjZ4, NjZ5, NjZ6
Partia punëtore	NjZ1, NjZ2, NjZ3, NjZ4, NjZ5, NjZ6
Partia jote	NjZ1 NjZ2, NjZ3, NjZ4
GROM	NjZ1, NjZ2, NjZ3, NjZ4, NjZ5, NjZ6
Era e tretë maqedonase	NjZ1, NjZ2, NjZ3, NjZ4, NjZ5, NjZ6

25 VMRO-DPMNE hoqi dorë nga zgjedhjet e parakohshme <https://www.dw.com/mk/mickovski-se-otkaza-od-predvremenite-izbori-kako-sto-ke-kaze-kovacevski-za-datum-i-den-taka-ke-bide/a-67161999> (vizita e fundit më 07.04.2024)

26 U arrit marrëveshje për datën zgjedhje të dyfishta më 8 maj <https://www.dw.com/mk/partiite-se-dogovorija-pretседателски-i-parlamentarni-izbori-na-8-maj/a-67626319> (vizita e fundit më 11.04.2024)

27 Janë parashtruar 17 lista të deputetëve për zgjedhjet parlamentare në KSHZ <https://nezavisen.mk/podneseni-17-listi-na-pratenici-za-parlamentarnite-izbori-do-dik/> (vizita e fundit më 07.04.2024)

BDI („Koalicioni për frontin evropian“)	NjZ1, NjZ2, NjZ3, NjZ4, NjZ5, NjZ6
Demokratët	NjZ1, NjZ2, NjZ3, NjZ4, NjZ5, NjZ6
Maqedonia e vetme	NjZ1, NjZ2, NjZ3, NjZ4, NjZ5, NjZ6
Grup zgjedhësish GJYLA ÇELIKU	NjZ6
Koalicioni „Vlen“	NjZ1, NjZ2, NjZ3, NjZ4, NjZ5, NjZ6
E majta - Levica	NjZ1, NjZ2, NjZ3, NjZ4, NjZ5, NjZ6
E djathta	NjZ1, NjZ2, NjZ3, NjZ4, NjZ5, NjZ6
Alternativa e re	NjZ1, NjZ2, NjZ3, NjZ4

Njëkohësisht me këto aktivitete partiake u përforcua polariteti politik dhe u intensifikua retorika politike dhe pritet këto procese të arrijnë kulmin gjatë fushatave parazgjedhore. Në raportin e ODIHR-së publikuar më 29 shkurt²⁸ vlerësohet se shtrirja mediatike e fushatës zgjedhore është fragmentarizuar dhe polarizuar, se ka zmadhim të konsiderueshëm të retorikës nacionaliste që mund të rezultojë me trazira dhe tensione të shtuara, si dhe është vërejtur shtimi i retorikës të patolerueshme dhe të dhunshme.²⁹

Ministri teknik i punëve të brendshme, Pançe Toshkovski, shprehu shqetësim për parregullsi të mundshme në njësinë e gjashtë zgjedhore, duke dhënë kritika për qeverinë aktuale, sepse qëkur është në detyrë nuk i është lejuar të emërojë shefin e ri të SPB Tetovë, edhe pse i takon kjo e drejtë konform ligjit.³⁰

Drejtori i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (ASHMAV), Zoran Trajčevski, më 29 mars, theksoi se prokuroria duhet të ketë kujdes se si do të shpenzohen paratë shtetërore për reklamat zgjedhore tek portalet. Trajčevski konsideron se Prokuroria publike duhet t'i kushtojë kujdes mediave onlajn, të cilat marrin nga 15.000 euro para nga shteti për reklama partiake gjatë kohës së zgjedhjeve, duke shtuar se këtë vit janë paraqitur 251 internet - portale. Sipas Trajčevskit, shumica e atyre portaleve janë partiake dhe zhduken pas zgjedhjeve. Rrezikun e njëjtë e spikati edhe kryetarja e Komisionit shtetëror për parandalimin e korrup-

28 Raport OSBE/ODIHR <https://www.osce.org/files/f/documents/b/e/563592.pdf> (vizita e fundit më 07.04.2024)

29 ODIHR, me më shumë se 300 vëzhgues të zgjedhjeve, pret rritje të trazirave dhe tensioneve <https://telma.com.mk/2024/03/11/odih-so-poveke-od-300-nabluduvachi-na-izborite-ochekuva-zasileni-nemiri-i-tenzil/> (vizita e fundit më 07.04.2024)

30 Toshkovski ngre dyshime për rregullsinë e zgjedhjeve në Tetovë, Gostivar dhe rrethinë <https://telma.com.mk/2024/03/27/toshkovski-otvora-somnezh-za-regularnosta-na-izborite-vo-tetovo-gostivar-i-okolinata/> (vizita e fundit më 07.04.2024)

sionit (KSHPK), Tatjana Dimitrovska, e cila theksoi se nuk është e rregulluar se si do të shpenzohen rreth 2,5 milionë euro të dedikuara për reklamimin partiak në internet.³¹

Që para fillimit të fushatave parazgjedhore filluan konfrontimet politike ndërmjet LSDM-së dhe VMRO-DPMNE-së, ndërsa situata është e njëjtë edhe në bllokun politik shqiptar. LSDM-ja e akuzoi VMRO-DPMNE-në për krijimin e lajmeve dhe anketave të rreme, të prezantuara në servis publik, kurse VMRO-DPMNE këtë e demantoi dhe paralajmëroi padi për shpifje.³² Konfrontimet politike ndërmjet LSDM-së dhe VMRO-DPMNE lidhur me këto tema mund të ndodhë të vazhdojnë deri në zgjedhjet.

LSDM në këto zgjedhje do ta udhëheqë „Koalicionin për të ardhmen evropiane“ me besimin se do të jetë udhëheqëse e proceseve reformuese dhe do të angazhohet për përfundimin e negociatave me BE-në deri në vitin 2028 dhe anëtarësimin deri në vitin 2030.³³ Këtë koalicion do ta përbëjnë gjithsej 14 parti.

Edhe pse kishte njoftime të dhëna se LSDM dhe BDI në zgjedhjet e ardhme do të shfaqen bashkërisht dhe do të formojnë frontin e ashtuquajtur të gjerë evropian, i cili sipas tyre do t'i kishte bashkuar të gjithë faktorët politikë dhe shoqërorë të cilët e mbështetësin anëtarësimin në BE, megjithatë këto parti të shumicës qeveritare vendosën të shfaqen të vetme. Në masë të madhe ky vendim vjen falë analizave dhe vlerësimeve brendapartiake, por edhe falë faktit që në bllokun shqiptar po formohej fronti i bashkuar opozitar. Për shkak të rrethanave të reja politike dhe faktit që opozita e bashkuar shqiptare „Vlen“ doli me kandidatin e përbashkët presidencial, BDI mori vendim të paraqitet me kandidatin e saj për president dhe të mos e mbështesë kandidatin e LSDM-së, Stevo Pendarovski, i cili në zgjedhjet e kaluara presidenciale ishte kandidat i përbashkët konsensual i LSDM-së dhe BDI-së. Këtij vendimi të BDI-së i parapriu konfrontimi politik me presidentin aktual, Stevo Pendarovski, për shkak të mosnënshkrimit të tij të Ligjit për lojërat e fatit dhe lojërave argëtuese, duke theksuar se këtë gjë e ka bërë për shkak të indikacioneve serioze të BE-së se po keqpërdoret flamuri evropian në procesin e miratimit të këtij ligji.³⁴

31 Rreziku i keqpërdorimit të parave të reklamave zgjedhore <https://prizma.mk/rizik-od-zloupotreba-od-parite-za-izborni-reklami/> (vizita e fundit më 07.04.2024)

32 VMRO-DPMNE shpalli padi për shpifje kundër LSDM-së: Dokumentet që i kanë publikuar janë të shpikura <https://360stepeni.mk/vmro-dpmne-najavi-tuzhba-za-kleveta-protiv-sdsm-dokumentite-shto-gi-objavijase-izmisleni/> (vizita e fundit më 07.04.2024)

33 LSDM dhe 13 parti formuan „Koalicionin për të ardhmen evropiane“ <https://www.dw.com/mk/sdsm-i-13-partii-so-koalicijata-za-evropska-idnina-ke-odat-na-izbori/a-68684980> (vizita e fundit më 07.04.2024)

34 Presidenti Pendarovski nuk e nënshkroi Dekretin për shpalljen e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese. https://pretsedatel.mk/dopis_13022024/ (vizita e fundit më 09.04.2024)

VMRO-DPMNE do ta udhëheqë koalicionin „Maqedonia jote“ dhe konform programit parazgjedhor „Platforma 1198“ si prioritete do të jenë ekonomia, lufta kundër korrupsionit dhe kthimi i besimit të qytetarëve në institucionet.³⁵ Në kuadër të koalicionit janë përfshirë gjithsej 24 parti.

Partitë „Dinjiteti“, Të bashkuar për Maqedoninë (OM) dhe Lidhja demokratike (DS), të cilat ishin partnere koalicioni të LSDM-së në prag të zgjedhjeve vendosën të largohen nga koalicioni deritashëm me LSDM-në dhe iu bashkëngjitën koalicionit të VMRO-DPMNE-së. Lideri i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski theksoi se me këto parti kanë marrëveshje të përbashkët parimore për dalje në zgjedhjet e ardhme parlamentare.³⁶ Liderët e „Dinjiteti“, Stojançe Angellov, dhe Lidhja demokratike, Pavle Trajanov, theksuan se vendimet e tyre kanë rrjedhur nga premtimet dhe pritshmëritë e papërbushura nga partneri i deritashëm i koalicionit, si dhe për shkak të bllokimit të propozimeve të tyre në Kuvend.³⁷ Lideri i OM-së, Lube Boshkovski, theksoi se vendimi për koalicionim me VMRO-DPMNE-në është për arsye ideologjike.³⁸

Në bllokun politik shqiptar, BDI në këto zgjedhje do ta udhëheqë koalicionin „Frontin evropian“.³⁹ Të përballur me opozitën e bashkuar shqiptare, BDI vendosi në këto zgjedhje të dalë me koalicion të gjerë. Më 25 mars në Tetovë BDI, PDSH, Partia demokratike evropiane dhe Lëvizja popullore nënshkruan marrëveshje për koalicion për „Frontin evropian“ të udhëhequr nga Ali Ahmeti. Marrëveshjen e nënshkruan kryetarët e katër partive, Ali Ahmeti, Menduh Thaqi, Arianit Hoxha dhe Skender Rexhepi - Zejd, e më vonë iu bashkëngjitën edhe partitë tjera nga bashkësitë më të vogla etnike, si dhe krahu i Ziadin Selës nga AA. Ahmeti theksoi se pret fitore të madhe në zgjedhjet dhe se fronti do të funksionojë deri në arritjen e qëllimit – anëtarësimi në BE.⁴⁰ Ky koalicion përbëhet nga gjithsej nëntë parti.

35 VMRO-DPMNE e prezantoi koalicionin parazgjedhor të quajtur „Për Maqedoninë tënde“ <https://kanal5.com.mk/vmro-dpmne-ja-pretstavi-predizborna-koalicija-narechena-za-tvoja-makedonija/a632907> (vizita e fundit më 07.04.2024)

36 Mickoski: Kemi marrëveshje parimore për paraqitje në zgjedhjet parlamentare mbi të cilën do të funksionojmë si qeveri e re <https://makfax.com.mk/makedonija/%D0%BC%D0%B8%D1%86%D0%BA%D0%BE%D1%81%D0%BA%D0%B8-%D0%B8%D0%BC%D0%B0%D0%BC%D0%B5-%D0%BF%D1%80%D0%B8%D0%BD%D1%86%D0%B8%D0%BF%D0%B8%D0%B5%D0%BB%D0%B5%D0%BD-%D0%B4%D0%BE%D0%B3%D0%BE%D0%B2%D0%BE%D1%80/> (vizita e fundit më 09.04.2024)

37 Paragrupime partiake para zgjedhjeve <https://www.dw.com/mk/partiite-se-pregrupiraat-pred-izborite-se-pravat-novi-koalicii-se-zaokruzuvaaat-izbornite-listi/a-68659288> (vizita e fundit më 09.04.2024)

38 Boshkovski: Koalicioni me VMRO-DPMNE-në do të jetë për arsye ideologjike <https://netpress.com.mk/boshkovski-koalici-a-so-vmro-dpmne-e-bide-od-ideoloshka-prichina/> (vizita e fundit më 09.04.2024)

39 Ahmeti me Frontin evropian do t'i mobilizojë votuesit <https://www.dw.com/mk/ahmeti-so-evropskiot-front-ke-gi-mobilizira-glasacite-i-ke-se-bori-protiv-ruskoto-vlijanie/a-68613769> (vizita e fundit më 07.04.2024)

40 Në Frontin evropian të BDI-së hanë katër parti <https://nezavisen.mk/vo-evropskiot-front-na-dui-vlegoachetiri-partii/> (vizita e fundit më 09.04.2024)

Opozita e bashkuar „Vlen“ do të përpiqet për ta dobësuar pozitën politike të BDI-së. Ky koalicion është i përbërë nga disa parti, siç janë: Lëvizja demokratike e Izet Mexhitit, Lëvizja BESA e Bilall Kasamit, Alternativa e Afrim Gashit, një pjesë e partisë Aleanca për Shqiptarët e udhëhequr nga kryetari i partisë Arben Taravari, si dhe mbështetësit e partisë Vetëvendosje e kryeministrit kosovar Albin Kurti. Ky bllok opozitar ka për qëllim që pas shumë vitesh ta dëbojë BDI-në nga pushteti.

Për të fituar vendet e deputetëve, në mesin e atyre partive që u jepet mundësi e konsiderueshme për të hyrë në Kuvend, do të pretendojnë edhe partitë politike „Levica“, „ZNAM – Për Maqedoninë tonë“ e Maksim Dimitrievskit dhe koalicioni „Trimërisht për Maqedoninë“ i udhëhequr nga Opsioni qytetar për Maqedoninë (GROM), ndërsa në katër njësitë zgjedhore të para do të marrë pjesë edhe partia Alternativa e Re e kryetares së Qytetit të Shkupit, Danella Arsovska.

Rrethi parë i zgjedhjeve presidenciale do të jetë përcaktues dhe domethënës lidhur me pozitat e partive politike, si dhe në masë të madhe do të jetë tregues i rezultatit të zgjedhjeve parlamentare. Njëkohësisht, partitë politike do të tentojnë ta përdorin rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale për të mobilizuar trupin votues në pragun e zgjedhjeve parlamentare dhe rrethit të dytë vendimtar të zgjedhjeve presidenciale. Në qendër të vëmendjes gjatë fushatës parazgjedhore pritet të jetë tema e miratimit të ndryshimeve kushtetuese me qëllim të zhbllokimit të proceseve eurointegruese, si dhe temat ekonomike për përmirësimin e standardit jetësor të qytetarëve dhe të luftës kundër korrupsionit. Çështja e ndryshimit të ndryshimeve kushtetuese mund të jetë faktor kyç në kombinatorikën politike dhe në krijimin e rrethanave të reja politike pas zgjedhjeve.

Përgatitjet për zgjedhjet parlamentare

KSHZ më 14 shkurt e miratoi Kalendarin e afateve për kryerjen e veprimeve zgjedhore për zbatimin e Zgjedhjeve të deputetëve në Kuvend.⁴¹ Në kuadër të aktiviteteve përgatitore, KSHZ-ja vazhdimisht i plotëson Komisionet komunale zgjedhore (KKZ) me anëtarë në vendet e atyre që u ka mbaruar mandati ose ka pasur kërkesa për shkarkime, por jo më vonë se 26 mars. Sipas Kalendarit të afateve, Komisioni komunal zgjedhor (KKZ) duhet t'i formojë këshillat zgjedhorë (KZ) më së voni deri më 26 mars, ndërsa deri në këtë afat kohor KSHZ-ja duhet t'i formojë edhe OZ-të në

41 Kalendar i afateve për zgjedhjet parlamentare https://drive.google.com/file/d/1iN8Gim1W542gkDasz_aDHK0pX_43dEcZ/view (vizita e fundit më 07.04.2024)

përfaqësitë diplomatike – konsullore (PDK)⁴².

Shikimi publik i listës zgjedhore në njësitë rajonale të KSHZ-së, në ueb-faqen <http://izbirackispisok.gov.mk/>, si dhe në PDK-të (për votim jashtë shtetit), u hap 20 ditë në periudhën 28 shkurt – 18 mars 2024. Ata qytetarë të cilët gjatë kësaj periudhe konstatuan se nuk ndodhen në Listën zgjedhore, ndërsa i plotësojnë kushtet për të drejtën e votës, mund të kërkonin që të regjistroheshin. Në periudhën prej shpalljes së zgjedhjeve deri në mbylljen e shikimit publik në Listën zgjedhore shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut që jetojnë jashtë kufijve të vendit dhe të cilët i plotësojnë kushtet për votim jashtë shtetit kishin mundësi që të paraqiteshin për ta realizuar këtë të drejtë të tyre.

Listën zgjedhore në të cilën janë bërë të gjitha ndryshimet e dala nga shikimi publik, të shtypur në formë ekstraktesh, KSHZ e përmbyll më së voni 15 pas shikimit publik të përfunduar, gjegjësisht më së voni më 2 prill. Në seancën e mbajtur më 2 prill, KSHZ e përmbylli Listën zgjedhore edhe për zgjedhjet parlamentare edhe për zgjedhjet presidenciale. Në Listën zgjedhore për zgjedhjet parlamentare janë regjistruar 1.815.350 zgjedhës, gjersa për zgjedhjet presidenciale 1.814.317 zgjedhës.⁴³

Në diasporë do të organizohen vetëm zgjedhjet për presidentin, ngase nuk është arritur norma ligjore e votuesve të regjistruar. Për t'u organizuar votimi për zgjedhjet parlamentare në diasporë është dashur të regjistrohen së paku 5.355 votues, aq sa kishte fituar në zgjedhjet e mëparshme deputeti me numër më të vogël votash nga njësitë zgjedhore të territorit të shtetit.⁴⁴

KSHZ-ja nënshkron Listën zgjedhore të përmbyllur, gjegjësisht Ekstraktet e Listës zgjedhore në të cilat votohet, më së voni 15 para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve, përkatësisht për këto zgjedhje, më së voni më 22 prill.

Sipas kalendarit të afateve, raportet financiare (me specifikacion të shpenzimeve për të ardhurat dhe harxhimet në llogarinë e transaksionit) të pjesëmarrësve

42 Duke pasur parasysh numrin e pamjaftueshëm të votuesve të regjistruar, votimi jashtë shtetit nuk do të organizohet për këto zgjedhje.

43 KSHZ e përmbylli Listën zgjedhore: Për zgjedhjet presidenciale ka 1 814 317 votues, ndërsa për ato parlamentare 1 815 350 <https://360stepeni.mk/dik-go-zakluchi-izbirackiot-spisok-za-pretседателските-izbori-ima-1-814-317-glasachi-a-za-parlamentarnite-1-815-350/> (vizita e fundit më 07.04.2024)

44 Dashtevski: Përgatitjet për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare pa probleme në pajtim me ligjin dhe kalendarin e afateve <https://mia.mk/en/story/%D0%B4%D0%B0%D1%88%D1%82%D0%B5%D0%B2%D1%81%D0%BA%D0%B8-%D0%BF%D0%BE%D0%B4%D0%B3%D0%BE%D1%82%D0%BE%D0%B2%D0%BA%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%B7%D0%B0-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%82%D1%81%D0%B5%D0%B4%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%BB%D1%81%D0%BA%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%B8-%D0%B7%D0%B0-%D0%BF%D0%B0%D1%80%D0%BB%D0%B0%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%82%D0%B0%D1%80%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%B5-> (vizita e fundit më 07.04.2024)

në fushatën zgjedhore në KSHZ, Entin shtetëror të revizionit (ESHR) dhe Komisionin shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK) dorëzohen në afatet e mëposhtme:

- » Në ditën e 11-të të fushatës zgjedhore, gjegjësisht më 28 prill, si dhe në afat njëditësh pas mbarimit të fushatës, gjegjësisht më 7 maj, për donacionet e pranuar për fushatën zgjedhore;
- » raporti i përgjithshëm financiar me specifikacionin e shpenzimeve për të ardhurat dhe harxhimet dorëzohet menjëherë, ndërsa më së voni në afat 15 ditësh nga dita e mbylljes së llogarisë së transaksionit.

Gjithashtu, radiodifuzerët, mediat e shtypit dhe mediat elektronike (internet portal-et) e kanë për detyrë të parashtrojnë raport në Ministrinë e financave (MF), KSHZ, ESHR dhe KSHPK, për hapësirën reklamuese të shfrytëzuar nga secili pjesëmarrës në fushatën zgjedhore, më së voni deri më 21 maj.

Organizatat dhe personat parashtrojnë kërkesë për vëzhgim në KSHZ nga dita e shpallje së zgjedhjeve, ndërsa më së voni 10 ditë para ditës së votimit, përkatësisht për këto zgjedhje në periudhën nga 14 shkurt deri më 27 prill. KSHZ-ja u lëshon autorizime vëzhguesve më së voni shtatë ditë pas pranimit të kërkesës.

Partitë politike deri më 2 prill deri në orën 24:00, gjegjësisht 35 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve, në KSHZ i kanë parashtruar listat e kandidatëve të tyre për zgjedhjet parlamentare. Deri në afatin e fundit kohor janë parashtruar listat e 17 pjesëmarrësve, përkatësisht 11 partive politike, pesë koalicioneve, si dhe është parashtruar lista e pavarur e grupit të zgjedhësve.

Fushata zgjedhore për zgjedhjet parlamentare fillon 20 ditë para ditës së zgjedhjeve, gjegjësisht më 18 prill në orën 00:00 dhe zgjat deri në orën 24, më 6 maj.

Në pajtim me nenin 8-a të Kodit zgjedhor, 20 ditë para fillimit të fushatës zgjedhore filloi periudha në të cilën nuk mund të mbahen ngjarjet publike me rastin e fillimit të ndërtimit ose vënies në përdorim të një objekti ose infrastrukture e financuar me mjete nga Buxheti, fondet publike, si dhe nga mjetet e ndërmarrjeve publike me kapital shtetëror.⁴⁵

Renditja e fletëvotimit të koalicionit dhe të partive të cilat e kanë kandidatin e vet në zgjedhjet presidenciale do të jetë e njëjtë ashtu si për kandidatët për president, ndërsa për partitë tjera do të kryhet me anë të shortit plotësues në KSHZ, në paj-

45 Kodi zgjedhor <https://drive.google.com/file/d/1ZJMruqcNI-yC5VuWSzpfT9BFekPhm5An/view> (vizita e fundit më 09.04.2024)

tim me ndryshimet e fundit të Kodit zgjedhor të cilat Kuvendi i votoi në kuadër të seancës së 150 -të.⁴⁶

Ndryshimet e fundit në legjislacionin zgjedhor

Nga cikli i fundit zgjedhor deri në ditët e sotme janë bërë shumë ndryshime lidhur me dispozitat e Kodit zgjedhor të Republikës së Maqedonisë Veriut (RMV). Kuvendi në muajin mars të këtij viti, me procedurë të shkurtuar dhe me 84 vota „pro“ i sollti ndryshimet e reja në Kodin zgjedhor. Ndryshimet kanë të bëjnë me organet shtetërore zgjedhore, financimin e fushatës politike, pjesëmarrësit në fushatë, si dhe shtrirjen mediatike të fushatës zgjedhore.⁴⁷

Për shkak të situatës së re të krijuar me vlefshmërinë e dokumenteve personale të qytetarëve, ekzistonte rreziku serioz që mbi 100.000 qytetarëve t'u mohohet e drejta e votimit në zgjedhjet e ardhshme. Me propozim të KSHZ-së, në ndryshimet e Kodit zgjedhor u gjet edhe dispozita kalimtare e cila e rregullon të drejtën e zgjedhësit për të votuar me letërnjoftim ose dokument udhëtimi vlefshmëria e të cilit ka skaduar në periudhën prej nëntë muajve deri në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve presidenciale, gjegjësisht parlamentare.⁴⁸

Si plotësim, u saktësuan dispozitat lidhur me regjistrimin e votuesve të rinj, në ç'mënyrë të drejtën për të votuar do ta kenë të gjithë që përfundimisht me ditën e zgjedhjeve do të mbushin 18 vjet. Kjo do të thotë se qytetarët që do të kalojnë në moshë madhore ndërmjet dy cikleve zgjedhore, do të kenë të drejtën e votimit vetëm në zgjedhjet parlamentare.⁴⁹

Me ndryshimin e neneve 61 dhe 62 të Kodit zgjedhor, në mënyrë të konsiderueshme rëndohet procesi që kandidatët e pavarur të zgjidhen në nivel lokal dhe

46 Partitë i dorëzuan në KSHZ listat e deputetëve për zgjedhjet më 8 maj, afati i parashtrimit mbaroi <https://360stepeni.mk/partiite-do-dik-gi-dostavija-listite-za-pratenitsi-za-izborite-na-8-maj-rokot-zapodnesuvane-zavrshi/> (vizita e fundit më 07.04.2024)

47 Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligji për ndryshim dhe plotësim të kodit zgjedhor 58/2024

48 „Mbi 100.000 qytetarë nuk kanë dokumente për votim në zgjedhje, KSHZ-ja propozoi ndryshime të Kodit zgjedhor, radhën e ka Kuvendi“ Telma, 04 mars 2024. Në dispozicion në <https://telma.com.mk/2024/03/04/nad-100-000-gragani-nemaat-dokumenti-za-glasane-na-izbori-sobranieto-na-poteg-otkako-dik-predlozhi-izmeni-na-izborniot-zakonik/> (vizita e fundit: 27 mars 2024)

49 „KSHZ: Qytetarët që do të mbushin 18 vjet ndërmjet dy rretheve të zgjedhjeve presidenciale më 8 maj do të mund të votojnë vetëm për zgjedhjen e deputetëve“ 360 shkallë, 15 mars 2024. Në dispozicion në: <https://360stepeni.mk/dik-graganite-shto-ke-napolnat-18-godini-pomegu-dvata-kruga-na-pretседателските-izbori-na-8-maj-ke-mozhe-da-glasaat-samo-za-izbor-na-pratenitsi/> (vizita e fundit: 26 mars 2024)

nacional. Me fjalë të tjera, në pajtim me nenin 61, parashtruesve të listave të pavarura parlamentare, në vend të 1000 nënshkrimeve të deritanishme në të ardhmen do t'u nevojiten nënshkrimet e 1% të zgjedhësve të regjistruar në Listën zgjedhore.⁵⁰ Si plotësim, ndryshimi i nenit 62 lidhur me zgjedhjet për këshilltarët komunalë dhe kryetarin e komunës, në vend të nënshkrimeve të deritashme të duhura që varionin prej 100 deri në 1.000 (varësisht nga numri i banorëve në komunën konkrete), tani rritet në 1% nga zgjedhësit e regjistruar në Listën zgjedhore të komunës së dhënë.⁵¹ Një pjesë e listave të pavarura të këshilltarëve që morën pjesë në zgjedhjet e mëparshme lokale reagon ndaj ndryshimeve të këtyre dy neneve, duke kundërshtuar se nuk janë në përputhje me rekomandimet e OSBE-së, por edhe se ekziston rreziku të njëjtit t'u shtypet pjesëmarrja në zgjedhjet vijuese lokale në vitin 2025.⁵²

Komisioni shtetëror i zgjedhjeve

Sipas ndryshimeve të fundit, për anëtar të Komisionit shtetëror të zgjedhjeve mund të zgjidhet personi i cili është shtetas i RMV-së me vendbanim të përhershëm në vend, të ketë arsim të lartë me të paktën tetë vjet përvojë pune dhe të mos jetë anëtar i ndonjë organi të partisë politike. Kuvendi i RMV-së në afat prej 30 ditëve para mbarimit të mandatit të Komisionit e shpall Konkursin për zgjedhje të përbërjes së re, përkatësisht zgjedhjen e kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të KSHZ-së në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe në shtypin ditor. Shpallja zgjat tetë ditë nga dita e publikimit në Gazetën zyrtare.

Procedura për zgjedhjen e anëtarëve mbetet e njëjte dhe përgatitet dhe zbatohet nga Komisioni për çështjen e zgjedhjeve dhe emërimeve në kuadër të Kuvendit të RMV-së. Ky komision e përgatit propozimin e listës së kandidatëve të paraqitur dhe e dorëzon në Kuvend. Nga kandidatët e listës së propozuar, opozita propozon kryetarin dhe dy anëtarë, ndërsa partitë në pushtet propozojnë nënkryetarin dhe tre anëtarë. Të gjithë anëtarët zgjidhen me dy të tretat e shumicës së numrit të përgjithshëm të deputetëve, me mandat 5 vjeçar nga dita e zgjedhjes.

Ndryshimet e këtij viti të Kodit zgjedhor e obligojnë Komisionin shtetëror të zgjedhjeve që të formojë një Qendër për edukim të vazhdueshëm në zgjedhje si njësi

50 Për listën e pavarur të deputetëve në NJZ1 në vend të 1.000 nënshkrimeve të deritashme, në të ardhmen do të jenë të nevojshme 3.372 nënshkrime.

51 Për listën e pavarur të këshilltarëve ose për kryetarin e qytetit të Shkupit në vend të 1.000 të deritashme, në të ardhmen do të nevojiten 4,674.

52 „Partitë i shtypën të pavarurit në fletëvotim” Radio Evropa e Lirë, 12 mars 2024. Në dispozicion në: <https://www.slobodnaevropa.mk/a/partiite-gi-istisnaa-nezavisnite-na-glasachkoto-livche/32858134.html> (Vizita e fundit: 1 prill 2024)

e veçantë organizative në shërbimin e saj, me të cilën do të udhëheqë këshilltari shtetëror i nivelit B1⁵³, i cili përgjigjet para Komisionit dhe Sekretarit të përgjithshëm. Qendra do të ketë për qëllim që të sigurojë trajnimin e vazhdueshëm të administratës zgjedhore, të votuesve, të pjesëmarrësve në zgjedhjet, të mediave dhe të vëzhguesve zgjedhorë, si dhe të përpunojë hulumtime dhe analiza të ndryshme për nevojat dhe me kërkesë të KSHZ-së.⁵⁴

Financimi i partive politike

Ligji për financimin e partive politike nuk ka pësuar ndryshime në disa vitet e fundit. Mbeten të vlejné dispozitat që kanë të bëjnë me specifikimin e pronës dhe financimin e partive politike (pronë e luajtshme dhe paluajtshme), lartësinë e mjeteve të përgjithshme për financimin vjetor të partive politike në lartësi prej 0,15% e të ardhurave të përgjithshme burimore të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, burimet private të financimit, lartësinë e donacioneve të veçanta që nuk guxojnë të tejkalojnë shumën prej 60 pagave mesatare si donacion nga persona juridikë dhe 30 paga mesatare neto nëse është donacion nga persona fizikë. Me ndryshimet e fundit të Kodit zgjedhor në mars të vitit 2024, nenit 83 iu shtua paragrafi i ri që i rregullon donacionet e veçanta që i marrin partitë politike për fushatat zgjedhore. Me fjalë të tjera, shuma e mjeteve kumulative në llogarinë e transaksionit për fushatën zgjedhore nuk guxon të jetë më e madhe se 3.000 euro në kundërvlerë denari nga personi i njëjte fizik ose 30.000 euro në kundërvlerë denari nga personi i njëjte juridik.

Mjetet për financimin e partive politike, në shumë prej 30% që sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, edhe më tutje shpërndahen në mënyrë të barabartë të të gjitha partitë politike që kanë fituar më së paku 1% nga numri i përgjithshëm i votave nga zgjedhjet e fundit parlamentare dhe lokale. 70% e mjeteve u shpërndahen partive politike sipas numrit të deputetëve të zgjedhur në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe sipas numrit të zgjedhur për këshilltarë në zgjedhjet e fundit lokale.

Neni 26 i Ligjit për financimin e partive politike parasheh që mbikëqyrjen e financimit ta kryejë Enti shtetëror i revizionit. Neni parasheh gjithashtu që partitë të kenë

53 Sipas Nenit 24 të Ligjit për nëpunës administrativë, nëpunësi shtetëror i kategorisë B1 është nëpunës administrativ udhëheqës i nivelit të parë, i cili i përmbush kushtet që të ketë më së paku dy vjet në vend udhëheqës pune në sektorin publik, respektivisht më së paku tre vjet në vend udhëheqës pune në sektorin privat.

54 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligji për ndryshim dhe plotësim të kodit zgjedhor 58/2024

vetëm një xhirollogari, ndërsa në rast të financimit përmes sigurimit të mjeteve nga kreditë nga bankat komerciale, krahas xhirollogarisë bazë, mund të kenë edhe një xhirollogari të veçantë për mjetet e partisë të siguruara përmes kredisë. Gjithashtu, partia politike ka të drejtën të kryejë transferim të mjeteve ndërmjet llogarive të tyre, ndërsa qendrat e partive për hulumtime dhe analizë kanë llogari të veçantë. Mjetet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në lartësi prej 280.000 euro në kundërvlerë denari janë paraparë edhe për financimin vjetor të qendrave të partive për hulumtime dhe analizë të cilat janë formuar në pajtim me ligjin si pjesë e organizimit të brendshëm të partisë.⁵⁵

Me ndryshimet në ligj, në vitin 2018 u krijua detyrimi për dorëzimin e raportit financiar për punët materiale-financiare të partisë, në të cilin përmbahen veprimet financiare të llogarisë, respektivisht llogaritë e partisë politike. Me ndryshimet, zërat „sponsorizim“ dhe „kredi“ njihen si pjesë plotësuese e raportit financiar. Me ndryshimet u parashikua që mjetet e dedikuara për financimin e partive politike të shlyhen në përputhje me mundësitë buxhetore, por jo më vonë se më 1 mars në çdo vit rrjedhës.

Mediat publike

Edhe në këtë cikël zgjedhor mbetet të vlejë ndalesa e ndryshimeve të Kodit zgjedhor në vitin 2018 me të cilën nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, e deri në fillimin e fushatës zgjedhore, radiodifuzerët, mediat e shtypit dhe mediat elektronike (portalet) nuk guxojnë të emetojnë, respektivisht të publikojnë reklamim të paguar politik, përveç shpalljeve dhe njoftimeve për mbledhjen e nënshkrimeve për mbështetjen e kandidaturës të një grupi zgjedhësish. Në rastet kur bëhet fjalë për emetim, respektivisht publikim të njoftimeve për mbledhjen e nënshkrimeve për mbështetjen e kandidaturave, kjo bëhet në blloqe të shënuara reklamuese gjatë kohës së lejuar të reklamimit brenda një ore reale. Ndryshimet në Kodin zgjedhor nga marsi i vitit 2024, në anën tjetër, parashikojnë kufizime në promovimin e kandidatëve, respektivisht, nga momenti i përcaktimit të listave të kandidatëve deri te fillimi i fushatës zgjedhore pjesëmarrësit në zgjedhjet kanë të drejtën që të organizojnë nga një ngjarje publike për promovimin e listave të tyre të vërtetuara të kandidatit/kandidatëve dhe programeve zgjedhore. Si rrjedhojë, me nenin 69-a u ndalohet partive të shpenzojnë prej mjeteve të dedikuara për fushatën zgjedhore në periudhën e mëparshme të përmendur.

⁵⁵ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për financimin e partive politike, 140/2018

Gjatë rrethit të parë dhe të dytë të fushatës zgjedhore, radiodifuzerët që mbulojnë zgjedhjet, mund të emetojnë gjithsej nëntë minuta kohë reale të dedikuara vetëm për reklamim të paguar politik. Nga këto 9 minuta, gjithsej katër minuta mund të ndahen për partitë politike të pushtetit, katër minuta për partitë politike të opozitës, ndërsa një minutë për grupin e deputetëve ose partitë politike që nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Këtë vit, për shkak të mbajtjes së zgjedhjeve të dyfishta, ka mundësi në një orë të dhënë partitë të reklamohen gjithsej 19 minuta. Më parë, rast të këtillë kishte në fushatën zgjedhore për zgjedhjet e dyfishta në v. 2014 kur partitë u morën vesh për kufizimin 15 minutësh promovim në një orë.⁵⁶

Me ndryshimet më të reja në Kodin zgjedhor, shërbimi radiodifuziv publik, si dhe stacionet televizive që do të publikojnë reklamim të paguar politik, kanë për detyrë që t'i publikojnë përmbajtjet lidhur me procesin zgjedhor në një format që do të ketë qasje për personat me aftësi të kufizuara, d.m.th. përdorimi i gjuhës së shenjave, titrave, audio përshkrimit ose mjeteve të tjera për t'u siguruar qasja, të paktën një herë, në periudhën prej orës 16:00 deri në orën 24:00. Si plotësim, neni 75 i detyron ofruesit e shërbimeve, para fillimit të fushatës zgjedhore të dorëzojnë orarin në Agjencinë për shërbime audio dhe audio-vizuale (ASHMAA) për atë se cili edicion lajmesh dhe cilat përmbajtje tjera do t'i emetojnë në format që do të ketë qasje për personat me aftësi të kufizuara, ndërsa ASHMAA duhet ta publikojë të njëjtën në faqen e saj të internetit.

56 „Zgjedhje 2024: EPP-ja partiake me përmasa epike“, Prizma, 08 shkurt 2024. Në dispozicion në: <https://prizma.mk/izbori-2024-partisko-epp-od-epski-razmeri/> (vizita e fundit: 26 mars 2024)



**Historiku i zgjedhjeve
parlamentare në Republikën
e Maqedonisë së
Veriut (1990 - 2020)**

1. Historiku i zgjedhjeve parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut (1990 - 2020)

Me vendosjen e pluralizmit politik në vitin 1989 u mundësua formimi i partive politike me ç 'gjë në **vitin 1990** votuesit maqedonas kishin mundësi për herë të parë të votojnë në zgjedhjet shumëpartiake. Njëherazi ishin zgjedhjet e para të lira shumëpartiake të cilat u mbajtën në të gjitha gjashtë republikat e RSFJ-së gjatë të njëjtit vit. Zgjedhjet e vitit 1990 u zhvilluan sipas sistemit zgjedhor të shumicës në dy rrahë votimi, në nivelin e 120 njësive zgjedhore. Në rrethin e parë të zgjedhjeve fitoi deri atëherë partia e vetme udhëheqëse në pushtet, Lidhja e komunistëve të Maqedonisë – Partia për transformim demokratik (LKM-PTD), ndërsa në rrethin e dytë VMRO-DPMNE-ja. Më 20 mars të vitit 1991 Kuvendi e votoi Qeverinë e parë të ekspertëve të Republikës së Maqedonisë, në krye me Nikolla Klusevin. Në këtë periudhë, Kuvendi e zgjodhi edhe Kiro Gligorovin për president të parë të shtetit, ndërsa Lubço Georgievskin, liderin e VMRO-DPMNE-së, për nënkryetar të presidentit. Qeveria e parë nuk zgjati shumë, meqë në gusht të vitit 1992 Kuvendi votoi mosbesimin e saj. Pas disa përpjekjesh për formimin e Qeverisë së re, mandatin e fitoi Branko Cërvenkovski i LSDM-së,⁵⁷ me ç 'gjë u formua Qeveria e parë politike në Maqedoninë e pavarur.

Zgjedhjet e para parlamentare pas pavarësisë u mbajtën në **vitin 1994**, njëkohësisht me zgjedhjet e para të drejtpërdrejta për president. Mënyra e zgjedhjes së deputetëve ishte e njëjtë si të zgjedhjeve në vitin 1990. Në zgjedhjet morën pjesë 38 parti dhe 283 kandidatë të pavarur. Në zgjedhjet fitoi koalicioni i udhëhequr nga Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), përderisa partitë kryesore opozitare, VMRO-DPMNE dhe Partia demokratike e Maqedonisë, e bojkotuan rrethin e dytë të votimit, duke ngritur akuza ndaj një sërë parregullsish në të parin. Pas zgjedhjeve, Branko Cërvenkovski e formon Qeverinë e re e cila në mandatin e saj katërvjeçar funksiononte pa partitë më të mëdha opozitare të cilat e bojkotuan punën e Kuvendit.

Zgjedhjet vijuese parlamentare në vitin 1998 u zhvilluan sipas modelit të modifikuar zgjedhor – sistem i përzier zgjedhor, me kombinim të modelit proporcional

⁵⁷ LKM-PTD në Kongresin e partisë në prill të vitit 1991 e ndërroi emrin në Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë, ndërsa ideologjinë e saj e transformoi nga komuniste në socialdemokrate.

dhe të modelit të shumicës, me votim në dy rrrathë. Fitues i zgjedhjeve ishte VMRO-DPMNE-ja me 49 mandate deputetësh, ku lideri Lubço Georgievski formoi qeverinë bashkë me Alternativën Demokratike (AD) dhe Partinë Demokratike të Shqiptarëve (PDSH). Këto zgjedhje ishin të parat në vend që u vëzhguan nga Misioni i OSBE-së/ODIHR-it, përfaqësuesit e të cilëve arritën me ftesë të Ministrisë së punëve të jashtme maqedonase.

Zgjedhjet parlamentare në vitin 2002 u zhvilluan në një atmosferë të acaruar paskonfliktuale. Veçoria e këtij cikli është se në skenën politike të bllokut politik shqiptar u shfaq një subjekt i ri, partia Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), e formuar nga udhëheqësia e Ushtrisë çlirimtare kombëtare (UÇK). Në këto zgjedhje u bë ndryshimi i serishëm i modelit zgjedhor, gjegjësisht u përqafua modeli proporcional zgjedhor, në gjashtë njësi zgjedhore. Ky model zgjedhor është përdorur në të gjitha zgjedhjet e mëvonshme parlamentare deri më sot, me modifikime të caktuara në pjesën e votimit të diasporës. Në këto zgjedhje morën pjesë 33 parti, pas së cilave ndodhi ndërrimi i pushtetit meqë shumicën e mandateve e fitoi koalicioni i udhëhequr nga LSDM-ja. Mandator i qeverisë së re ishte sërish Branko Cërvenkovski, ndërsa në qeveri u përfshinë LSDM, LDP dhe BDI.

Zgjedhjet parlamentare në vitin 2006 shënojnë daljen më të ulët të trupit votues deri atëherë meqë vetëm 56% e votuesve të regjistruar e realizuan të drejtën e tyre të votës. Aktorët politikë i ndryshuan rolet sërish meqë VMRO-DPMNE-ja e fitoi shumicën në Kuvend. Pas zgjedhjeve, Nikolla Gruevski e mori mandatin e tij të parë për formimin e Qeverisë. Qeveria e re u krijua nga partitë politike VMRO-DPMNE-Partia demokratike e unitetit kombëtar Maqedonas, PDSH- Partia Demokratike Shqiptare, NSDP- Partia e re socialdemokrate dhe PEI- Partia për ardhmëri evropiane. Veçori e kësaj përbërje të Qeverisë është se edhe pse BDI-ja fitoi më shumë vota dhe deputetë, VMRO-DPMNE-ja për partner të saj nga blloku shqiptar e zgjodhi PDSH-në e Menduh Thaqit. Kjo gjë rezultoi me krizë politike dhe bllokada të ndryshme nga BDI-ja. Ata konsideruan se për shkak të rezultateve, ata janë përfaqësuesi i vetëm legjitim i shumicës së shqiptarëve në vend, prandaj duhet të jenë pjesë e Qeverisë. Në vitin 2008 PDSH-ja mori vendim për ta lëshuar Qeverinë për shkak të mospërbushjes së pjesës më të madhe të kushteve të përcaktuara me partnerin e saj VMRO-DPMNE.

Dy vjet pas marrjes së pushtetit **në vitin 2008**, partia udhëheqëse në pushtet VMRO-DPMNE e pranoi iniciativën parlamentare të BDI-së për shpërbërjen e Kuvendit dhe për organizimin e zgjedhjeve të reja, të parakohshme. Dalja në këto zgjedhje ishte 57,06%. Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE atëherë shënoi rekord me 63 mandate të fituara. Qeverinë e formoi sërish Nikolla Gruevski, kurse në të

përveç ministrave të koalicionit hynë edhe ministrat e BDI-së si fitues të bllokut politik shqiptar.

Në **vitin 2011**, pas njërës nga krizat më të rënda politike në shtet dhe me kërkesë të partisë opozitare LSDM, u mbajtën zgjedhjet e dyta të parakohshme parlamentare në shtet. Veçori e këtyre zgjedhjeve është se për herë të parë i përfshinë edhe shtetasit maqedonas jashtë kufijve të vendit meqenëse numri i njësive zgjedhore u shtua prej 6 në 9, ndërsa numri i deputetëve prej 120 në 123. Deputetët e gjashtë njësive zgjedhore në shtet u zgjodhën sipas modelit proporcional, ndërsa për tre njësitë e reja jashtë kufijve shtetërorë u zbatua modeli i shumicës. Në zgjedhjet morën pjesë 53 parti politike, me ç' rast fitoren e korri sërish koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE. Pas zgjedhjeve, lideri i VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski, për herë të tretë formoi Qeverinë në të cilën sërish si përfaqësuese e bllokut shqiptar hyri BDI-ja. Dalja në këto zgjedhje ishte 63,48%.

Zgjedhjet parlamentare në vitin 2014 u mbajtën së bashku me zgjedhjen e Presidentit të shtetit. Është ruajtur modeli i njëjtë zgjedhor i zgjedhjeve të mëparshme, duke përfshirë edhe votimin e diasporës. Në zgjedhjet presidenciale fitoi sërish kandidati i VMRO-DPMNE-së, presidenti i atëhershëm Gjorgje Ivanov, ndërsa mandatin për formimin e qeverisë së re e mori për herë të katërt lideri i VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski. Në Qeverinë e re si partner i bllokut shqiptar sërish hyri Bashkimi demokratik për integrim. Dalja ishte 62,96%.

Zgjedhjeve të nënta parlamentare në vitin **2016** u paraprinte periudha e trazuar dhe dinamike e mbushur me shumë ngjarje tronditëse politike që kulmuan në 2015 me „afërën e përgjimeve“, më pas vijuan një sërë protestash masive që kontribuan në destabilizimin e madh dhe fillimin e njërës nga krizat më të mëdha në historinë moderne të shtetit. Me qëllim të stabilizimit të marrëdhënieve, nën patronazhin e bashkësisë ndërkombëtare u nënshkrua Marrëveshja e Përzahinos që parashihte një pako të gjerë masash për zgjidhjen e krizës politike. Në janar të vitit 2016, LSDM-ja e bëri të ditur se nuk do të marrë pjesë në zgjedhjet e caktuara për shkak të mospërbushjes së kushteve të Marrëveshjes, pas së cilës mbajtja e zgjedhjeve u shty për në dhjetor të po këtij viti. Edhe në këto zgjedhje më së shumti mandate mori koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE me 51 mandate të fituara, ndërsa opozita e udhëhequr nga LSDM mori 49. Menjëherë pas zgjedhjeve vijuan negociatat intensive ndërmjet BDI-së dhe dy partive më të mëdha maqedonase. Këto negociata rezultuan me marrëveshje për koalicion mes LSDM-së dhe BDI-së, por presidenti i atëhershëm i shtetit, Gjorgje Ivanov, refuzoi t'ia jepte mandatin liderit të LSDM-së, Zoran Zaev, duke e akuzuar se „po e rrënon sovranitetin e shtetit“ përmes pranimit të a.sh. Platformës shqiptare. Pas krizës disamuajshe e cila përfshiu pushtimin e Kuvendit më 27 prill të

vitet 2017, më 17 maj 2017 Ivanovi ia dha mandatin Zaevit, ndërsa Kuvendi më 31 maj me 62 vota „PRO“ e votoi qeverinë e re të koalicionit të udhëhequr nga LSDM.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2020

Zgjedhjet e dhjeta me radhë të deputetëve u mbajtën në vitin 2020 në periudhën e pandemisë së shkaktuar nga virusi Kovid-19. Veçori e këtyre zgjedhjeve ishte se ato u mbajtën për herë të parë në periudhën prej tre ditëve. Në ditën e parë, më 13 korrik, në shtëpitë e tyre votuan personat të cilëve u ishte caktuar masa e vetizolimit. Ditën e dytë votuan personat e sëmurë dhe të pafuqishëm, personat në arrest shtëpiak, si dhe të burgosurit në entet ndëshkuese-korrektuese, ndërsa dita e tretë, 15 korrik, ishte dita kryesore e zgjedhjeve. Në rrethana të atilla, dalja në zgjedhjet (52,02%) ishte më e ulët për 14% nga ajo në 2016 kur të drejtën e votimit e realizuan 66,79% të zgjedhësve të regjistruar.

Në zgjedhjet morën pjesë 15 subjekte politike, gjegjësisht 3 koalicione 12 parti politike. Paraqitje në koalicion pati partia në pushtet LSDM me koalicionin „Mundemi“, partia opozitare VMRO-DPMNE me koalicionin „Përtëritja e Maqedonisë“ dhe koalicioni i Aleancës për Shqiptarët dhe Alternativës. Në garën për mandatet e deputetëve në mënyrë të pavarur u shfaqën : BDI, PDSH, Partia politike E majta- Levica, Integra – Partia konservatore maqedonase, Unioni demokratik qytetar (GDU), MORO – Parti e punës, Partia politike Zëri për Maqedoninë, Maqedonia e bashkuar, Bashkimi socialdemokrat Shkup, Partia jote, Partia politike Demokratët dhe Partia popullore e Romëve.

Për shkak të rrezikut të përhapjes së virusit Qeveria para fillimit të fushatës solli protokolle me të cilat ngjarjet dhe mbledhjet masive ishin të kufizuara, andaj partitë politike ishin të detyruara të përdornin metoda të ndryshme të komunikimit me trupin votues. Në ç ’mënyrë, fokusi i organizimit të mitingjeve masive dhe të mbledhjeve të mëdha u drejtua kah fushatat masive në mediat sociale.

Pas përfundimit të votimit, ueb-faqja e Komisionit shtetëror të zgjedhjeve ishte cak i sulmeve të hakerëve, me çka u prolongua shpallja e rezultateve të zgjedhjeve. Kryetari i atëhershëm, Oliver Derkoski, në konferencën për shtyp deklaroi se Komisioni punon në pajtim me kodin zgjedhor, se caku i hakerëve ishte ueb-faqja, e jo softueri i rezultateve dhe se sulmi është paraqitur në departamentin e krimit kibernetik pranë Ministrisë së punëve të brendshme.⁵⁸

58 „KSHZ – rezultate zgjedhore, mandate, hakime, reaksione dhe vlerësime“, Radio Europa e Lirë, 16 korrik 2020. Në dispozicion në: <https://www.slobodnaevropa.mk/a/%D0%B4%D0%B8%D0%BA-D1%81%D0%B4%D1%81%D0%BC-%D0%B2%D0%BC%D1%80%D0%BE-%D0%B4%D0%BF%D0%BC%D0%BD%D0%B5/30731705.html> (vizita e fundit: 5 prill 2024)

Edhe në këto zgjedhje, si në zgjedhjet parlamentare në vitin 2016, u zhvillua thujtë një „garë e ngushtë“ ndërmjet dy partive më të mëdha të bllokut maqedonas, LSDM dhe VMRO-DPMNE, që fituan numër më të vogël mandatesh të deputetëve në krahasim me zgjedhjet e mëparshme. Koalicioni „Mundemi“, i udhëhequr nga LSDM, fitoi numër më të madh mandatesh – 46 ose 35,89 % nga numri i përgjithshëm i votave. Menjëherë pas saj, me 2 mandate më pak ishte koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, i cili në këto zgjedhje fitoi 44 mandate, që është 34,57 % nga numri i përgjithshëm i votave. Në vendin e tretë në bazë të numrit të mandateve të fituara ishte BDI me 15 deputetë. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa korri një rezultat dukshëm më të mirë nga zgjedhjet e mëparshme, duke marrë 12 mandate deputetësh. Për herë të parë partia politike „Levica“ u përfaqësua në Kuvend me dy mandate të fituara, përderisa PDSH pati rezultat më të dobët nga zgjedhjet e mëparshme dhe arriti të marrë vetëm një mandat deputeti. Partitë dhe koalicionet e tjera të cilat morën pjesë në këto zgjedhje nuk fituan numër të mjaftueshëm votash për të siguruar mandate parlamentare.

Misioni i OSBE/ODIHR vlerësoi se fushata zgjedhore kishte ton negativ, por ishte konkurruese dhe pjesëmarrësit kishin mundësi që t'i përçojnë mesazhet e tyre përkundër kufizimeve të shkaktuara nga pandemia e Kovid-19. LSDM i vlerësoi zgjedhjet si dinjitoze, të lira, demokratike dhe të sigurta. Në anën tjetër, nga VMRO-DPMNE u vu në dukje se gjatë kohës së zgjedhjeve janë bërë presione serioze, ka pasur parregullsi të shumta dhe rryshfet masiv të votuesve. Aleanca dhe Alternativa akuzuan për mbushje të kutive në disa vendvotime. Nga partia politike „Levica“, në anën tjetër, u parashtruan madje 1.982 ankesa në KSHZ, nga të cilat 1.478 u refuzuan me arsyetimin se i kanë dorëzuar pa nënshkrimin e personit të autorizuar, ndërsa të tjerat për mungesë provash.

Më 4 gusht 2020 u mbajt seanca konstitutive në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në të cilën u verifikuan mandatet e 120 përfaqësuesve të sapozgjedhur dhe u verifikua përbërja e re e Kuvendit. Seancën e kryesoi kryetari i mandatit të kaluar, Talat Xhaferi, i cili u zgjodh në të njëjtin muaj me 62 vota „PRO“, për mandat të ri katërvjeçar.⁵⁹ Kuvendi e zgjodhi qeverinë e re nën udhëheqjen e Zoran Zaevit, në të cilën përveç LSDM-së dhe koalicionit morën pjesë edhe BDI dhe BESA.

Më tepër informacione rreth historikut të zgjedhjeve parlamentare nga pavarësia deri më sot mund të gjeni në Doracakun për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2020.⁶⁰


59 „Talat Xhaferi u rizgjodh për kryetar i Kuvendit“, Kanal 5, 22 gusht 2020. Në dispozicion në: <https://kanal5.com.mk/talat-djafერი-reizbran-za-pretsetdatel-na-sobranieto/a435725> (vizita e fundit: 5 prill 2024)

60 Doracak për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2020, botimi i dytë i plotësuar. KAS dhe IDSCS, v. 2020. F. 22-41. Në dispozicion në: https://izbornaarhiva.mk/dokumentacija/priracnik/Priracnik_zaparlamentarni_izbori_2020_ALB.pdf (vizita e fundit më 5 prill 2024)

Jehona e zgjedhjeve parlamentare (1990 – 2020)

Nga të dhënat e të gjitha zgjedhjeve të deritashme parlamentare, nisur nga viti 1990 deri në zgjedhjet e vitit 2020, mund të vërehen ndryshime dinamike në jehonën e votuesve. Zgjedhjet e para parlamentare në vitin 1990 mbeten si zgjedhjet me jehonën më të madhe deri më tani prej 85%. Kufirin e poshtëm të daljes në zgjedhjet parlamentare më tepër se një dekadë e shënuan zgjedhjet e vitit 2006, por zgjedhjet e mëparshme parlamentare në vitin 2020 të zbatuara në kulmin e pandemisë të njëjtin e zhvendosën për 4% më poshtë, gjegjësisht me rekord të ulët prej 52% nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar.⁶¹

Jehona e zgjedhjeve parlamentare në % (1990-2020)



61 Komisioni shtetëror i zgjedhjeve. Arkivi i rezultateve. Në dispozicion në: <https://www.sec.mk/izbori-arhiva/> (vizita e fundit: 5 prill 2024)

2

Sistemi zgjedhor maqedonas për zgjedhjet parlamentare

2. Sistemi zgjedhor maqedonas për zgjedhjet parlamentare⁶²

Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut deputeti **zgjidhet në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira** me votim të fshehtë, me një mandat 4- vjeçar. Në zgjedhjet parlamentare zgjidhen 120–123 deputetë, ndërsa sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, përbërja e Kuvendit mund të jetë prej 120 deri në 140 deputetë.

Deputetët zgjidhen sipas modelit proporcional zgjedhor me lista të mbyllura të kandidatëve, me ç'rast në secilën nga gjashtë njësitë zgjedhore, sipas të cilave është ndarë territori i shtetit, zgjidhen nga 20 deputetë. Secila nga partitë fiton aq vende deputetësh proporcionalisht me numrin e votave për listën e tyre të kandidatëve krahasuar me numrin e votave për listat e tjera të kandidatëve. Shpërndarja e mandateve të deputetëve bëhet me anë të zbatimit të formulës së Dontit. Kandidatët i fitojnë mandatet e tyre në bazë të renditjes sipas së cilës janë përcaktuar në listat e kandidatëve.

Zgjedhjet për deputet mbahen çdo vit të katërt brenda 90 ditëve të fundit të mandatit të përbërjes së mëparshme parlamentare, ose brenda 60 ditëve nga dita e shpërbërjes së Kuvendit. Gjatë zgjedhjeve të përkohshme, të gjitha afatet e kryerjes së veprimeve zgjedhore janë shkurtuar për pesë ditë, përveç afatit të përcaktuar për zhvillimin e fushatës zgjedhore.

Mandati i deputetit mund të ndërpritet para mbarimit të kohës për të cilën është zgjedhur, nëse paraqet dorëheqje, nëse është dënuar për vepër penale për të cilën është caktuar dënim me burg në kohëzgjatje prej më së paku pesë vjet, nëse paraqitet rast i papajtueshmërisë me funksionin deputet, në rast të vdekjes ose nëse me aktvendim të plotfuqishëm është i privuar nga aftësia afariste. Nëse deputetit të zgjedhur nga lista e kandidatëve i ndërpritet mandati, sipas njërës nga këto baza, atëherë për pjesën e mbetur të mandatit vjen në vendin e tij kandidati i radhës nga lista zgjedhore e partisë në të cilën është zgjedhur deputeti. Bën përjashtim nga ky rregull, në qoftë se i ndërpritet mandati deputetes. Në rast të këtillë, në vendin e saj, do të vijë kandidatja e radhës nga lista.

62 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e kodit zgjedhor 58/2024

Përbërja parlamentare e re e Kuvendit konstituohet në seancën e parë e cila mbahet më së voni 20 ditë pas mbajtjes së zgjedhjeve, ndërsa e thërret kryetari në largim. Nëse Kuvendi nuk konstituohet në këto 20 ditë, atëherë deputetët mblidhen vetë dhe e konstituojnë Kuvendin në ditën e njëzetënjtë nga dita e përfundimit të zgjedhjeve në orën 10, ndërsa seancën duhet ta thërrasë deputeti i zgjedhur më në moshë sipas viteve.

Në afat prej dhjetë ditëve pas konstituimit të përbërjes së re të Kuvendit, Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut e ka për detyrë që t'ia besojë mandatin për formimin e Qeverisë së re kandidatit (mandatarit) nga partia ose partitë të cilat kanë shumicë të deputetëve. Mandatari në afat prej 20 ditëve nga dita e besimit të mandatatit, Kuvendit ia parashtron programin dhe e propozon përbërjen e Qeverisë. Pataj deputetët me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve e zgjedhin Qeverinë.

Komisioni shtetëror i zgjedhjeve (KSHZ), së bashku me komisionet komunale zgjedhore (KKZ) dhe Komisionin zgjedhor të Qytetit të Shkupit, këshillat zgjedhorë (KZ) për votimin në vend dhe në përfaqësitë diplomatike-konsullore (PDK) të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë organet zgjedhore të obliguara për zbatimin e zgjedhjeve parlamentare.

Komisioni shtetëror i zgjedhjeve përbëhet nga shtatë anëtarë të cilët i zgjedh Kuvendi, me propozimin e partive, me dy të tretën e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me mandat pesëvjeçar nga dita e zgjedhjes. Në kompetencat e KSHZ-së hyn edhe shpallja e Listës zgjedhore, e cila duhet të vihet publikisht në dispozicion të qytetarëve në afat prej 15 ditë nga data e shpalljes së zgjedhjeve.⁶³ Shikimi publik i Listës zgjedhore zgjat 20 ditë. KSHZ-ja e ka në dispozicion të saj shërbimin profesional-administrativ dhe organizativ-teknik. KSHZ-ja është përgjegjëse që t'i informojë dhe t'i edukojë qytetarët për mënyrën e votimit dhe për realizimin e të drejtës zgjedhore.

Të drejtë vote ka çdo shtetas maqedonas që i ka mbushur 18 vjet, që është i aftë për punë dhe ka vendbanim të përhershëm në njësinë zgjedhore ku bëhet zgjedhja. Votimi është i fshehtë dhe askush nuk ka të drejtë ta thërrasë zgjedhësin në përgjegjësi për shkak të votimit, as, dhe, të kërkojë prej tij që të tregojë se për kë ka votuar ose pse nuk ka votuar.

63 Shikimi i listës zgjedhore. Qasje në: <https://www.sec.mk/uvid-vo-izbirachki-spisok/> (Qasur më: 16 prill 2024)

Të drejtën e kandidimit për deputet e ka çdo qytetar në moshë madhore dhe i aftë për punë. Në atë rast, një kandidat mund të propozohet vetëm nga një listë, ndërsa një parashtrues i listës mund të parashtrorë vetëm një listë të kandidatëve për deputetë. Në listat e kandidatëve për deputetë, nevojitet së paku 40 % të kandidatëve t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar, me ç'rast për çdo tre vende së paku një vend i takon gjinisë më pak të përfaqësuar dhe në mënyrë plotësuese së paku edhe një vend në çdo 10 vende.

Të drejtën e parashtrimit të listave të kandidatëve për deputetë e kanë partitë politike të regjistruara në mënyrë të pavarur, koalicionet, si dhe grupi e zgjedhësve. Sipas ndryshimeve të fundit ligjore të muajit mars 2024, grupi i zgjedhësve së bashku me parashtrimin e listës së kandidatëve nevojitet të bashkëngjeshë edhe nënshkrimet e së paku 1% të zgjedhësve të regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore të njësisë zgjedhore.

Funksioni deputet në Kuvend është i papajtueshëm me funksionin president i Republikës, kryetar i Qeverisë, ministër, gjykatës, prokuror publik, avokat i shtetit, avokat i popullit dhe me bartës të tjerë të funksioneve të cilat i zgjedh ose i emëron Kuvendi ose Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Funksioni deputet, gjithashtu, është i papajtueshëm me funksionin kryetar i komunës ose anëtar i këshillit të vetëqeverisjes lokale, me kryerjen e punëve profesionale dhe administrative në organet e administratës shtetërore, me kryerjen e veprimtarisë ekonomike ose të veprimtarisë tjetër profitabile, me anëtarësimin në këshillat drejtues të ndërmarrjeve publike, institucioneve publike, fondeve, agjencive, enteve dhe në subjekte të tjera juridike, si dhe me zgjedhjen e përfaqësuesit të kapitalit shtetëror dhe shoqëror në shoqëritë tregtare.

Fushata zgjedhore është prezantimi publik i kandidatëve dhe programeve të tyre në periudhën parazgjedhore për zgjedhje të caktuara. Fushata zgjedhore për zgjedhjet parlamentare fillon 20 ditë para ditës së zgjedhjeve, gjegjësisht më 18 prill në orën 00:00 dhe përfundon më 6 maj në orën 24:00.⁶⁴ Dita para mbajtjes së zgjedhjeve, gjegjësisht data 7 maj, është ditë e heshtjes parazgjedhore kur kandidatët nuk guxojnë të zhvillojnë fushatë zgjedhore, ndërsa mediat publike nuk guxojnë të bëjnë prezantimin publik të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor.

⁶⁴ Kalendar i afateve për kryerjen e veprimeve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Komisioni shtetëror i zgjedhjeve. Qasur në: https://mojotizbor.mk/images/2024/Rokovnik_za_Parlamentarni_izbori_2024_godina_-_MK.pdf (Vizita e fundit 16 prill 2024)

Organizatorët e fushatës zgjedhore duhet të hapin llogari bankare të veçantë dhe vetëm përmes saj mund të financohet fushata zgjedhore dhe nuk mund të shfrytëzohet për dedikime tjera. Në atë rast, fushata mund të financohet nga mjetet nga llogaria e rregullt e partisë politike, nga anëtarësia e partive politike, nga donacionet dhe kreditë e dedikuara për fushatën zgjedhore. Pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore guxojnë të shpenzojnë më së shumti deri në 110 denarë për zgjedhës të regjistruar në njësinë zgjedhore për të cilën e ka parashtruar listën e kandidatëve.

Fushatat zgjedhore nuk mund të financohen me mjete nga buxhetet e komunave dhe Qytetit të Shkupit, nga fonde të ndërmarrjeve dhe institucioneve publike, nga fonde të shoqatave të qytetarëve, bashkësive fetare, grupeve dhe fondacioneve fetare, nga fonde të qeverive të huaja dhe të institucioneve ndërkombëtare, organeve dhe organizatave të shteteve të jashtme dhe subjekteve të huaja, si dhe nga fonde të ndërmarrjeve me kapital të përzier ku dominon kapitali i huaj, por edhe nga burime të paidentifikuara. Radiodifuzerët, mediat e shtypit dhe mediat elektronike (portalet e internetit), si dhe personat e tyre të ndërlidhur nuk guxojnë të financojnë partitë politike ose të japin donacione për to ose për kandidatët e pavarur, duke i përfshirë edhe fushatat.

Si pjesë e ndryshimeve ligjore të vendosura pas arritjes së Marrëveshjes së Përzihinos⁶⁵, nga dita e shpalljes së zgjedhjeve dhe deri në përfundimin e tyre, radiodifuzerët, mediat e shtypit dhe mediat elektronike (portalet e internetit) nuk guxojnë të publikojnë reklama të cilat financohen nga buxheti i shtetit, nga buxhetet e komunave dhe Qytetit të Shkupit dhe nga të gjithë personat e tjerë të cilëve me ligj u është besuar ushtrimi i autorizimeve publike.

Gjatë fushatës, të gjitha mediat dhe servisi radiodifuziv publik e kanë për detyrë të mundësojnë qasje të barabartë për prezantimin e programeve zgjedhore dhe kandidatëve në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe të balancuar. Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizive (ASHMAA) e ka për detyrë të monitorojë prezantimin zgjedhor të partive dhe të kandidatëve dhe shërbimin programor të radiodifuzerëve dhe e ka për detyrë të fillojë procedurë kundërvajtëse nëse e njëjta nuk respektohet.

Servisi radiodifuziv publik është i obliguar, pa kompensim, në bashkëpunim me Komisionin shtetëror të zgjedhjeve, t'i informojë qytetarët për mënyrën dhe teknikën e informimit dhe të emetojë informacione të tjera lidhur me procesin zgjedhor si dhe të sigurojë informim të paanshëm. Me ndryshimet e Kodit zgjedhor

65 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e kodit zgjedhor 196/2015

sipas Marrëveshjes së Përzhinos, 30 % e programit duhet t'u referohet ngjarjeve nga vendi dhe bota, 30 % aktiviteteve të partive të përfaqësuara në pushtet, 30 % të kohës aktiviteteve të partive në opozitë dhe 10 % të kohës aktiviteteve të partive politike jashtëparlamentare dhe për kandidatët e pavarur.

Mediat gjatë kohës së fushatës zgjedhore të cilat i përfshijnë zgjedhjet mund të emetojnë gjithsej nëntë minuta dhe tridhjetë sekonda kohë shtesë për reklamimin e programit të emetuar në kohë reale, ekskluzivisht për reklamimin e paguar politik. Nga këto nëntë minuta e gjysmë, gjithsej katër minuta mund të ndahen për dy partitë më të mëdha politike të pushtetit, katër minuta për dy partitë më të mëdha politike të opozitës, një minutë për partitë politike në Kuvend të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë nuk kanë marrë numër të mjaftueshëm deputetësh për të formuar grup parlamentar, si dhe tridhjetë sekonda për partitë politike të cilat nuk janë të përfaqësuara në Kuvend. Këtë vit, për shkak të mbajtjes së zgjedhjeve të dyfishta, ekziston mundësia brenda një ore të dhënë partitë të reklamohen gjithsej 19 minuta. Më parë, kishte një rast të këtillë në fushatën zgjedhore për zgjedhjet e dyfishta në vitin 2014, atëherë partitë u dakorduan që promovimi të kufizohet në 15 minuta brenda një ore.⁶⁶

Sipas Kodit zgjedhor, shpenzimet për publikimin e reklamimit të paguar politik i shlyen Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, në bazë të faturës së dorëzuar nga radiodifuzerët, mediat e shtypit dhe mediat elektronike (portalet e internetit).

Të drejtën për të vëzhguar zgjedhjet e kanë vëzhguesit e akredituar, për ç'gjë autorizimin e lëshon KSHZ-ja. Akreditimin për vëzhgues mund ta marrin organizatat qytetare vendore dhe të huaja të cilat janë regjistruar të paktën një vjet para mbajtjes së zgjedhjeve, ndërsa në statutin e tyre e kanë përfshirë parimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Përfaqësuesit e vendeve të huaja, gjithashtu, mund t'i vëzhgojnë zgjedhjet. Përfaqësuesit e autorizuar të paraqitësve të listave kanë të drejtë të caktojnë përfaqësuesin e tyre, i cili do të ndjekë punën e organeve zgjedhore.⁶⁷

Më tepër informacion rreth sistemit zgjedhor maqedonas për zgjedhjen e deputetëve në Kuvend mund të gjeni në Doracakun për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2020.⁶⁸

66 „Zgjedhjet 2024: EPP-ja partiake me përmasa epike“. Prizma, 8 shkurt 2024. Qasur në: <https://prizma.mk/izbori-2024-partisko-epp-od-epski-razmeri/> (vizita e fundit: 26 mars 2024).

67 Tabela e vëzhguesve të akredituar për Zgjedhjet për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Komisioni shtetëror i zgjedhjeve. Qasur në: <https://www.sec.mk/parlamentarni-izbori-2024/#tab-id-26> (Vizita e fundit: 16 prill 2024)

68 Doracak për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2020, botim i dytë i plotësuar. KAS dhe IDSCS, v. 2020. F. 43-56. Qasur në: https://izbornaarhiva.mk/dokumentacija/priracnici/Priracnik_za_parlamentarni_izbori_2020_ALB.pdf (vizita e fundit 05 prill 2024)



3

**Njësitë
zgjedhore**

3. Njësitë zgjedhore

Zgjedhjet e rregullta parlamentare të cilat do të mbahen më 8 maj të vitit 2024 do të organizohen në nivelin e gjashtë njësive zgjedhore (NjZ) në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Drejtëpërdrejt para mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare në vitin 2002 u miratua Ligji për njësitë zgjedhore⁶⁹, me të cilin u përcaktuan 6 NjZ, me të cilat territori i shtetit ndahet në rajone zgjedhore me numër afërsisht të barabartë të votuesve të regjistruar. Në pajtim me ndryshimet e Kodit zgjedhor të vitit 2016⁷⁰, numri i zgjedhësve në një NjZ mund të ndryshojë nga minus 5 deri në plus 5 përqind në raport me numrin mesatar të zgjedhësve, që është rreth 292 000 për njësi zgjedhore. Në secilën prej këtyre 6 NjZ zgjidhen nga 20 deputetë në Kuvend sipas parimit proporcional, gjegjësisht 120 nga gjithsej 123 deputetë.

Para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vitin 2011 u bënë ndryshime në Kodin zgjedhor⁷¹, me të cilat për herë të parë u mundësua që të votojnë edhe shtetasit maqedonas jashtë kufijve të vendit. Votimi jashtë shtetit zhvillohej në tre njësi zgjedhore sipas modelit të shumicës. Në atë rast, njësia zgjedhore 7 përfshinte Evropën dhe Afrikën, njësia zgjedhore 8 përfshinte Amerikën Veriore dhe Jugore dhe njësia zgjedhore 9 përfshinte Azinë dhe Australinë. Me ndryshimet ligjore të parapara me Marrëveshjen e Përzahinos u vendos vetëm një njësi zgjedhore jashtë kufijve shtetërorë, gjegjësisht njësia zgjedhore 7 për Evropë, Afrikë, Amerikë Veriore, Amerikë Jugore, Australi dhe Azi, ku sipas modelit proporcional zgjidhen tre deputetë.⁷² Zgjedhja e këtyre deputetëve kushtëzohet me marrjen e së paku të po aq numri votash me të cilat zgjidhet deputeti me numër më të vogël votash në njësitë zgjedhore në shtet. Nëse në njësinë e shtatë zgjedhore asnjë nga listat nuk i merr votat e nevojshme, nuk zgjidhet asnjë deputet. Shtetasit maqedonas jashtë kufijve të vendit votojnë në përfaqësitë diplomatike – konsullore (PDK) dhe në zyrat konsullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

69 Ligji për njësitë zgjedhore për zgjedhje të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, „Gazeta zyrtare“, nr. 43 më 26 qershor 2002

70 Kodi zgjedhor (propozimi i tekstit të konsoliduar), version jozyrtar i përpiluar nga Shërbimi profesional i Komisionit shtetëror të zgjedhjeve („Gazeta zyrtare“, nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19, 98/19 dhe 42/20)

71 Kodi zgjedhor (tekst i spastruar), „Gazeta zyrtare“, nr.54 më 14 prill 2011

72 Kodi zgjedhor (tekst i spastruar), version jozyrtar i përpiluar nga Shërbimi profesional i Komisionit shtetëror të zgjedhjeve, („Gazeta zyrtare“, nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16 dhe 99/16).

Numri i vendvotimeve në vend për këto zgjedhje të rregullta parlamentare është 3.360. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2020 numri i vendvotimeve ishte 3.478, gjegjësisht 46 më pak vendvotime sesa në zgjedhjet e mëparshme në vitin 2016. Në një vendvotim nuk mund të votojnë më shumë se 1.000 votues.

Në shkurt të vitit 2020 në prag të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare u votuan ndryshimet shtesë të Kodit zgjedhor, me të cilat bëhet ndërhyrje në NjZ të territorit të vendit. Në pajtim me ndryshimet e sapokrijuara, u bë ndryshimi i dy njësive zgjedhore – NjZ 5 dhe NjZ 6. Më konkretisht, Komuna e Dibrës me 16 vendvotime dhe Komuna e Mavrovës dhe Rostushës me 30 vendvotime nga NjZ 5 kaluan në kuadrin e kufijve të NjZ 6.⁷³ Ndryshimi i këtillë i njësive zgjedhore vjen nga rekomandimet se një njësi zgjedhore nuk guxon të ndryshojë në numrin e votuesve të njësive zgjedhore fqinje më tepër se kufiri +5 %.⁷⁴

Njësiti zgjedhore



NjZ 1 e përfshin një pjesë të kryeqytetit të Shkupit dhe një pjesë të pjesëve qendrore të shtetit, gjegjësisht komunat e Shkupit: Aerodrom, Karposh, Kisella Vodë, Qendër, një pjesë të komunës së Çairit, Saraj, Sopishtë, Makedonski Brod dhe Studeničan. Sipas përkatësisë etnike të popullsisë, pjesa e shumicës së votuesve janë maqedonas etnik. Në zgjedhjet e fundit parlamentare në vitin 2020, në këtë njësi zgjed-

73 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e kodit zgjedhor, „Gazeta zyrtare“ nr. 58, më 11 mars, v. 2024

74 “Në moment të fundit do të ndryshohen kufijtë e dy njësive zgjedhore” 360 shkallë, 15 shkurt, 2020 <https://360stepeni.mk/vo-posleden-moment-ke-se-menuvaat-granitsite-na-dve-izborni-edinitsi/> (vizita e fundit: 9 prill 2024)

hore u regjistruan 309.210 votues, të shpërndarë nëpër gjithsej 590 vendvotime. Të drejtën zgjedhore e shfrytëzuan 164.287 votues, gjegjësisht 53,16%, që rezultoi me shpërndarjen si në vijim të mandateve në njësinë zgjedhore: Koalicioni Mundemi i udhëhequr nga LSDM– 8 mandate, VMRO-DPMNE dhe Koalicioni – 7 mandate, BDI – 2 mandate, Aleanca për Shqiptarët – 2 mandate, ndërsa partia „Levica” mori një mandat dhe për herën e parë u bë pjesë e pushtetit legjislativ.

NjZ 2 e përfshin, gjithashtu, një pjesë të kryeqytetit të Shkupit dhe një pjesë të pjesëve veriore të shtetit me një përbërje të barabartë të popullsisë, maqedonas etnik, shqiptarë, ndërsa janë të përfaqësuar edhe serbët dhe romët. Në këto NjZ hyjnë komunat e Shkupit: Butel, Gazi Babë, Gjorçe Petrov, një pjesë të Komunës së Çairit, Shuto Orizarë, Haraçinë, një pjesë të Kumanovës, Lipkovë, një pjesë të Staro Nagoriçanit dhe Çuçer Sandevës. Në NjZ 2 në v. 2020 sipas Komisionit shtetëror të zgjedhjeve kishte 319.820 votues, nga të cilët 158.804 (49,65%) dolën në votim në gjithsej 433 vendvotime në territorin e njësisë zgjedhore. Në NjZ 2 në zgjedhjet e vitit 2020 VMRO-DPMNE dhe Koalicioni fitoi 7 vende deputetësh, Koalicioni Mundemi fituan 7 vende deputetësh, BDI fitoi 3 vende deputetësh, kurse Aleanca për Shqiptarët fitoi, gjithashtu, 3 vende deputetësh.

NjZ 3 i përfshin pjesët e pjesëve qendrore, lindore, verilindore të shtetit. Kjo NjZ i përfshin komunat: Berovë, Veles, Vinicë, Gradsko, Dellçevë, Zelenikovë, Zërnovc, Ilinden, Karabinc, Koçanë, Kratovë, Kriva Pallankë, një pjesë të Kumanovës, Llozovë, Makedonska Kamenicë, Petrovec, Pehçevë, Probishtip, Rankovcë, Sveti Nikollë, një pjesë të Staro Nagoriçanit, Çashkë, Çeshinovë – Obleshevë dhe Shtip. Dominuese është popullsia e përkatësisë etnike maqedonase. Sipas të dhënave zyrtare të Komisionit shtetëror të zgjedhjeve, në këtë njësi zgjedhore janë regjistruar 278.511 votues të cilët të drejtën e vet zgjedhore e realizojnë në 668 vendvotime. Në vitin 2020, dalja në NjZ 3 shënon 58,4%, gjegjësisht 162.648 votues, ku VMRO-DPMNE dhe Koalicioni fituan 10 mandate deputetësh, pas tyre ishte Koalicioni Mundemi me 9 mandate të fituara, kurse në këtë njësi zgjedhore partia „Levica” e fitoi mandatin e dytë nga gjithsej dy vende deputetësh në këto zgjedhje.

NjZ 4 e përfshin territorin e rajonit juglindor të shtetit. Në këtë NjZ përfshihet një pjesë e qytetit të Manastirit, Bogdanci, Bosileva, Vallandova, Vasileva, Gjevgjelia, Demir Kapija, Dojrani, Kavadari, Konçe, një pjesë e Krivogashtanit, Mogilla, Negotina, Novaci, Novo Sella, Prilepi, Radovishi, Rosomani dhe Strumica. Në këtë pjesë dominon popullsia e përkatësisë etnike maqedonase. NjZ 4 ka 615 vendvotime në të cilat të drejtën zgjedhore në vitin 2020 e shfrytëzuan gjithsej 282.506 persona, ose 60,77% të gjithë votuesve të regjistruar. Në këtë NjZ VMRO-DPMNE dhe Koalicioni edhe Koalicioni Mundemi fituan me nga 10 vende deputetësh në zgjedhjet e vitit 2020.

NjZ 5 e përfshin territorin e pjesës jugperëndimore të shtetit. Atij i takon një pjesë e qytetit të Manastirit, Vevçani, një pjesë e Dibrës, Debarca, Demir Hisari, Dollneni, një pjesë e Kërçovës, një pjesë e Krivogashtanit, Krusheva, Ohri, Pllasnica, Resnja, Struga dhe Qendër Zhupa. Shumica e popullsisë janë të përkatësisë etnike maqedonase, por një pjesë të konsiderueshme e përfaqësojnë edhe votuesit e përkatësisë etnike shqiptare. Në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2020 në NjZ 5 u regjistruan 314.489 votues të cilët votuan në 776 vendvotime. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020 dalja ishte 50,92%, gjegjësisht gjithsej votuan 160.146 zgjedhës. Mandatet i fituan VMRO-DPMNE – 8, Koalicioni Mundemi – 8, BDI – 3 dhe Aleanca për Shqiptarët – 1.

NjZ 6 e përfshin territorin veriperëndimor të shtetit. Këtu bëjnë pjesë Bogovina, Bërvenica, Vrapçishti, Gostivari, një pjesë e Dibrës, Zhelina, Jegunovci, një pjesë e Kërçovës, Mavrova dhe Rostusha, Tearca dhe Tetova. Në këtë pjesë të shtetit dominon popullsia e përkatësisë etnike shqiptare. Në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2020 në NjZ 6 u regjistruan 309.727 votues të cilët votuan në 396 vendvotime, ndërsa jehona ishte 40,74%, gjegjësisht 126.175 votues. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2020 në këtë NjZ më së shumti mandate fitoi BDI – 7, në vendin e dytë ishte Aleanca për Shqiptarët me 6 mandate, pastaj Koalicioni Mundemi – 4 mandate, VMRO-DPMNE dhe Koalicioni – 2, dhe PDSH e cila fitoi një mandat.

NjZ 7 i përfshin të gjithë shtetasit maqedonas të cilët jetojnë ose ndodhen me qëndrim të përkohshëm jashtë shtetit, gjegjësisht në shtetet në Evropë, Afrikë, Amerikë Veriore, Amerikë Jugore, Australi dhe Azi. Në këtë njësi zgjedhore shtetasit maqedonas jashtë kufijve të vendit mund të zgjedhin 3 deputetë sipas modelit proporcional. Mandatet e deputetëve shpërndahen sipas formulës së Dontit. Që të mund të votojnë jashtë shtetit, shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët ndodhen me punë të përkohshme ose vendqëndrim jashtë shtetit me paraqitjen e vendbanimit të fundit në vend para zgjedhjeve duhet të paraqiten në zyrën përkatëse PDK/konsullore. Në atë rast, regjistrohen në certifikatë të veçantë të Listës zgjedhore. Paraqitja mund të bëhet me dorëzimin e kërkesës e cila duhet të jetë e nënshkruar me dorë ose të jetë dërguar përmes postës elektronike. Numri i vendvotimeve jashtë shtetit i nënshtrohet ndryshimit, ndërsa vendvotimi nuk do të caktohet për PDK/zyrë konsullore ku do të paraqiten për të votuar më pak se 10 votues.

Në zgjedhjet e fundit parlamentare në vitin 2020 nuk u zbatua votimi në përfaqësitë diplomatike-konsullore dhe zyrat konsullore, meqë u parashtuan listat e kandidatëve për deputetë në Kuvend.⁷⁵ Sipas kodit zgjedhor⁷⁶, votimi jashtë kufijve të

75 Vendim për moszbatimin e votimit në PDK, 17 mars 2020, Në dispozicion në: <https://www.sec.mk/parlamentarni-izbori-2020/#tab-id-18> (vizita e fundit: 26 mars 2024)


76 Ligji për ndryshime dhe plotësime të kodit zgjedhor, „Gazeta Zyrtare“ nr. 58 më 11 mars, v. 2024

vendit zbatohet nëse numri i zgjedhësve është i barabartë apo më i madh nga numri më i vogël i votuesve me të cilin në zgjedhjet e kaluara është zgjedhur deputeti nga territori i shtetit. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2016, sipas modelit të Don-tit për llogaritjen e mandateve, deputeti i fundit i NjZ 6 ku dalja ishte më e vogël, u zgjodh me rreth 6.500 vota.⁷⁷ Për zgjedhjet parlamentare në vitin 2020, 6.096 kërkesa të zgjedhjeve në IE 7 u pranuan, kurse 1.439 kërkesa u refuzuan për parregullsi. Numri i zgjedhësve të paraqitur nuk e tejkaloi numrin e votave me të cilat u zgjodh deputeti nga NjZ 6 në vitin 2016. Në pajtim me këto shifra, përbërja parlamentare e zgjedhur në zgjedhjet në vitin 2020 nuk kishte deputetë nga NjZ 7.

Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2024 sërish nuk do të zbatohet votimi në përfaqësitë diplomatike-konsullore dhe zyrat konsullore sepse nuk u paraqitën numër i mjaftueshëm qytetarësh për votim.⁷⁸

77 „S’është e sigurt se vallë do të votojë diaspora“ 360 Shkallë, 20 mars 2020, Në dispozicion në: <https://360stepeni.mk/neizvesno-e-dali-ke-glasa-dijasporata/vizita-e-fundit>: 26 mars 2024)

78 Radio Europa e Lirë. (2024, 27 mars), „Gjithsej 2.571 qytetarë jashtë shtetit do të mund të votojnë në zgjedhjet presidenciale.“ <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32880067.html> (në dispozicion më 29 mars 2024)



4

Pasqyrë e pjesëmarrësve në zgjedhjet parlamentare 2024

4. Pasqyrë e pjesëmarrësve në zgjedhjet parlamentare 2024

Në pajtim me kalendarin e afateve për kryerjen e veprimeve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve parlamentare të miratuar nga KSHZ-ja, deri në afatin e fundit, më 2 prill 2024, gjithsej 17 subjekte politike i dorëzuan listat e kandidatëve për zgjedhjen e deputetëve. Pas shqyrtimit të fletëparaqitjeve, KSHZ-ja mori vendim për pranimin e 17 fletëparaqitjeve. Që do të thotë se në këto zgjedhje 1.815.350 qytetarë me të drejtë vote do të kenë mundësi të votojnë për 17 subjekte politike, gjegjësisht për 11 parti politike, 5 koalicione dhe një listë të pavarur të grupit të zgjedhësve me 84 lista të kandidatëve, që është gjashtë më shumë krahasuar me 78 listat e kandidatëve të parashtruara për zgjedhjet parlamentare në vitin 2020.

Pasqyrë e listave të kandidatëve për gjashtë njësitë zgjedhore

Numri rendor	Partia/koalicioni	NZ 1	NZ 2	NZ 3	NZ 4	NZ 5	NZ 6
1	Koalicioni i së ardhmes evropiane - LSDM	✓	✓	✓	✓	✓	✓
2	Koalicioni Maqedonia Jote – VMRO-DPMNE	✓	✓	✓	✓	✓	✓
3	Koalicioni Fronti Evropian - BDI	✓	✓	✓	✓	✓	✓
4	Koalicioni Vlen	✓	✓	✓	✓	✓	✓
5	E majta - Levica	✓	✓	✓	✓	✓	✓
6	Avaja – Mjaft më!	x	x	✓	✓	✓	✓
7	Partia politike Demokratët	✓	✓	✓	✓	✓	✓
8	Partia politike E djathta	✓	✓	✓	✓	x	x
9	Partia politike Maqedonia e Bashkuar	✓	✓	✓	✓	✓	x
10	Lëvizja ZNAM (E di) – Për Maqedoninë tonë	✓	✓	✓	✓	✓	✓
11	Era e Tretë Maqedone - Sovranët	✓	✓	✓	✓	✓	✓
12	Opsioni i reformës së rindërtimit të Maqedonisë – Partia e Punës	✓	x	x	x	✓	x
13	Partia politike Alternativa e re	✓	✓	✓	✓	x	x
14	Partia politike Rodina Maqedoni	✓	✓	✓	✓	✓	✓
15	Partia Jote	✓	✓	✓	✓	x	x
16	Koalicioni Trimërisht për Maqedoninë - GROM	✓	✓	✓	✓	✓	✓
17	Grup zgjedhësish Gjyla Çeliku	x	x	x	x	x	✓

Në këtë doracak do të prezantohen të gjitha partitë politike, koalicionet, si dhe bartësit e listave të kandidatëve që do të marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare. Partitë parlamentare, LSDM me koalicionin, VMRO-DPMNE me koalicionin, BDI me koalicionin, koalicioni „Vlen“ dhe E majta - Levica⁷⁹, do të prezantohen më hollësisht.

Partitë politike, koalicionet dhe bartësit e listave të kandidatëve⁸⁰

Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë⁸¹ dhe koalicioni „Për të ardhmen evropiane“



Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë deklarohet si parti në të majtë të qendrës, me origjinë ideologjike socialdemokrate. Është themeluar në Kongres, më 21 prill 1991, si pasardhës ligjor i Lidhjes së Komunistëve të Maqedonisë – Partia për transformim demokratik (LKMPD). Po në atë vit, partia e ndryshoi emrin në LSDM dhe ideologjinë nga komuniste në socialdemokrate. Ka marrë pjesë në të gjitha zgjedhjet parlamentare dhe lokale nga pavarësia deri më sot. Në vitin 1992, pas shpërbërjes së Qeverisë së parë të ekspertëve, LSDM, megjithëse nuk e kishte shumicën në Kuvend, fitoi mandatin dhe e formoi Qeverinë e parë politike të Republikës së Maqedonisë. Në periudhën e viteve 1994 - 1998 partia e kishte shumicën në Kuvend, atëbotë kur bashkë me partnerët e saj të koalicionit, në zgjedhjet e vitit 1994, që u bojkotuan nga opozita në rrethin e dytë, fitoi 85 vende deputetësh. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 1998, LSDM e humbi pushtetin duke marrë vetëm 27 vende deputetësh. LSDM është partia më e madhe opozitare deri në vitin 2002, kur i fitoi përsëri zgjedhjet me 60 vende deputetësh së bashku me partnerët e saj të koalicionit dhe mbetet në pushtet deri në zgjedhjet e ardhshme parlamentare në vitin 2006. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2006 koalicioni i LSDM-së fitoi 32 vende deputetësh. Nga atëherë deri në vitin 2016, LSDM është në opozitë, meqë humbi në katër cikle të tjera zgjedhore,


79 Renditja e partive politike të përfaqësuara në Kuvend është sipas numrit të mandateve parlamentare të fituara në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020. Renditja e partive dhe koalicioneve të tjera është sipas rendit alfabetik.

80 Logot e partive, biografitë dhe fotografitë të bartësve të listave të kandidatëve janë marrë nga faqet e internetit të partive përkatëse, institucioneve publike të caktuara dhe nga Fejsbuk profilet zyrtare të kandidatëve.

81 Doracak për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2020 (botim i dytë i plotësuar), Fondacioni Konrad Adenauer dhe Instituti për demokraci „Societas Civilis“ – Shkup. Qasur në: https://izbor-naarhiva.mk/dokumentacija/priracnik/Priracnik_zaparlamentarni_izbori_2020_ALB.pdf (vizita e fundit: 4 prill 2024)

në 2008, 2011, 2014 dhe 2016. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2008 së bashku me koalicionin fitoi 27 vende deputetësh, ndërsa në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2011, LSDM me koalicionin fitoi 42 vende deputetësh. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014, LSDM fitoi 27 vende deputetësh, ndërsa koalicioni gjithsej 34 vende deputetësh. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2016, LSDM dhe koalicioni fituan gjithsej 49 vende deputetësh, që është për dy më pak se VMRO-DPMNE-ja, por arriti të formojë shumicën parlamentare së bashku me BDI-në. Në zgjedhjet e fundit parlamentare në vitin 2020, LSDM dhe koalicioni „Mundemi“ fituan gjithsej 46 mandate dhe arriti ta sigurojë shumicën parlamentare dhe ta formojnë Qeverinë.⁸²

Kryetar i partisë nga pavarësia e shtetit dhe nga transformimi prej LKM-PTD në LSDM në vitin 1991 e deri në vitin 2004 është Branko Červenkovski. Tërhiqet nga kjo pozitë për shkak të fitores në zgjedhjet e jashtëzakonshme presidenciale në vitin 2004 dhe bëhet President i shtetit. Në Kongresin e jashtëzakonshëm të LSDM-së, në nëntor të vitit 2004, kryetar u zgjodh Vllado Buçkovski, i cili drejtoi partinë deri në humbjen e pësuar në zgjedhjet e vitit 2006. Pas zgjedhjeve, Buçkovskit iu votua mosbesimi dhe në Kongresin e jashtëzakonshëm, në nëntor të vitit 2006, kryetar i partisë u zgjodh Radmilla Sheqerinska. Në pozitën e kryetarit të LSDM-së, Radmilla Sheqerinska mbeti deri në qershor të vitit 2008, kur paraqiti dorëheqje të paravokueshme për shkak të humbjes në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Në shtator 2008, në Kongresin e 8-të të partisë, u.d. zgjidhet Zoran Zaev. Në vitin 2009, pas skadimit të mandatit presidencial, në Kongresin e partisë përsëri në krye të LSDM-së kthehet Branko Červenkovski. Ai është drejtues i partisë deri në vitin 2013, kur tërhiqet nga pozita, ndërsa në vendin e tij përsëri zgjidhet Zoran Zaev. Në vitin 2021, në zgjedhjet e jashtëzakonshme brendapartiake zgjidhet kryetari aktual i partisë Dimitar Kovačevski.⁸³



Pas zgjedhjeve të fundit lokale në vitin 2021, LSDM e ka pushtetin në 16 prej gjithsej 80 komuna.⁸⁴

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024 LSDM e udhëheq koalicionin

82 Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, Zgjedhjet 2020. Qasur në: <https://izbornaarhiva.mk/> (vizita e fundit 4 prill 2024)

83 Dimitar Kovačevski është kryetari i ri i LSDM-së me 37.649 vota të fituara. Qasur në: <https://sds.org.mk/pres-konferencii/38964> (vizita e fundit: 4 prill 2024)

84 Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, Zgjedhjet 2021. Qasur në: <https://izbornaarhiva.mk/> (vizita e fundit 4 prill 2024)

„Për të ardhmen evropiane“, në të cilin janë përfshirë edhe: Partia liberale demokratike, Partia e Re Socialdemokrate, VMRO Partia Popullore, Partia për Lëvizjen e Turqve, Lidhja Demokratike e Vllahëve, Lidhja e Romëve të Maqedonisë, Pala e Aksionit Demokratik të Maqedonisë, Përtëritja Demokratike e Maqedonisë, E djathta, Partia e Pensionistëve, Partia për Prosperitetin Demokratik të Romëve, Partia për progres shoqëror dhe ekonomik dhe Pala Serbe në Maqedoni.

Koalicioni „Për të ardhmen evropiane“ do të garojë me listat e veta të kandidatëve në gjashtë njësi zgjedhore.

Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë

rr. „Bihacka“ nr.8 1000 Shkup

web@sdsd.org.mk

www.sdsd.org.mk

Bartësit e listave të kandidatëve të LSDM-së dhe të koalicionit „Për të Ardhmen Evropiane“⁸⁵



NjZ 1 – Dimitar Kovačevski është kryetar i LSDM-së, ish-kryeministër dhe profesor inordinar në Universitetin Kolegji Amerikan Shkup. Diplomoi dhe magjistroi në Fakultetin e Ekonomisë pranë Universitetit „Sh. Kirili dhe Metodi“ në Shkup. Studimet e doktoratës i mbaroi në Fakultetin e ekonomisë në Malin e Zi. Kovačevski ka qenë zëvendësministër për financa në vitin 2020. I lindur në vitin 1974 në Kumanovë.

85 Komisioni shtetëror i zgjedhjeve. Listat e kandidatëve sipas njësisve zgjedhore - prill 2024. Qasur në: Листа на кандидати по политичка партија (sec.mk) (vizita e fundit: 15 prill 2024)



NjZ 2 – Oliver Spasovski është ish-ministër i punëve të brendshme dhe kryeministër në Qeverinë teknike përgjegjëse për zbatimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në qershor të vitit 2020. Më parë ka mbajtur katër herë postin e ministrit të brendshëm, nga 11 nëntor 2015 deri më 18 maj 2016, nga 2 shtator 2016 deri më 29 dhjetor 2016, nga 31 maj 2017 deri në pranimin e mandatit për formimin e qeverisë teknike më 3 janar 2020 dhe nga 1 shtator 2020 deri më 29 janar 2024. Spasovski u zgjodh deputet në Kuvend në dy mandate (2006 - 2008 dhe 2011 - 2014). Diplomoi dhe magjistroi në

Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit „Sh. Kirili dhe Metodi“ në Shkup. I lindur në vitin 1976 në Kumanovë.



NjZ3 – Sanja Llukarevska është drejtoreshë e Drejtorisë për të hyra publike dhe është zëvendëskryetare e LSDM-së. Diplomoi në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit „Sh. Kirili dhe Metodi“ në Shkup. E lindur në vitin 1982 në Shkup.



NjZ 4 – Venko Filipçe është ish-ministër i shëndetësisë. Para marrjes së postit ishte këshilltar për shëndetësi i kryeministrit të Qeverisë së Zoran Zaevit dhe docent në Fakultetin e Medicinës në Shkup. Filipçe është edhe sekretar i Shoqatës së neurokirurgëve të Maqedonisë dhe është anëtar i komitetit ekzekutiv të Shoqatës së neurokirurgëve të Evropës Juglindore. Diplomoi, magjistroi dhe doktoroi në Fakultetin e Medicinës në Shkup. I lindur në vitin 1977 në Shkup.



NjZ 5 - Jovan Mitrevski është kryetar i Kuvendit, ish-koordinator i grupit parlamentar të LSDM-së dhe e ushtron mandatin e dytë si deputet. Më parë ka qenë deputet në periudhën prej vitit 2016 deri në vitin 2020. Diplomoi në Fakultetin e ekonomisë pranë Universitetit „Sh. Klimenti i Ohrit“ në Manastir. I lindur në vitin 1980 në Strugë.



NjZ 6 - Sllavjanka Petrovska është ministre e mbrojtjes. Në periudhën nga viti 2020 deri në marrjen e postit ministre e mbrojtjes është deputete. Në periudhën nga muaji janar deri në muajin korrik të vitit 2020, Petrovska ka qenë zëvendësministër plotësues i punëve të brendshme në Qeverinë teknike përgjegjëse për zbatimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në korrik të vitit 2020. Diplomoi në Fakultetin e drejtësisë pranë Universitetit „Sh. Kirili dhe Metodi“ në Shkup. E lindur në vitin 1982 në Shkup.

VMRO-DPMNE dhe koalicioni “Maqedonia Jote”



VMRO-DPMNE është parti që deklarohet si parti popullore në të djathtë të qendrës, me origjinë ideologjike demokristiane. Nga pavarësia deri më sot, VMRO-DPMNE-ja është një nga dy partitë më të mëdha në vend. Ka marrë pjesë pothuajse në të gjitha zgjedhjet parlamentare dhe lokale, me përjashtim të zgjedhjeve parlamentare në vitin 1994 kur e bojkotoi rrethin e dytë. Në zgjedhjet e treta parlamentare të vitit 1998 me 49 mandate të fituara në koalicion me Alternativën demokratike, e cila fitoi 13 deputetë, dhe PPDSH-PDP (më vonë PDSH) me 11, dhe disa parti të vogla, VM-


RO-DPMNE për herë të parë formon qeverinë. VMRO-DPMNE mbeti në pushtet deri në vitin 2002, por gjatë kohës së konfliktit nga muaji maj deri në muajin nëntor të vitit 2001 u formua Qeveria e koalicionit të gjerë, e cila përfshiu edhe ministrat e LSDM-së dhe LDP-së. Në vitin 2002 VMRO-DPMNE bashkë me partnerët e koalicionit fitoi 33 mandate deputetësh, i humbi zgjedhjet dhe funksionoi si opozitë deri në vitin 2006. Në vitin 2006 bashkë me koalicionin „Për një Maqedoni më të mirë“ i fitoi përsëri zgjedhjet parlamentare duke marrë gjithsej 45 vende deputetësh dhe e formoi qeverinë. Prej atëherë, VMRO-DPMNE ka fituar në katër cikle zgjedhore radhazi, në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në 2008, 2011, 2014 dhe 2016. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2008 së bashku me koalicionin „Për një Maqedoni më të mirë“ fitoi një numër rekord prej 63 vende deputetësh. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2011 së bashku me koalicionin kjo parti fitoi gjithsej 56 vende deputetësh. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2014, VMRO-DPMNE në Kuvend kishte 52 deputetë, ndërsa bashkë me partnerët e koalicionit kishin 61 deputetë nga gjithsej 123 vende në Kuvend. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2016, VMRO-DPMNE fitoi 51 mandate deputetësh. Edhe përkundër faktit se VMRO-DPMNE fitoi numër më të madh deputetësh, në ç’mënyrë kryetari i partisë, Nikolla Gruevski, e mori mandatin nga Presidenti i shtetit, Ivanov, për të formuar qeverinë, megjithatë, partia nuk arriti ta mbledhë shumicën e nevojshme prej 61 deputetë në afatin e caktuar, kështu që nuk arriti ta formojë qeverinë. Mandati për formimin e Qeverisë pastaj iu besua kryetarit të LSDM-së, Zoran Zaev, si parti që në zgjedhjet fitoi 49 vende deputetësh. Qeveria e Zoran Zaevit u votua në maj 2017, me 62 vota „Pro“.⁸⁶

86 Doracak për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2020 (botim i dytë i plotësuar), Fondacioni Konrad Adenauer dhe Instituti për demokraci „Societas Civilis“ – Shkup. Qasur në: https://izbornaarhiva.mk/dokumentacija/prirachnici/Prirachnik_za_parlamentarni_izbori_2020_ALB.pdf (vizita e fundit 3 prill 2024)

Në zgjedhjet e fundit parlamentare në vitin 2020, VMRO-DPMNE fitoi 44 vende deputetësh, që është për dy mandate më pak nga LSDM dhe koalicioni „Mundemi“ të cilët fituan 46 mandate dhe arritën të sigurojnë shumicën parlamentare dhe të formojnë Qeverinë.⁸⁷

Në zgjedhjet e fundit lokale në vitin 2021 kandidatët e VMRO-DPMNE-së fituan 42 mandate kryetarësh komunash, nga gjithsej 80 komuna dhe Qytetin e Shkupit.⁸⁸ Krahasuar me zgjedhjet e mëparshme lokale të vitit 2017 kur VMRO-DPMNE fitoi vetëm 5 mandate kryetarësh komunash, kështu që partia ka shënuar rritje për 37 vende të kryetarëve të komunave.

Që nga themelimi deri në vitin 2003 kryetar i VMRO-DPMNE-së ishte Lubčo Georgievski. Në Kongresin e partisë në maj të vitit 2003 Georgievski paraqet dorëheqjen, ndërsa në vendin e tij zgjidhet Nikolla Gruevski. Gruevski e udhëheq partinë deri në dhjetor të vitit 2017, kur paraqet dorëheqjen nga funksioni, e cila pranohet nga Komiteti qendror. Në Kongresin e 16-të të jashtëzakonshëm, të mbajtur në dhjetor të vitit 2017, kryetar i partisë u zgjodh Hristian Mickovski.⁸⁹ Në vitin 2021 u mbajt Kongresi i 17-të, ku u rizgjidh kryetari aktual i partisë, Hristian Mickovski.⁹⁰



Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2024 VMRO-DPMNE e udhëheq koalicionin „Maqedonia Jote“ në të cilin hyjnë edhe: Partia socialiste e Maqedonisë, Partia Demokratike e Serbëve në Maqedoni, Lidhja Demokratike, Aksioni Maqedonas, Lëvizja e Bashkimit Kombëtar të Turqve,

Pala Progresive Serbe në Maqedoni, Partia Popullore e Boshnjakëve, Forcat Demokratike të Romëve, Partia e Demokratëve të Bashkuar të Maqedonisë, Partia e Vllahëve të Maqedonisë, ZËRI për Maqedoninë, Partia e Re Liberale, Unioni Socialdemokrat, Romët e Bashkuar të Maqedonisë, Partia Demokratike e Romëve, Partia Bujqësore e Punëtorëve të Maqedonisë, Partia e Bashkuar për Barazinë e Romëve, Dinjiteti, Bashkimi i Përhershëm Radikal Maqedonas, Të Bashkuar për Maqedoninë, Koncepti Maqedonas.

87 Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, Zgjedhjet 2020. Qasur në: <https://izbornaarhiva.mk/> (vizita e fundit: 3 prill 2024)

88 Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, Zgjedhjet 2021. Qasur në: <https://izbornaarhiva.mk/> (vizita e fundit: 3 prill 2024)

89 Doracak për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2020 (botim i dytë i plotësuar), Fondacioni Konrad Adenauer dhe Instituti për demokraci „Societas Civilis“ – Shkup. Qasur në: https://izbornaarhiva.mk/dokumentacija/prirachnici/Prirachnik_za_parlamentarni_izbori_2020_ALB.pdf (vizita e fundit: 4 prill 2024)

90 Me 489 vota „pro“ dhe 3 fletvotime të pavlefshme, Mickovski rizgjidhet kryetar i VMRO-DPMNE-së, 360 shkallë, 12 dhjetor 2021. Qasur në: <https://360stepeni.mk/so-489-glasa-za-i-3-nevazhechki-livchina-mitskoski-reizbranzalider-na-vmro-dpmne/> (vizita e fundit: 4 prill 2024)

Për këto zgjedhje, koalicioni „Maqedonia Jote“ i udhëhequr nga VMRO-DPMNE do të garojë me listat e veta të kandidatëve në të gjitha gjashtë njësitë zgjedhore.

VMRO-DPMNE

Sheshi VMRO nr. 1 1000 Shkup

contact@vmro-dpmne.org.mk

www.vmro-dpmne.org.mk

Bartësit e listave të kandidatëve të VMRO-DPMNE-së dhe të koalicionit „Maqedonia Jote“



NjZ 1 – Hristian Mickovski është kryetar i VMRO-DPMNE-së dhe profesor ordinar në Fakultetin e makinerisë në Shkup. Në periudhën 2015-2017 ka qenë këshilltar për energjetikë të kryeministrave Nikolla Gruevski dhe Emill Dimitriev, ndërsa në periudhën 2016-2017 ka qenë drejtor gjeneral i ShA „Elektranat e Maqedonisë“. Në vitin 2017 u zgjodh lider i VMRO-DPMNE-së, ndërsa në vitin 2021 përsëri u rizgjodh në këtë pozitë. Magjistroi dhe doktoroi në Fakultetin e makinerisë në Shkup. I lindur në vitin 1977 në Shkup.



NjZ 2 – Vllado Misajlovski është nënkryetar i VMRO-DPMNE-së dhe deputet aktual në Kuvend. Diplomoi në Fakultetin e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare pranë Universitetit „Sh. Kirili dhe Metodi“ në Shkup, në drejtimin diplomaci dhe politikë ndërkombëtare, ku i mbaroi studimet e magjistraturës. Misajlovski ishte ministër i transportit dhe lidhjeve nga 13 maj 2015 deri në 1 qershor 2017. Më parë ka kryer shumë funksione tjera të ndryshme. I lindur në vitin 1985 në Shkup.



NjZ 3 – Dragan Kovački është deputet në përbërjen e fundit të Kuvendit, ka gradë ushtarake dhe është kolonel në Armatë. Ka qenë komandant i brigadës së parë të mekanizuar të këmbësorisë, shef i seksionit për operacione dhe gatishmëri luftarake në brigadën e parë të mekanizuar të këmbësorisë. Kovački ka qenë udhëheqës Sektorit (Shërbimi i sigurisë dhe informimit ushtarak në Ministrinë e mbrojtjes). Ka qenë shef i njësisë së kundërzbulimit në shërbimin ushtarak të sigurisë dhe informimit. I lindur në vitin 1977 në Dellçevë.



NjZ 4 – Aleksandar Nikollovski është nënkryetar i VMRO-DPMNE-së dhe deputet. Nikollovski është politikolog i diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë „Justiniani i Parë“ në Shkup. Nikollovski është anëtar shumëvjeçar i VMRO-DPMNE-së dhe deputet në disa mandate. Nikollovski nga viti 2009 deri në vitin 2017 ka qenë anëtar i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, në këtë pozitë emërohet përsëri në vitin 2021. Në vitin 2022 zgjidhet Zëvendëskryetar i grupit të Partisë Popullore Evropiane në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës. I lindur në vitin 1984 në Ohër.



NjZ 5 – Gjorgjia Sajkoski është deputet në Kuvend, sekretar i përgjithshëm i VMRO-DPMNE-së dhe doktor i shkencave të historisë. Sajkovski ka kryer disa funksione, siç janë: kryetar i Këshillit të Komunës së Kërçovës (2009 - 2013), zëvendësministër në ministrinë e vetëqeverisjes lokale, anëtar i Komisionit për vetëqeverisje lokale (2010 - 2014), kryetar i KK - VMRO-DPMNE Kërçovë (2010 - 2020) dhe drejtor i NP Studentçica. I lindur në vitin 1972 në Kërçovë.



NjZ 6 - Dafina Stojanoska është deputete aktuale në Kuvend dhe anëtare e Komitetit ekzekutiv të partisë. Ajo e ushtroi funksionin e deputetes edhe në dy mandatet e mëparshme (2016 - 2020 dhe 2014 - 2016). Stojanoska është stomatologe e diplomuar dhe ka punuar si stomatologe amë në Gostivar, në periudhën 2001 - 2008. Në periudhën 2008 - 2016 ishte e punësuar në Fondin e sigurimit shëndetësor në Gostivar. E lindur në vitin 1974 në Gostivar.

Bashkimi Demokratik për Integrim⁹¹ dhe koalicioni „Fronti evropian“



Bashkimi Demokratik për Integrim doli nga anëtarët e ish-Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK), e cila e filloi konfliktin e armatosur në vitin 2001. Ideologjikisht, BDI deklarohet si parti e qendrës së majtë që angazhohet për më shumë të drejta për shqiptarët dhe për zbatimin e Marrëveshjes kornizë të Ohrit. Partia u formua në vitin 2002 dhe për herë të parë garoi në zgjedhjet parlamentare vitin e njëjtë ku fitoi numrin më të madh të votave në mesin e trupit votues etnik shqiptar, me ç' rast siguroi gjithsej 16 vende deputetësh dhe u bë pjesë e Qeverisë të udhëhequr nga LSDM. BDI ishte pjesë e Qeverisë prej 2002 deri në 2006, me ç' rast u prezantua me numrin më të madh të ministrave të një partie shqiptare deri më tani. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2006 BDI fitoi përsëri numrin më të madh të votave në mesin e trupit votues etnik shqiptar (12,2 %) dhe 17 vende deputetësh, por pas negociatave të pasuksesshme me VMRO-DPMNE nuk u përfshi në koalicionin e atëhershëm qeveritar. Si rezultat i kësaj gjëje, BDI e bojkotoi punën e Kuvendit për një periudhë më të gjatë, prej vitit 2006 deri në vitin 2008, kur u shpallën zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2008 BDI fitoi 12,8 % të votave dhe 18 vende deputetësh, dhe si partia më e madhe politike që përfaqësonte shqiptarët etnikë hyri në Qeveri së bashku me Nikolla Gruevskin. Në zgjedhjet e ardhme parlamentare në vitin 2011, BDI është përsëri partia e tretë më e madhe në vend, duke fituar 14 vende deputetësh. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2014 BDI fitoi 19 vende deputetësh dhe formoi Qeverinë së bashku me VMRO-DPMNE-në.

Në zgjedhjet e kaluara parlamentare të mbajtura në vitin 2020, BDI shënoi rritje të rezultatit duke fituar 15 deputetë, që është për 5 deputetë më shumë krahasuar me zgjedhjet parlamentare të vitit 2016.⁹² Nëpërmjet koalicionimit me LSDM-në, BDI është përsëri pjesë e Qeverisë. Nga themelimi i saj deri më sot kryetar i partisë është Ali Ahmeti.

Në nivel lokal pas zgjedhjeve të fundit lokale në vitin 2021, BDI ka 11 kryetarë komu-

91 Doracak për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2020 (botim i dytë i plotësuar), Fondacioni Konrad Adenauer dhe Instituti për demokraci „Societas Civilis“ – Shkup. Qasur në: https://izbornaarhiva.mk/dokumentacija/prirachnici/Prirachnik_za_parlamentarni_izbori_2020_ALB.pdf (vizita e fundit: 4 prill 2024)

92 Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, Zgjedhjet 2020. Qasur në: <https://izbornaarhiva.mk/> (vizita e fundit: 5 prill 2024)

nash nga gjithsej 80 komuna dhe Qytetin e Shkupit, ndërsa në zgjedhjet lokale në vitin 2017 kishin 10 kryetarë komunash.⁹³

Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2024 BDI e udhëheq koalicionin „Fronti evropian“, në të cilin janë përfshirë edhe: Partia Demokratike e Shqiptarëve, Partia Demokratike Evropiane, Lëvizja Popullore, Aleanca për Shqiptarët (Ziadin Sela)⁹⁴, Lëvizja e Turqve të Maqedonisë për Drejtësi dhe Demokraci, Partia Demokratik e Turqve dhe Unioni i Romëve.

Në këto zgjedhje, koalicioni „Fronti evropian“ i udhëhequr nga BDI do të garojë me listat e veta të kandidatëve në të gjitha gjashtë njësitë zgjedhore.

Bashkimi Demokratik për Integrim

rr. „Reçicë e Vogël“ 1200 Tetovë

press@bdi.mk

bdi.mk

93 Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, Zgjedhjet 2021. Qasur në: <https://izbornaarhiva.mk/> (vizita e fundit: 3 prill 2024)

94 Krahu i Aleancës për Shqiptarët i udhëhequr nga Ziadin Sela mori vendim që në zgjedhjet e ardhme t'i bashkohet „Frontit evropian“ të udhëhequr nga BDI. Pas vendimit të fundit të miratuar në Gjykatën themelore në Tetovë, Sela i mori vullat e Aleancës për Shqiptarët, me çka edhe zyrtarisht është kryetar i AA-së. „Ziadin Sela i mori vullat e Aleancës për Shqiptarët nga vendimi gjyqësor, Taravari paralajmëron ankesë“, 360 shkallë, 2 prill. Qasur në: <https://360stepeni.mk/zijadin-sela-sudski-gi-dobi-pechatite-na-alijansa-za-albantsite-taravari-najavuva-zhalba/> (vizita e fundit: 16 prill 2024)

Bartësit e listave të kandidatëve të koalicionit „Fronti Evropian“



NjZ 1 – Blerim Bexheti është jurist dhe avokat. Nga viti 2006 deri në vitin 2009 ka qenë deputet. Në periudhën 2009-2011 ka qenë kryetar i Komunës së Sarajit. Prej periudhës 28 korrik 2011 deri në 19 qershor 2014 ka qenë Ministër i drejtësisë. Bexheti është kryetar aktual i Komunës së Sarajit pasi fitoi në zgjedhjet e vitit 2021.



NjZ 2 – Sadulla Duraku lindi në vitin 1960 në Lipkovë, rrethi i Kumanovës. Diplomoi në Fakultetin e makinerisë në Prishtinë. Në vitin 2004 u emërua Ministër në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave dhe atë funksion e ushtroi deri në vitin 2006. Në vitin 2006 është deputet në Kuvend i grupit parlamentar të BDI-së. Ka qenë kryetar i Komunës së Lipkovës në periudhën 2009-2017. Në vitin 2017 u emërua ministër i ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor, ndërsa në vitin 2019 Zv/kryeministër për zbatimin e Marrëveshjes kornizë dhe për sistem politik. Në funksion mbetet deri në vitin 2020.



NjZ 3 – Sulejman Baki lindi në Shkup në vitin 1975. Studimet deridiplomike dhe të magjistraturës i mbaroi në Universitetin në Bursë - Ulludag, ndërsa doktoroi në Institutin e historisë kombëtare pranë UKIM në fushën e historisë osmane. Nga viti 2011 është profesor në Universitetin Shtetëror të Tetovës, i cili udhëheq me Katedrën e gjuhës dhe letërsisë turke. Ai është përfaqësues i Lëvizjes së turqve të Maqedonisë për drejtësi dhe demokraci.



NjZ 4 – Enver Hysein lindi në vitin 1971 në fshatin Topollnicë, Radovish. Ai është profesor i diplomuar për mësimin klasor në Universitetin Goce Dellçev në Shtip, ndërsa ka magjistruar në shkencat juridike në Universitetin ndërkombëtar - Strugë. Nga viti 2008 deri në vitin 2012 është nënkryetar i Partisë Demokratike të Turqve në Maqedoni. Nga viti 2014 deri në vitin 2017 është sekretar shtetëror në Ministrinë e punës dhe politikës sociale, ndërsa nga viti 2018 deri në vitin 2020 e ushtroi detyrën sekretar shtetëror në MASH. Momentalisht e ushtron detyrën e Zv/ministrit të punës dhe politikës sociale.



NjZ 5 – Ziadin Sela është kryetar i Aleancës për Shqiptarët.⁹⁵ Deputet në Kuvend u zgjodh në zgjedhjet në vitin 2020 dhe më parë në vitin 2016. Funkcionin e deputetit e ka ushtruar edhe në periudhën 2011 - 2013, para se të zgjidhet kryetar i Komunës së Strugës (2013-2016). Diplomoi në Fakultetin e Medicinës në Universitetin e Tiranës. I lindur në vitin 1972 në Strugë.



NjZ 6 – Ali Ahmeti është deputet në Kuvend nga viti 2002 dhe është lider i BDI-së. Ai është lider i partisë që nga themelimi i saj në vitin 2002. Në konfliktin e vitit 2001 ishte komandant suprem dhe lider politik i Ushtrisë çlirimtare kombëtare (UÇK). Në vitin 1983 diplomoi në filozofi në Universitetin e Prishtinës, Kosovë. I lindur në vitin 1959 në f. Zajas, rrethi i Kërçovës. Ahmeti është bartës i listës së kandidatëve në NjZ 6 për të tetën herë.

95 „Sela: Gjykata vendosi, unë jam kryetar i AA-së, ndërsa vula e partisë janë anëtarët e saj”, mkd.mk, 03 prill 2024. Qasur në: <https://mkd.mk/sela-sudot-presudi-jas-sum-pretsedatel-na-aa-a-pechat-na-partijata-se-chlenovite/> (vizita e fundit: 22 prill 2024)

Коалиција „Вреди“



Në koalicionin „Vlen“ janë përfshirë partitë politike: Alternativa, Lëvizja Besa, Aleanca për Shqiptarët (Arben Taravari) dhe Lëvizja Demokratike.

Alternativa është parti politike, e cila në spektrin ideologjik përcaktohet si subjekt i qendrës së djathtë. Partia është formuar në vitin 2019. Kuvendi qendror e emëron Afrim Gashin si kryetarin e saj të parë. Partia rrjedh nga anëtarët e mëparshëm të lëvizjes Besa, të cilët e formuan partinë pas rezultateve të dobëta në zgjedhjet lokale në vitin 2017. Programi politik mbështetet në katër shtylla kryesore: Zhvillimi, Integrimi, Dialogu i hapur dhe Drejtësia.

Lëvizja Besa është parti politike e themeluar në vitin 2014. Kryetar i partisë është Bilall Kasami. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2016 „Besa“ fitoi pesë deputetë, me çka u bë partia e dytë më e madhe shqiptare në Kuvend.⁹⁶ Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2020, partia mori pjesë në koalicion të udhëhequr nga LSDM dhe fitoi 4 mandate deputetësh.

Aleanca për Shqiptarët është parti politike e cila doli nga Lëvizja për reforma në PDSH, ndërsa si parti politike është regjistruar pak përpara zgjedhjeve lokale në vitin 2017 me emrin „Aleanca e Shqiptarëve“ që u kontestua nga udhëheqësia e Unitetit dhe PDK-së. Në zgjedhjet e kaluara parlamentare të vitit 2020, partia ishte në koalicion me partinë Alternativa. Në këto zgjedhje koalicioni fitoi 12 vende deputetësh. Para zgjedhjeve në vitin 2024 ndodhi ndarja e kësaj partie në dy krahë, njëri krah i udhëhequr nga Ziadin Sela, ndërsa krahun tjetër i udhëhequr nga Arben Taravari. Pas përçarjes, Arben Taravari dhe partitë opozitare të shqiptarëve konfirmuan koalicionin dhe firmosën deklaratën për bashkimin opozitar shqiptar në zgjedhjet e ardhshme. Taravari është edhe kandidat presidencial i koalicionit „Vlen“.⁹⁷

Lëvizja demokratike është parti politike e formuar nga mbështetësit e Izet Mexhinit të ashtuquajturit „Grupi i zjarrit“ nga BDI. Për shkak të mosmarrëveshjeve të brendshme dhe revoltit ndaj partisë, Lëvizja demokratike u shkëput dhe filloi të

96 Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, Zgjedhjet 2020. Qasur në: <https://izbornaarhiva.mk/> (vizita e fundit : 5 prill 2024)

97 „Ziadin Sela me vendim gjyqësor mori vullat e Aleancës për Shqiptarët, Taravari paralajmëron ankesë“, 360 shkallë, 2 prill. Qasur në: <https://360stepeni.mk/zijadin-sela-sudski-gi-dobi-pechatite-na-alijansa-za-albantsite-taravari-najavuva-zhalba/> (vizita e fundit: 16 prill 2024)

veprojë në mënyrë të pavarur nga viti 2023.⁹⁸ Respektimi i të drejtave të njeriut, sundimi i ligjit, avancimi i të drejtave dhe të statusit të shqiptarëve dhe arritja e mirëqenies ekonomike janë vetëm disa nga vlerat themelore për të cilat angazhohet Lëvizja demokratike.

Në këto zgjedhje, koalicioni „Vlen“ do të garojë me listat e veta të kandidatëve në të gjitha gjashtë njësitë zgjedhore.

Koalicioni „Vlen“

vlen.mk

Bartësit e listave të kandidatëve të koalicionit „Vlen“



Njz 1 – Izet Mexhiti është lider i Lëvizjes demokratike dhe deputet në Kuvend. I lindur në vitin 1977 në Shkup. Diplomoi në Fakultetin e ekonomisë pranë Universitetit „Sh. Kirili dhe Metodi“. Në periudhën 2001-2003 ka qenë profesor i lëndës së ekonomisë në shkollën e mesme „Arseni Jovkov“. Nga 2005 deri në 2017 Mexhiti ishte kryetar i komunës së Çairit, ndërsa në vitin 2019 bëhet kryetar i nëndegës partiake të BDI-së në këtë komunë. Në vitin

2023 nga fraksioni „Grupi i zjarrit“ në BDI, Mexhiti themelon partinë e re – Lëvizja Demokratike.



Njz 2 – Afrim Gashi është lider i Alternativës dhe deputet në përbërjen e fundit të Kuvendit (2020-2024). Ai e ka ushtruar funksionin e deputetit edhe në mandatin e mëparshëm (2016 - 2020). Në vitin 2011 e themeloi revistën „Shenja“ dhe deri në vitin 2014 ishte kryeredaktor i saj. Nga viti 2014 është aktiv edhe në politikë, duke e themeluar Lëvizjen Besa, ku një kohë e ushtroi funksionin e sekretarit të përgjithshëm. Në kuvendin qendror pas

shkëputjes nga Lëvizja Besa, Gashi u zgjodh kryetar i parë i partisë së re Alternativa. Diplomoi në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tetovës. I lindur në vitin 1977 në Shkup.

98 „Të zjarrtët“ u bënë Lëvizje demokratike, DW, 2 gusht 2023. Qasur në: „Огнените“ станаа Демократско движење – DW – 2.08.2023 (vizita e fundit 15 prill).



Njz 3 – Shener Bilalli është profesor në Fakultetin për komunikime pranë Universitetit Ndërkombëtar të Ballkanit. Në periudhën prej 2013-2017 ka qenë docent, ndërsa prej vitit 2017 është profesor në të njëjtin fakultet. Në vitin 2023 i bashkëngjitet Lëvizjes Besa. Doktoroi në Institutin e historisë kombëtare pranë Universitetit „Sh. Kirili dhe Metodi“ në Shkup.



Njz 4 – Mendurim Zekmani është bartës i listës në njësinë zgjedhore 4. Ka studiuar në fakultetin për siguri pranë Universitetit FON në Shkup.⁹⁹



Njz 5 – Salim Sulejmani është ish- Myfti dhe magjistër në teologji dhe filozofi islame. Studioi dhe magjistroi në Jordan, ndërsa 12 vjet ka qenë në krye të Myftinisë së Bashkësisë Fetare Islame në Strugë, ku ka dhënë kontribut në zhvillimin e jetës fetare, duke punuar në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore.

99 Për bartësin e listës së kandidatëve të koalicionit „Vlen“ për Njz4 nuk është mundur të gjendet foto e përshtatshme dhe më shumë të dhëna biografike nga ato që janë përmendur.



NjZ 6 – Bilall Kasami është lider i Lëvizjes Besa nga formimi i saj në vitin 2014. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2016 u zgjodh deputet në Kuvend, funksionin të cilin e ushtroi deri në vitin 2017 kur paraqiti dorëheqje për t'u kandiduar në zgjedhjet lokale. Në zgjedhjet e parakohshme në vitin 2020 zgjidhet përsëri deputet, ndërsa funksionin e ushtroi deri në vitin 2021, kur u bë Kryetar i Komunës së Tetovës. Doktoroi në Fakultetin e ekonomisë pranë

Universitetit „Sh. Kirili dhe Metodi“ në Shkup. I lindur në vitin 1975 në Tetovë.

Partia politike E majta- Levica ¹⁰⁰



Partia politike „Levica” është themeluar në fund të vitit 2015. Partia ka ideologji të theksuar majtiste dhe angazhohet për vlerat majtiste, ndër të cilat antikapitalizmin, antinacionalizmin, antimilitarizmin dhe antiklerikalizmin dhe antikonservatizmin. Partia përqendrohet në të drejtat e punëtorëve dhe të drejtat themelore të njeriut, ndërsa si parti angazhohet, para së gjithash, për të varfrit, të paprivilegjuarit, të marginalizuarit, të privuarit nga të drejtat. Në zgjedhjet e vitit 2016 partia garoi vetë duke marrë 12 120 vota (1,02 %), në zgjedhjet lokale në vitin 2017 partia arriti të marrë gjithsej tre vende këshilltarësh, ndër të cilët një në Këshillin e Qytetit të Shkupit, dhe nga një vend këshilltari në komunat Karposh dhe Rosoman, ndërsa në zgjedhjet e fundit lokale në vitin 2021 partia fitoi këshilltarë në tetë komuna.¹⁰¹ Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2020 „Levica” fitoi dy mandate.¹⁰²

Nisma për formimin e „Levicës” ka rrjedhur nga anëtarët e Lëvizjes për drejtësi sociale „Lenka”, anëtarët e lëvizjes majtiste „Solidariteti”, anëtarët e Partisë komuniste të Maqedonisë, sindikalistët, aktivistët dhe individët majtistë. Deri në vitin 2019 Levica ka pasur kryesi kolektive, Presidium, i përbërë nga shtatë anëtarë me mandat imperativ. Në mbledhjen e rregullt të Plenumit të partisë politike Levica miratohet statuti i ri partiak me të cilin është bërë ndryshim në strukturën organizative, ku përveç organeve themelore udhëheqëse Plenumi, Komiteti qendror, Presidiumi dhe Tribunati, vendoset edhe pozita e kryetarit me mandat katërvjeçar. Kryetari i tanishëm i „Levicës” është Dimitar Apasiev.

„Levica” i paraqiti listat e veta të kandidatëve në të gjitha gjashtë njësitë zgjedhore.

Partia politike „Levica”

rr. „Miroslav Kërlezha” nr. 20, hyrja 1, kati 3, lokali nr.12

1000 Shkup

contact@levica.mk

www.levica.mk

100 Doracak për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2020 (botim i dytë i plotësuar), Fondacioni Konrad Adenauer dhe Instituti për demokraci „Societas Civilis” – Shkup. Qasur në: https://izbornaarhiva.mk/dokumentacija/prirachnici/Prirachnik_za_parlamentarni_izbori_2020_ALB.pdf (vizita e fundit: 15 prill 2024)

101 Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, Zgjedhjet 2021. Qasur në: <https://izbornaarhiva.mk/> (vizita e fundit: 5 prill 2024)

102 Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, Zgjedhjet 2020. Qasur në: <https://izbornaarhiva.mk/> (vizita e fundit: 5 prill 2024)

Bartësit e listave të kandidatëve të „Levica-s“



NjZ 1 – Dimitar Apasiev është kryetar i Levicës, deputet në Kuvend në përbërjen e fundit (2020 - 2024) dhe profesor inordinar në Fakultetin e drejtësisë pranë Universitetit „Goce Dellçev“ - Shtip. Ai është një kohë të gjatë aktivist i Lëvizjes për drejtësi sociale „Lenka“, ka marrë pjesë në shumë simpoziume shkencore vendore dhe ndërkombëtare dhe është autor i disa librave në fushën e drejtësisë dhe të monografive, si dhe mbi 50 artikujve dhe punimeve profesionale. Diplomoi, magjistroi dhe doktoroi në fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit „Sh. Kirili dhe Metodi“ në Shkup. I lindur në vitin 1983 në Veles.



NjZ 2 – Amar Mecinoviq është politolog, aktivist, kolumnist. Nga viti 2021 emërohet zëdhënës i partisë dhe nga viti 2022 zgjidhet këshilltar në Këshillin e Qytetit të Shkupit. I lindur në vitin 1996 në Shkup.



NjZ 3 – Borisllav Kërmov është historiani arti. Ka studiuar historinë e artit dhe arkeologjinë. Ka punuar profesionalisht, si kritik arti dhe teoricien si dhe punonjës ndërtimi. Prej vitit 2020 është zgjedhur deputet në Kuvend. I lindur në vitin 1981 në Shtip.



NjZ 4 – Sashko Jançev është jurist i diplomuar dhe magjistër për drejtësi penale në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit „Sh. Kirili dhe Metodi“, anëtar i KQ-së dhe këshilltar i „Levicës“ në Komunën e Gjevgjelisë. Luftëtar shumëvjeçar i mbrojtjes së ambientit jetësor me fokus në jugun e shtetit dhe luftën për Kozhuvin për ta bërë park nacional.




NjZ 5 – Jovana Mojsovska është sekretare e përgjithshme e „Levicës“. Diplomoi në Fakultetin për siguri dhe kontroll financiar. Është themeluese dhe anëtare e shumë iniciativave për mbrojtjen e kafshëve dhe mbrojtjen e ambientit jetësor. E lindur në vitin 1992 në Strugë.



NjZ 6 – Igor Dimeski është udhëheqës i Sektorit për energjetikë dhe këshilltar i Levicës në Komunën Qendër.

Avaja – Mjaft më!



Partia politike **Avaja**, në përkthim: Po vijnë, është partia më e re në skenën politike maqedonase, e formuar në vitin 2024. Partisë i paraprin Lëvizja qytetare AVAJA që filloi të funksionojë gjatë vitit 2019, e udhëhequr nga tre organizata: Instituti për hulumtim dhe analizë të politikave Romolitiko, Shoqata e qytetarëve – Romaverzitas dhe Shoqata për forcimin dhe organizimin e komunitetit rom “Romano Avazi”. Për herë të parë kryetar i partisë është zgjedhur Akif Kariman. Në zgjedhjet parlamentare „Avaja” me sloganin „Mjaft më” do të garojë e pavarur në katër njësi zgjedhore, NjZ 3, NjZ 4, NjZ 5, NjZ 6.

Avaja

rr. Franjo Klluz 6/14
1000 Shkup
www.avaja.mk

Bartësit e listave të kandidatëve të Avaja-s

NjZ 3 - Idris Zejnelov

NjZ 4 - Qemal Sulejmanov

NjZ 5 - Remzi Medik

NjZ 6 - Deniz Ismaili

Partia politike Demokratët



Demokratët — parti politike maqedone e themeluar në vitin 2018, ndërsa në Kuvendin themelues për kryetar të partisë është zgjedhur Jorgo Ognenovski. Partia angazhohet për vlera demokratike dhe respektim të të drejtave themelore të njeriut, ndër të cilat edhe votimi dhe deklarimi në zgjedhje ose referendum, dhe respektimi i vullnetit të qytetarëve. Demokratët me listat e veta të kandidatëve do të garojnë në të gjitha gjashtë njësitë zgjedhore.

Partia politike Demokratët

rr. Boris Trajkovski 24-1/2
1000 Shkup
www.demokrati.mk

Bartësit e listave të kandidatëve të Demokratëve

NjZ 1 – Jorgo Ognenovski

NjZ 2 - Dimitar Spasov

NjZ 3 – Violeta Spasova

NjZ 4 – Gabriella Todorovska

NjZ 5 – Gjorgji Veljanov

NjZ 6 – Hirmet Eljezi

Partia politike E djathta



Partia është themeluar në vitin 2022 , ndërsa kryetar i saj i parë është zgjedhur Lupço Palevski - Pallço. E djathta paraqitet si rezultat i shoqërimit të më shumë shoqatave të qytetarëve. Ushtrues i detyrës së kryetarit momentalisht është Toni Aleksovski.¹⁰³ Partia E djathta në zgjedhjet parlamentare garon me lista kandidatësh në të gjitha njësitë zgjedhore, me përjashtim të NjZ 5 dhe NjZ 6.

Partia politike E djathta rr. Dimo Haxhi Dimov 8

1000 Shkup

www.desna.org.mk

Bartësit e listave të kandidatëve E djathta

NjZ 1 – Toni Aleksovski

NjZ 2 – Angjela Mitkovska

NjZ 3 – Zorica Cvetkovska

NjZ 4 – Gjosh Bojaxhiev

¹⁰³ Toni Aleksovski është emëruar U.D. Kryetar i partisë pas rastit me kidnapimin dhe vrasjet e Vanja Gjorçevskës dhe Pançe Zhezhovskit për çka i dyshuar i parë është kryetari i mëparshëm i partisë E djathta, Lupço Palevski – Pallço, i cili momentalisht pret ekstradim nga Republika e Turqisë.

Partia politike Maqedonia e Bashkuar



Maqedonia e Bashkuar është parti politike e themeluar në vitin 2002 me emrin „Lëvizja popullore për Maqedoninë“. Në vitin 2018 Komiteti qendror i partisë vendos ta ndryshojë emrin në „Maqedonia e Bashkuar“ si dhe ndryshimin e tërësisëm të politikave të partisë lidhur me procesin eurointegruar. Partia vepron me skepticizëm të hapur euroatlantik, ndërsa në pajtim me Statusin e saj, angazhohet për anëtarësim në Bashkimin ekonomik euroaziatik dhe partneritetin strategjik me Rusinë. Bashkëthemelues i saj dhe kryetar është Janko Baçev. Partia Maqedonia e Bashkuar në zgjedhjet parlamentare garon me lista kandidatësh në NjZ 1, NjZ 2, NjZ 3, NjZ 4 dhe NjZ 5.

Maqedonia e Bashkuar

rr. Dame Gruev 10

1000 Shkup

www.edinstvenamakedonija.mk

Bartësit e listave të kandidatëve të „Maqedonia e Bashkuar“

NjZ 1 – Emilija Geleva

NjZ 2 – Tome Dimishkovski

NjZ 3 – Dragan Ugrinovski

NjZ 4 – Janko Baçev

NjZ 5 – Mirjana Mirçevski

Lëvizja ZNAM (E di) – Për Maqedoninë Tonë



Lëvizja ZNAM – Për Maqedoninë tonë është parti politike me ideologji majtiste. Partia lindi nga lëvizja që doli nga pakënaqësia e anëtarësisë së LSDM-së, e cila e udhëhequr nga deputeti i atëhershëm Dimitrievski mori pjesë vetë në zgjedhjet lokale në vitin 2021 me moton „Për Kumanovën Tonë“. Me fitoren e kandidatit për kryetar të komunës, Maksim Dimitrievski, lëvizja qytetare u zhvillua në parti politike. Më 9 tetor 2023 u mbajt kongresi themelues, ku për kryetar i partisë u emërua kryetari aktual i komunës së Kumanovës dhe kandidati për president të shtetit në zgjedhjet presidenciale në vitin 2024, Maksim Dimitrievski.

Partia politike Lëvizja ZNAM – Për Maqedoninë Tonë

rr. Sh. Kirili dhe Metodi nr. 50/1-1, Qendër

1000 Shkup

www.dvizenjeznam.org.mk

Bartësit e listave të kandidatëve të Lëvizjes ZNAM – Për Maqedoninë Tonë

NjZ 1 – Boban Karapejovski

NjZ 2 – Daniell Stojçevski

NjZ 3 – Pavle Arsovski

NjZ 4 – Mile Cekov

NjZ 5 – Vesna Bendevska

NjZ 6 – Nebojsa Zaharievski

Era e tretë Maqedonase / Listat e Pavarura Maqedonase – Sovranët



Era e tretë Maqedonase është parti politike me seli në Manastir, e cila në vitin 2020 doli nga lëvizja me emërtim të njëjtë. Themeluesi i saj është ish-ambasadori maqedonas në Republikën e Turqisë, Goran Taskovski.

Era e tretë Maqedonase paraqiti listat e kandidatëve në të gjitha gjashtë njësitë zgjedhore.

Era e tretë Maqedonase / Listat e pavarura Maqedonase - Sovranët

Shirok Sokak, Manastir

www.makedonskae3.mk

Bartësit e listave të kandidatëve të Erës së tretë Maqedonase / Listat e pavarura Maqedonase - Sovranët

NjZ 1 – Vlladimir Trajkovski

NjZ 2 – Marjan Kamillovski

NjZ 3 – Vllado Pavlllov

NjZ 4 – Vlladimir Gjorgjiovski

NjZ 5 – Goran Taskovski

NjZ 6 – Sonja Jovanovska

Opsioni i reformës së rindërtimit të Maqedonisë – Partia e punës



Opsioni i reformës së rindërtimit të Maqedonisë – Partia e Punës (MORO-RP) është themeluar në vitin 2014 si opsion i reformës së rindërtimit të Maqedonisë – Bashkimi demokratik qendror (MORO-CDU). Partia ka marrë pjesë në dy cikle zgjedhore parlamentare në vitin 2014 dhe 2016. Të dyja pjesëmarrjet në zgjedhjet MORO-RP i realizoi përmes pjesëmarrjes në koalicion. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2014, MORO-RP i bashkëngjitet koalicionit „Dinjitet për Maqedoninë“ së bashku me partinë Dinjiteti, me ç’rast fituan 9 265 vota ose 0,8 % të numrit të përgjithshëm të votave. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2016 partia ishte pjesë e koalicionit „Koalicioni për ndryshime dhe drejtësi - Blloku i Tretë“ së bashku me Bashkimin demokratik, DEMOS dhe FRODEM. Ky koalicion fitoi 10 028 vota ose 0,8 % të numrit të përgjithshëm të votave. Partia nuk ka marrë vende deputetësh në zgjedhjet. Kryetari i partisë është Goran Zafirovski. Partia e Punës në zgjedhjet parlamentare garon me lista të kandidatëve në NjZ 1 dhe NjZ 5.

MORO-Parti e punës

rr. Anton Popov 103-b
1000 Shkup

Bartësit e listave të kandidatëve të Partisë së punës

NjZ 1 -Ana Bobinkova Mijakovska

NjZ 5 – Ljube Petrevski

Partia politike Alternativa e Re



E themeluar në vitin 2007 nga Gjorgji Orovčanec pas braktisjes së tij të VMRO-NP-së. Nga viti 2008 deri në zgjedhjet në vitin 2024 Alternativa e Re është pjesë e koalicioneve të udhëhequra nga LSDM. Në janar të vitit 2024, partinë e mori përsipër kryetarja aktuale e komunës së Qytetit të Shkupit, Danella Arsovska. Në këto zgjedhje parlamentare Alternativa e Re do të garojë me lista të veta në katër njësitë e para zgjedhore.

Alternativa e Re

bul. Aradha partizane 37/014
1000 Shkup
www.novaalternativa.mk

Bartësit e listave të kandidatëve të Alternativës së Re

NjZ 1 – Danella Arsovska

NjZ 2 – Dragan Mitkovski

NjZ 3 – Irena Vitina

NjZ 4 – Ana Cumbuleva

Partia politike Rodina Maqedoni



Partia „Rodina Maqedoni“ është themeluar në vitin 2020 dhe drejtohet nga Kryesia si organ kolektiv udhëheqës. Nga ana statutore, partia është kundër anëtarësimit të vendit në Unionin evropian, ndërsa angazhohet edhe për largim nga Aleanca e NATO-s, duke synuar afrimin me Bashkimin ekonomik euroaziatik dhe BRIKS-in, si dhe partneritetin strategjik me Rusinë. Kryesues i Kryesisë është

Zoran Jovançev, Partia Rodina në zgjedhjet parlamentare me lista kandidatësh do të garojë ne të gjitha gjashtë njësitë zgjedhore.

Rodina Maqedoni

rr. 27 marsi 10/1-2

1000 Shkup

www.rodina.org.mk

Bartësit e listave të kandidatëve të Rodina Maqedoni

NjZ 1 – Tomçe Shirkov

NjZ 2 – Zoran Jovançev

NjZ 3 – Aleksandar Stefanovski

NjZ 4 – Ilija Jankovski

NjZ 5 – Marijan Gacevski

NjZ 6 – Darko Jançeski

Partia Jote



„Partia Jote“ është themeluar në vitin 2020, ndërsa një nga themeluesit janë avokati Aleksandar Torteovski dhe profesora Mirjana Najçevska. Në pajtim me statutin e saj, „Partia Jote“ është parti demokratike veprimtaria e së cilës bazohet në kombinimin e politikave për ndryshim shoqëror me politikat për zgjidhjen e problemeve të mëdha ekologjike në suaza kombëtare dhe ndërkombëtare, për të krijuar një shoqëri të drejtë, korrekte dhe të qëndrueshme. Në këto

zgjedhje partia „Jote“ paraqiti listat e veta të kandidatëve në katër njësi zgjedhore, më saktësisht në NjZ 1, NjZ 2, NjZ 3 dhe NjZ 4.

Partia Jote

rr. Maqedonia nr. 25-1/6

1000 Shkup

www.tvoja.org.mk

Bartësit e listave të kandidatëve të „Partia Jote“

NjZ 1 – Mirjana Najçevska

NjZ 2 – Aleksandar Torteovski

NjZ 3 – Trajko Ajtov

NjZ 4 – Risto Stravrov

Opsioni qytetar për Maqedoninë dhe koalicioni „Trimërisht për Maqedoninë“



Opsioni qytetar për Maqedoninë (GROM) është parti politike e cila është themeluar në vitin 2013. Kryetari i partisë është Stevço Jakimovski. Parimet e GROM-it themelohen në parimet burimore të jetës demokratike: liria e zgjedhjes personale dhe krijimi i një shoqërie më të drejtë për secilin qytetar. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2014, partia ka marrë pjesë në mënyrë të pavarur dhe ka fituar një vend deputeti. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2016, partia ka

marrë pjesë në koalicionin e udhëhequr nga VMRO-DPMNE dhe ka fituar dy vende deputetësh, përderisa në zgjedhjet parlamentare në vitin 2020 fitoi një vend deputeti, gjithashtu, në koalicion me VMRO-DPMNE-në.

Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2024 Opsionit qytetar për Maqedoninë i paraprin koalicioni „Trimërisht për Maqedoninë“, në të cilin janë përfshirë edhe: INTEGRA – Partia konservatore maqedonase dhe Partia për emancipimin e plotë të romëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Opsioni qytetar për Maqedoninë

rr. e Pragës nr. 21 hyrja 1, lokali 2 dhe 3
1000 Shkup
grom.mk

Bartësit e listave të kandidatëve të koalicionit „Trimërisht për Maqedoninë“

NjZ 1 – Dobrilla Andonovska

NjZ 2 – Lubço Ristovski

NjZ 3 – Jordan Nikollov

NjZ 4 – Ruzhica Nikollova

NjZ 5 – Samka Ibraimoski

NjZ 6 – Zoran Sofreski

Grup zgjedhësish Gjyla Çeliku

Grupi i zgjedhësve Gjyla Çeliku për herë të parë do të marrë pjesë në zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Grupi do të garojë në mënyrë të pavarur vetëm në NjZ 6.¹⁰⁴

Bartësit e listave të kandidatëve të Grupit të zgjedhësve Gjyla Çeliku

NjZ 6 – Gjyla Çeliku

¹⁰⁴ Për Grupin e zgjedhësve Gjyla Çeliku nuk mund të gjenden më tepër të dhëna biografike nga ato që janë përmendur.



5

**Zgjedhjet parlamentare në
Republika e Maqedonisë së Veriut
2024 - Rezultatet,
fushata, vlerësime**

5. Zgjedhjet parlamentare në Republika e Maqedonisë së Veriut 2024 - Rezultatet, fushata, vlerësime

Hyrje

Më 8 maj të vitit 2024 u mbajtën zgjedhjet e njëmbëdhjeta parlamentare me radhë që nga pavarësia e vendit, të cilat ishin njëkohësisht edhe zgjedhjet e para të rregullta pas Zgjedhjeve parlamentare në vitin 2006. Të drejtë vote kishin gjithsej 1 815 350 votues. Personat e sëmurë, personat e pafuqishëm, personat në arrest shtëpie dhe të burgosurit në institucionet ndëshkuese - korrektuese votuan një ditë më parë, gjegjësisht më 7 maj. Dalja në zgjedhjet parlamentare më 8 maj ishte 53,41 %, që është përafërsisht 2 % më e lartë nga zgjedhjet parlamentare që u mbajtën në vitin 2020.

Në këto zgjedhje morën pjesë 17 subjekte politike, gjegjësisht 11 parti politike, pesë koalicione dhe një listë e pavarur me 84 lista të kandidatëve, që është për 6 lista më shumë në krahasim me 78 listat e kandidatëve në zgjedhjet e vitit 2020 të parashtruara nga 15 subjekte politike, gjegjësisht 12 parti politike dhe 3 koalicione. Pjesëmarrësit në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024 ishin: Koalicioni „Për ardhmërinë evropiane“ i paraprirë nga LSDM, Koalicioni „Maqedonia Jote“ i paraprirë nga VMRO-DPMNE, Koalicioni „Fronti Evropian“ i paraprirë nga BDI, partitë politike E majta - Levica, Avaja, Demokratët, E djathta - Desna, Maqedonia e Vetme, Lëvizja ZNAM, Era e Tretë Maqedone, MORO – Partia punëtore, Alternativa e Re, Rodina Maqedoni, Partia Jote, Koalicioni „Trimërisht për Maqedoninë“, si dhe Grupi i pavarur i zgjedhësve – Gjyle Çeliku.

Sipas KSHZ-së, gjithsej 942 vëzhgues, gazetarë të huaj dhe përkthyes janë akredituar për monitorimin e zgjedhjeve presidenciale, gjegjësisht 342 vëzhgues vendorë dhe 568 të huaj. Numri i vëzhguesve është shumë më i vogël në raport me zgjedhjet e kaluara presidenciale (3 156 vendorë dhe 433 të huaj në rrethin e parë, gjegjësisht 3 321 vendorë dhe 809 të huaj në rrethin e dytë).

Në përbërjen e re parlamentare koalicioni „Maqedonia Jote“ i paraprirë nga VMRO-DPMNE ka 58 deputetë, që është për 14 më tepër nga përbërja e kaluar. Koalicioni „Për ardhmërinë evropiane“ i paraprirë nga LSDM fitoi 18 mandate, që është për 28 më pak nga zgjedhjet e kaluara, duke e realizuar rezultatin më të dobët në

historinë e partisë. Koalicioni „Fronti Evropian” i paraprirë nga BDI fitoi 18 mandate, që shënon një rritje me tre mandate më tepër. Opozita e bashkuar shqiptare „Vlen” fitoi 14 mandate. Numri i mandateve të partisë politike „Levica” u shtua për katër deputetë, duke fituar gjashtë vende. Për herë të parë në Kuvend hyri edhe Lëvizja ZNAM – Për Maqedoninë Tonë, e cila në këto zgjedhje fitoi gjashtë mandate deputetësh. Partitë dhe koalicionet tjera të cilat morën pjesë në këto zgjedhje nuk morën vota të mjaftueshme për ta siguruar përfaqësuesin e tyre në Kuvend.

Në vazhdim të këtij doracaku vijon një vështrim më i hollësishëm i fushatës zgjedhore, të ardhurat dhe shpenzimet e partive dhe koalicioneve gjatë fushatës zgjedhore, njoftimi i medias, rezultatet e zgjedhjeve, respektimi dhe mbrojtja e të drejtave zgjedhore, vlerësimi i zgjedhjeve nga vëzhguesit dhe nga partitë politike, si dhe konkluzionet përmbyllëse për ciklin e tërësishëm zgjedhor.

Fushata zgjedhore

Fushata e zgjedhjeve të rregullta parlamentare zyrtarisht filloi më 18 prill, ndërsa përfundoi në mesnatë, më 6 maj. Fushata u përputh me presidencialen e cila filloi më 4 prill. Temat kryesore të cilat mbizotëronin në fushatën zgjedhore ishin ekonomia, ndryshimet e mundshme kushtetuese, anëtarësimi në BE, politika e jashtme dhe lufta kundër korrupsionit.

Sipas misionin vëzhgues OSBE/ODIHR¹⁰⁵, fushata ishte konkurruese dhe liritë themelore u respektuan. Procesi i promovimit të partive po bëhej më negativ dhe herë pas here përmbante kërcënime, fyerje personale dhe stereotipe siç po afrohej dita e zgjedhjeve. Në kuadër të fushatës u mbajtën një sërë emisionesh debative të ballafaqimit të kandidatëve nga njësitë e ndryshme zgjedhore. Emisionet e ndryshme politike u mbajtën në të gjithë radiodifuzerët kombëtarë dhe u përdorën kryesisht për kritika dhe akuza personale.

Koalicioni „Për Ardhmërinë Evropiane“, i paraprirë nga LSDM, fushatën zgjedhore e udhëhoqi me sloganin „Nuk heqim dorë nga e ardhmja“. Fushata zgjedhore e cila quhej „Programi për të ardhmen evropiane“¹⁰⁶ në 156 faqe i prezantoi qëllimet kryesore të koalicionit, i ndarë në shtatë kapituj: Energjia e re ekonomike e zhvillimit dhe standardit evropian; Administrimi i mirë – Sistem më të mirë dhe të drejtë për të gjithë; Përkujdesja ndaj të gjithëve; Cilësia evropiane e jetesës; Maqedonia e sigurt; MK në BE 2030 dhe Rinia – shtylla e ardhmërisë. Në kapitullin e parë është përqendruar në ekonominë maqedonase për tregun evropian, masat për pavarësi energjetike, zhvillimin ekonomik të gjelbër dhe të bujqësisë. Kapitulli i dytë ka të bëjë me luftën kundër korrupsionit, digjitalizimin, lirinë e medias dhe hapjen e institucioneve për qytetarët. Kapitulli „Përkujdesja ndaj të gjithëve“ ka të bëjë me masat sociale dhe arsimore, kurse, në anën tjetër, kapitulli „Cilësia evropiane e jetesës“ ka të bëjë me mjedisin jetësor dhe zhvillimin e kulturës dhe sportit. Kapitulli i pestë përqendrohet në sigurinë e shtetit, përderisa i gjashti e vërteton zotimin e partisë që shteti të bëhet pjesë e BE-së dhe politikës së jashtme të gjithmbarshme të vendit. Kapitulli i fundit i përkushtohet rinisë, të drejtave të tyre dhe standardit rinor. Fushata onlajn e LSDM-së udhëhoqej përmes internet-faqes së partisë, përmes profileve partiake zyrtare në rrjetet sociale Fejsbuk, Instagram dhe në rrjetin X (Tuiteri i mëparshëm) dhe përmes profileve personale të bartësve dhe të kandidatëve të listave zgjedhore të koalicionit. Videot e mitingjeve dhe takimeve me qytetarët,

105 Misioni vëzhgues ndërkombëtar për zgjedhjet OSBE/ODIHR, Republika e Maqedonisë së Veriut, Zgjedhjet e rregullta parlamentare, 8 maj 2024, Deklaratë për gjetjet fillestare dhe konkluzionet. Qasur në: <https://www.osce.org/files/f/documents/f/8/568321.pdf> (vizita e fundit: 4 qershor 2024)

106 „Nuk lëshojmë pe nga e ardhmja!“, koalicioni Për të ardhmen evropiane. Qasur në: https://sds.org.mk/wp-content/uploads/2024/04/Programa-za-evropska-idnina-web_02.pdf (vizita e fundit: 4 qershor 2024)

përveç në rrjetet sociale u shpallën edhe në kanalin Jutjub¹⁰⁷ të partisë.

Koalicioni i paraprirë nga partia më e madhe opozitare VMRO-DPMNE, „Maqedonia Jote“, në këto zgjedhje e udhëhiqte fushatën me sloganin „Maqedonia sërish e jua-ja!“. Në kuadër të fushatës zgjedhore partia e promovonte programin e saj zgjedhor për periudhën 2024-2028 me titull „Platforma #1198“¹⁰⁸. Programi përmban 1198 projekte, programe, masa dhe politika nëpërmjet të cilave trajtohen problemet e qytetarëve. Programi prezantohet në mbi 240 faqe dhe ndahet në gjashtë shtylla: Lufta për standard jetësor cilësor; Fronti kundër korrupsionit; Institucionet punojnë sipas ligjeve; Sistem funksional të qytetarëve; Patriotizmi që na bashkon; Të drejtat dhe liritë. Fokusi kryesor është vënë në disa përcaktime strategjike: demografia dhe zvogëlimi i shpërnguljes, sfidat dhe aspiratat e të rinjve, krijimi i kushteve të favorshme për biznes, ruajtja e burimeve natyrore dhe mbrojtja e mjedisit jetësor, mbështetja e prodhuesve bujqësorë të vegjël dhe të mesëm, zhvillimi i arsimit cilësor dhe modern, ndërtimi i sistemit shëndetësor cilësor dhe të drejtë dhe mbrojtja e interesit kombëtar. Fushata onlajn e VMRO-DPMNE-së udhëhiqej përmes internet-faqes së partisë, www.vmro-dpmne.org.mk, profileve zyrtare të partisë në rrjetet sociale Fejsbuk, Instagram dhe X, si dhe përmes profileve të bartësve dhe kandidatëve të listave zgjedhore. Videot e mitingjeve dhe takimeve me qytetarët, si dhe nga videospotet dhe spotet muzikore zgjedhore, përveç në rrjetet sociale, u publikuan edhe në kanalin Jutjub¹⁰⁹ të partisë.

Koalicioni „Fronti Evropian“, i udhëhequr nga partia e bllokut shqiptar – BDI, e udhëhiqte fushatën zgjedhore me sloganin „Evropa 2030“. Programi politik i koalicionit¹¹⁰ në 171 faqe u prezantua në tre kapituj: Një kryeministër për të gjithë; Jo pro Rusisë, Po për Evropën; Marrëveshje për konsensus ekonomik. Fokusi kryesor në paraqitjet e kandidatëve të koalicionit “Fronti Evropian” ishin ndryshimet kushtetuese me të cilat Bullgaria e kushtëzon rrugën eurointegruese të vendit. Ky zotim u prezantua në fillimin e fushatës në formën e seancës së improvizuar parlamentare, në të cilën është bërë votimi i ndryshimeve kushtetuese. Në këtë simulim, Ziadin Sela zgjidhet për kryetar Kuvendi, ndërsa Bujar Osmani inaugurohet për president shteti.¹¹¹ Fushata zgjedhore në pjesën dërmuese udhëhiqej përmes

107 Kanali Jutjub i LSDM-së. Në dispozicion në: <https://www.youtube.com/user/SDSMtube> (vizita e fundit: 4 qershor 2024).

108 „Platforma #1198“. Në dispozicion në: <https://vmro-dpmne.org.mk/nporpama> (vizita e fundit: 4 qershor 2024)

109 Jutjub kanali i VMRO-DPMNE-së. Në dispozicion në: <https://www.youtube.com/user/vmrodpmnemacedonia> (vizita e fundit: 6 qershor 2024)

110 “Evropa 2030“. Në dispozicion në: <file:///C:/Users/Dell/AppData/Local/Microsoft/Windows/INetCache/Content.Outlook/I23EOJN5/EU%202030%20Final-1.pdf> (vizita e fundit: 4 qershor 2024)

111 “Me simulim për votimin e ndryshimeve kushtetuese, BDI e filloi fushatën për zgjedhjet parlamentare” Nova Makedonija. <https://novamakedonija.com.mk/makedonija/politika/so-simulacija-za-izglasuvanje-na-ustavnite-izmenit-dui-ja-zapochna-kampanjata-za-parlamentarnite-izbori/> (vizita e fundit: 5 qershor 2024)

faqes zyrtare të BDI-së, përmes profileve zyrtare partiake në rrjetin social Fejsbuk, profileve të bartësve të listave zgjedhore dhe kandidatëve për deputetë, si dhe në kanalit Jutjub të partisë BDI.¹¹²

Koalicioni „Vlen” fushatën e udhëhoqi me moton „Voto numrin që vlen”, ndërsa baza ishte programi me titullin „Plani 2030”.¹¹³ Programi u orientua në proceset e decentralizimit, fuqizimin e komunave, krijimin e bankës shqiptare, zhvillimin e infrastrukturës rrugore dhe energjetike, mbështetjen e diasporës, vendosjen e arsimit dual, zhvillimin e kulturës shqiptare, evropianizimin e gjyqësorit, zotimin e miratimit sa më të shpejtë të ndryshimeve kushtetuese. Krahas takimeve me qytetarët, fushata udhëhiqej edhe përmes ueb faqes zyrtare të koalicionit <https://levizjademokratike.mk/tag/vlen/>, rrjeteve sociale Fejsbuk dhe X, përmes profileve zyrtare partiake dhe përmes profileve të bartësve dhe kandidatëve të listave zgjedhore.

Partia „Levica” garoi me sloganin „Të pakorruptueshmit në Kuvend”, ndërsa në programin e saj¹¹⁴ prezantoi trembëdhjetë kapituj: drejtësi sociale dhe pune, e drejta dhe kundërkorrupsioni, sistemi politik dhe administrata, shoqëria qytetare dhe mediat, ekonomia politike dhe financat, urbanizmi, trafiku dhe vetëqeverisja lokale, kultura, turizmi dhe sporti, arsimit dhe shkenca, shëndetësia, bujqësia, ekologjia dhe energjetika, siguria publike dhe mbrojtja popullore dhe politika e jashtme. Nga programi veçohen propozim-masat, orari gjashtë orësh i punës, vënien e administratës me dy ndërrime, dyfishimin e pushimit të lehonisë, rritjen e pensionit minimal, uljen e pensionit të moshës, shfuqizimin/anulimin e Marrëveshjes së Prespës, Marrëveshjes kornizë të Ohrit dhe Marrëveshjes për fqinjësi të mirë, heqjen e dygjuhësisë dhe shumicën e badenterit. Krahas takimeve me qytetarët, fushata udhëhiqej më së tepërmi përmes faqes zyrtare, <https://levica.mk/>, në rrjetet sociale Fejsbuk, Instagram dhe X, përmes profileve zyrtare partiake dhe përmes profileve të bartësve dhe kandidatëve të listave zgjedhore. Xhirimet e ngjarjeve u shpërndanë përmes rrjeteve sociale dhe kanalit Jutjub¹¹⁵ të partisë.

Në këto zgjedhje partia e sapoformuar Lëvizja - ZNAM mori pjesë për herën e parë në zgjedhjet parlamentare dhe garoi me sloganin „Maksimumi për Maqedoninë.” ZNAM-i u ofroi votuesve programin zgjedhor të prezantuar në 5 faqe. Fokusin kryesor në fushatë ZNAM-i e vendosi në masat për investim në vetëqëndrueshmërinë

112 JutjubkanaliiiBDI-së.Nëdispozicionnë:<https://www.youtube.com/c/BashkimiDemokratikp%C3%ABrIntegrim> (vizita e fundit: 5 qershor 2024)

113 “Plani 2030”. Në dispozicion në: <https://vlen.eu/wp-content/uploads/2024/04/VLEN-Izborna-Programa-MK.pdf> (vizita e fundit: 4 qershor 2024)

114 „Të pakorruptueshmit në Kuvend!”. Në dispozicion në: <https://levica.mk/izborna-programa-2024-cela/> (vizita e fundit: 5 qershor 2024)

115 Jutjub kanali i Levicës. Në dispozicion në: <https://www.youtube.com/channel/Uck1hX0b1siSQjAkyAFGqmCQ> (vizita e fundit: 5 qershor 2024)

energetike, zhvillimin e turizmit mjekësor dhe atij spa, përmirësimin e standard-it jetësor të mjekëve dhe të punonjësve arsimorë, mosvjetërsimin e veprave për krim dhe korrupsion, mbrojtjen e vlerave kombëtare të të gjitha bashkësive etnike dhe zotimin për hyrje në BE pas plotësimit të kushteve që i kanë plotësuar shtetet anëtare të deritashme. Krahas takimeve me qytetarët, fushata udhëhiqej përmes ueb faqes zyrtare, <https://dvizenjeznam.org.mk>, në rrjetin social Fejsbuk, përmes profileve zyrtare partiake dhe përmes profileve të bartësve dhe të kandidatëve të listave zgjedhore. Xhirimet e ngjarjeve u shpërndanë përmes rrjeteve sociale dhe kanalit Jutjub¹¹⁶ të partisë.

Koalicioni „Trimërisht për Maqedoninë“ i paraprirë nga partia GROM, slogani dominues i të cilit është „Maqedonia u takon trimave!“, në fushatën e tij garoi me disa zotime, nga të cilat veçohen zhvillimi i shëndetësisë, ulja e tatimeve, forcimi i bashkëpunimit me Rusinë dhe BRIKS-in, rritjen e pensionit minimal dhe eliminimin e importit të ushqimit. Fushata udhëhiqej përmes ueb faqes zyrtare të GROM-it, <https://grom.mk>, në rrjetin social Fejsbuk, përmes profileve zyrtare partiake dhe përmes profileve të bartësve dhe të kandidatëve të listave zgjedhore. Xhirimet e ngjarjeve u shpërndanë përmes rrjeteve sociale dhe kanalit Jutjub¹¹⁷ të GROM-it.

Partia „Desna“ (E djathta) e prezantoi programin në 11 faqe.¹¹⁸ Theksi kryesor u vu në interesat kombëtarë, heqjen e kuotave lidhur me përkatësinë etnike dhe kriteret tjera, kthimin e ndarjes së vjetër të komunave dhe flamurin e vjetër, vendosjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, etj. Krahas takimeve me qytetarët, fushata udhëhiqej kryesisht përmes ueb faqes zyrtare, <https://desna.org.mk/>, në rrjetin social Fejsbuk, përmes profileve zyrtare partiake dhe përmes profileve të bartësve dhe të kandidatëve të listave zgjedhore. Xhirimet e ngjarjeve u shpërndanë përmes rrjeteve sociale dhe kanalit Jutjub¹¹⁹ të partisë.

Partia Maqedonia e Vetme në zgjedhjet parlamentare garoi me sloganin „Së bashku nuk na bëjnë dot gjë!“ Si zotime parësore të partisë ishin forcimi i bashkëpunimit me Rusinë, prishjen e Marrëveshjes së Prespës, kthimin e organizimit territorial në shtet para vitit 2004, heqjen e përmbarimit privat, shitjen e 10 000 automjeteve zyrtare e të tjera. Krahas takimeve me qytetarët, fushata udhëhiqej përmes ueb faqes zyrtare, <https://edinstvenamakedonija.mk>, në rrjetin social Fejsbuk, përmes

116 Jutjub kanali i Lëvizjes ZNAM. Në dispozicion në: https://www.youtube.com/@dvizenje_znam (vizita e fundit: 5 qershor 2024)

117 Jutjub kanali i GROM-it. Në dispozicion në: <https://www.youtube.com/@grommacedonia> (vizita e fundit: 5 qershor 2024)

118 Programi politik i partisë „Desna“. Në dispozicion në <https://desna.org.mk/izborna-programa-2024/> (vizita e fundit: 5 qershor 2024)

119 Jutjub kanali i partisë „Desna“. Në dispozicion në: <https://www.youtube.com/@Desna24> (vizita e fundit: 5 qershor 2024)

profileve zyrtare partiake dhe përmes profileve të bartësve dhe të kandidatëve të listave zgjedhore. Xhirimet e ngjarjeve u shpërndanë përmes rrjeteve sociale dhe kanalit Jutjub¹²⁰ të partisë.

Alternativa e Re për herën e parë garoi e pavarur në zgjedhjet parlamentare dhe parashtriu listën për katër njësi zgjedhore. Fushatën e udhëhoqi me sloganin „Ligj, Drejtësi. Prosperitet“. Zotimet kryesore të kësaj partie ishin si në vijim: ulja e papunësisë dhe forcimi ekonomik i rajoneve të anashkaluara, përmirësimi i standardit jetësor të pensionistëve, rezistenca ndaj ideve për ndryshime kushtetuese, etj. Krahas takimeve me qytetarët, fushata udhëhoqej përmes ueb faqes zyrtare <https://novaalternativa.mk>, në rrjetin social Fejsbuk, përmes profileve zyrtare partiake dhe përmes profileve të bartësve dhe të kandidatëve të listave zgjedhore.

Partia Demokratët garoi me sloganin „Mjaft më!“, me kërkesë për ndryshime thelbësore në të gjitha fushat e jetës politike, shtetërore dhe shoqërore. Një pjesë të zotimeve të partisë ishin si në vijim: zbatimin e regjistrimit të ri, zvogëlimin e numrit të komunave dhe ministrive, vendosjen e një njësie zgjedhore, ndryshimin e mënyrës së financimit të partive e të tjera. Krahas takimeve me qytetarët, fushata udhëhoqej përmes ueb faqes zyrtare <https://demokrati.mk/>, në rrjetin social Fejsbuk, përmes profileve zyrtare partiake dhe përmes profileve të bartësve dhe të kandidatëve të listave zgjedhore, si dhe përmes kanalit Jutjub¹²¹ të Demokratëve.

MORO – Partia punëtore në zgjedhjet parlamentare garoi me sloganin „T’ua kthejmë vendin rinisë dhe punëtorëve“. Në programin e saj partia u zotua për reforma në më shumë nivele, përkatësisht prishjen e Marrëveshjes së Prespës dhe Marrëveshjes për fqinjësi të mirë, futjen e arsimit falas, heqjen e tatimeve për personat fizikë dhe amvisëritë dhe shtypjen e krimit dhe korrupsionit. Krahas takimeve me qytetarët, fushata udhëhoqej përmes ueb faqes zyrtare <https://rabortnickapartija.org.mk/>, në rrjetin social Fejsbuk, përmes profileve zyrtare partiake dhe përmes profileve të bartësve dhe të kandidatëve të listave zgjedhore, si dhe përmes kanalit Jutjub të partisë.¹²²

Rodina Makedonija garoi në zgjedhjet me sloganin „Rodina kthen Maqedoninë“. Fushata dhe programi zgjedhor¹²³ u bazua në disa zotime, gjegjësisht mbrojtjen e

120 Jutjub kanali i Maqedonia e Vetme. Në dispozicion në: <https://www.youtube.com/user/ndmkanal> (vizita e fundit : 30 qershor 2024)

121 Jutjub kanali i Demokratëve. Në dispozicion në: <https://www.youtube.com/channel/UCsymgpM8yVCHuhO0YfvnQzg> (vizita e fundit: 5 qershor 2024)

122 Jutjub kanali i MORO – Parti punëtore. Në dispozicion në: <https://www.youtube.com/@user-jt4pl5uu9y> (vizita e fundit:05 qershor 2024)

123 “Rruga e Vërtetë Maqedonase” Në dispozicion në: <https://rodina.org.mk/nporpama-2/> (Vizita e fundit: 5 qershor 2024)

familjes tradicionale maqedonase, shtetëzimin e të gjitha subjekteve juridike dhe kompanive me rëndësi strategjike, konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë joligjore, zgjatjen e pushimit të lehonisë, ripozicionimin gjeostrategjik të shtetit, shfuqizimin e të gjitha agjencive dhe institucioneve kompetencat e të cilave tashmë janë dyfishuar e të tjera. Krahas takimeve me qytetarët, partia e udhëhiqte fushatën e saj përmes rrjeteve sociale Fejsbuk , ueb faqen <https://rodina.org.mk/>, përmes profileve zyrtare partiake dhe përmes profileve të bartësve dhe të kandidatëve të listave zgjedhore, si dhe përmes kanalit Jutjub ¹²⁴ të partisë.

Partia Jote për herën e dytë garoi në zgjedhje dhe përdori sloganin „Vendimi është i yti“. Fushata përqendrohej në disa fusha: përmirësimin e të drejtave dhe statusit të punëtorëve, digjitalizimin dhe zhvillimin e arsimit, mbrojtjen e mjedisit jetësor e të tjera. Fushatën e saj onlajn partia e udhëhoqi kryesisht përmes rrjeteve sociale Fejsbuk dhe X, ueb faqen: <https://tvoja.org/>, përmes profileve zyrtare partiake dhe përmes profileve të bartësve dhe të kandidatëve të listave zgjedhore, si dhe përmes kanalit Jutjub ¹²⁵ të partisë.

Partia Avaja, e cila për herën e parë garoi në zgjedhjet parlamentare, kishte lista kandidatësh në katër njësi zgjedhore (NjZ 3, 4, 5 dhe 6). Partia zotohej për përmirësimin e jetesës së Romëve, nxitjen e përfshirjes dhe përfaqësimit të të gjitha bashkësive dhe tejkalimin e pabarazisë në shoqërinë maqedonase. Fushata onlajn udhëhiqej përmes ueb faqes zyrtare <https://avaja.mk/>, rrjetit social Fejsbuk, përmes profileve të bartësve dhe të kandidatëve të listave zgjedhore.

Partia Era e Tretë Maqedonase - Sovranët në këto zgjedhje garoi me moton „Bashkimi për Maqedoninë.“ Fokusi kryesor u vendos në çështjen maqedonase kombëtare, kthimin e bashkimit kombëtar maqedonas, kthimin e emrit, kthimin e borxhit të jashtëm maqedonas dhe sigurimin e pavarësisë energjetike. Partia e udhëhoqi fushatën përmes takimeve me qytetarët, përmes rrjetit social Fejsbuk, përmes profileve zyrtare partiake dhe përmes profileve të bartësve dhe të kandidatëve të listave zgjedhore. Xhirimet e ngjarjeve u shpërndanë përmes rrjeteve sociale dhe kanalit Jutjub¹²⁶ të partisë.

Lista e pavarur e grupit të zgjedhësve Lëvizja qytetare evropiane është subjekti i ri i bllokut politik shqiptar i cili për herën e parë morri pjesë në zgjedhje. Fokusi

124 Jutjub kanali i Rodina Maqedoni. Në dispozicion në: <https://www.youtube.com/@rodinamakedonija> vizita e fundit: 5 qershor 2024)

125 Jutjub kanali i Partia Jote. Në dispozicion në: <https://www.youtube.com/@user-bp1bq1re6o> (vizita e fundit: 5 qershor 2024)

126 Jutjub kanali i Erës së Tretë Maqedonase. Në dispozicion në: <https://www.youtube.com/@makedonskae3340> (vizita e fundit : 5 qershor 2024)

kryesor ishte vënë në krijimin klimës së mirëkuptimit të ndërsjellë, nxitjes së zhvillimit ekonomik, depolitizimit të arsimit, mbrojtjen e ambientit të punës dhe kujdesit për njerëzit me nevoja të posaçme. Partia e udhëhoqi fushatën përmes takimeve me qytetarët, përmes ueb faqes zyrtare <https://www.lqe.mk/>, përmes rrjetit social Fejsbuk, përmes profileve zyrtare partiake dhe përmes profileve të bartësve dhe të kandidatëve të listave zgjedhore.

Financimi i fushatës zgjedhore¹²⁷

Në përputhje me Kalendarin e afateve për kryerjen e veprimeve zgjedhore, pjesëmarrësit e këtyre zgjedhjeve parlamentare ishin të obliguar të dorëzonin katër raporte financiare për shpenzimet e fushatës zgjedhore. Raporti i parë financiar i përfshin 10 ditët e para të fushatës zgjedhore, edhe partitë edhe koalicionet ishin të obliguara që ta dorëzojnë në ditën e njëmbëdhjetë të fushatës zgjedhore, gjegjësisht më 29 prill. Raporti i dytë e përfshin gjysmën e dytë të fushatës zgjedhore, edhe partitë edhe koalicionet ishin të obliguara që ta dorëzojnë një ditë pas mbarimit të fushatës zgjedhore, gjegjësisht më 7 maj. Raporti i tretë financiar i përfshin të ardhurat dhe shpenzimet e llogarisë së transaksionit të partive, nga dita e hapjes së saj deri në ditën e votimit, edhe partitë edhe koalicionet ishin të obliguara që ta dorëzojnë më së voni deri më 31 korrik. Raporti i katërt financiar, i cili ka të bëjë me të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme gjatë tërë fushatës, partitë dhe koalicionet duhet ta parashtrorjnë menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej 30 ditëve nga dita e mbylljes së llogarisë së transaksionit. Llogaritë e transaksionit të partive për fushatën zgjedhore duhet të mbyllën në afat prej 60 ditëve nga shpallja e rezultateve përfundimtare zgjedhore. Raportet financiare parashtrorhen në KSHZ, në Entin Shtetëror të Revizionit (ESHR) dhe në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), ndërsa raporti i katërt financiar parashtrorhet edhe në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu, ESHR është i obliguar që në afat prej 60 ditëve nga parashtrimi i raportit të përgjithshëm financiar të zbatojë revizionin. Gjatë financimit të fushatës zgjedhore, pjesëmarrësit mund të shpenzojnë më së shumti deri në 110 denarë të zgjedhësit të regjistruar në listën zgjedhore, gjegjësisht të komunës për të cilën është parashtruar lista e kandidatëve.

Të gjithë pjesëmarrësit e zgjedhjeve e dorëzuan raportin e parë financiar, përveç partisë Avaja. Raportin e dytë financiar e dorëzuan, por jo në afatin e paraparë ligjor, partitë si në vijim: Partia Jote, Demokratët, Lëvizja Znam dhe Maqedonia e Vetme.

¹²⁷ Raportet financiare të pjesëmarrësve në zgjedhjet parlamentare janë në dispozicion në ueb faqen e Entit Shtetëror të Revizionit (<https://dzt.mk/mk/izbori/parlamentarni-izbori>)

Partitë Alternativa e Re dhe Era e Tretë Maqedone nuk e dorëzuan aspak raportin e dytë. Raportin e tretë financiar përsëri nuk e dorëzuan partitë Alternativa e Re dhe Era e Tretë Maqedone, ndërsa partitë tjera e dorëzuan në afatin e paraparë ligjor. Është me rëndësi të theksohet se në disa raste partitë e dorëzuan raportin në ESHR, por jo në KSHPK dhe anasjelltas, edhe pse në pajtim me Kalendarin, raportet duhet të dorëzohen në të dy institucionet. Raporti i tretë financiar nuk është dorëzuar në asnjë institucion nga Alternativa e Re, Avaja, Era e Tretë Maqedone dhe koalicioni Vlen. Të gjitha partitë tjera e dorëzuan raportin me kohë, përveç Lëvizja ZNAM, që e dorëzoi në ESHR 6 ditë pas afatit të paraparë ligjor.¹²⁸

Sipas raporteve të parashtruara financiare, në fushatën zgjedhore më së shumti mjete shpenzoi koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, gjegjësisht 143 253 905 denarë (2 329 332 euro).¹²⁹ Koalicioni mblodhi aq mjete sa shpenzoi për fushatën zgjedhore, gjegjësisht nuk ka dallim ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve.

Koalicioni i dytë sipas shumës së mjeteve të shpenzuara është koalicioni i udhëhequr nga LSDM, i cili gjatë fushatës zgjedhore shpenzoi gjithsej 98 160 901 denarë (1 596 112 euro). Dhe në këtë rast koalicioni i shpenzoi të gjitha mjetet që i kishte mbledhur.

E treta sipas të ardhurave dhe shpenzimeve në fushatë është koalicioni i udhëhequr nga BDI i cili mblodhi dhe shpenzoi gjithsej 58 899 636 denarë (957 717 euro).

Vijon partia „Levica” sipas lartësisë së shpenzimeve, e cila për këto zgjedhje harxhoi gjithsej 58 899 626 denarë (256 144 euro). Edhe në këtë rast, të ardhurat e përgjithshme janë të barabarta me shpenzimet.

Koalicioni i udhëhequr nga partia GROM mblodhi dhe shpenzoi gjithsej 8 738 486 denarë (142 089 euro).

Të ardhurat dhe shpenzimet për fushatën zgjedhore të partive dhe koalicioneve të cilat i dorëzuan raportet financiare në institucione nuk tejkalojnë shumën prej 2 000 000 denarë. Me fjalë të tjera, partia Demokratët mblodhi dhe shpenzoi gjithsej 1 989 786 denarë (32 354 euro), te Rodina Maqedoni shuma është 1 179 114 denarë (19 173 euro), te Partia Jote të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme janë 1 069 025 denarë (17 383 euro), gjersa të ardhurat e Partisë punëtore janë 565 420,30 denarë (9 194 euro). Sipas raporteve financiare të dorëzuara të Lëvizjes Znam, shpenzimet e përgjithshme të partisë për fushatën zgjedhore janë 499 023 denarë (8 114 euro),

128 Përmbledhja e raporteve të dorëzuara financiare është bërë përfundimisht me datën 7 gusht të vitit 2024.

129 Llogaritjet në euro bëhen me kursin mesatar prej 61,5.

ndërsa të ardhurat janë 0. Partia „Desna” nuk ka pasur aspak të ardhura, as shpenzime për fushatën zgjedhore, ndërsa raporti i partisë Maqedonia e Vetme është i pakompletuar që të mund të llogariten të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme.

Sipas korrelacionit të mjeteve të marra dhe të shpenzuara financiare mund të vërehet se pjesa më e madhe e partive politike kanë shpenzuar aq mjete sa kanë mbledhur, gjë që nuk ka ndodhur në ciklin e kaluar zgjedhor, kur kanë shpenzuar më pak mjete se sa kanë mbledhur. Tejkalmi i shpenzimeve në krahasim me të ardhurat është vërejtur në vetëm një nga njëmbëdhjete raportet e paraqitura, gjë që është një pasqyrë e ndryshme në krahasim me zgjedhjet parlamentare të vitit 2020 kur në tre nga gjithsej dhjetë raporte shpenzimet i tejkalonin të ardhurat.

Raporte financiare të pjesëmarrësve në zgjedhjet e parakohshme parlamentare¹³⁰

	Gjithsej të ardhura	Gjithsej shpenzime
Koalicioni Maqedonia Jote	143 253 905	143 253 905
Koalicioni për Ardhmërinë Evropiane	98 160 901	98 160 901
Koalicioni Fronti Evropian	58 899 626	58 899 626
Levica	15 752 857	15 752 857
Koalicioni Trimërisht për Maqedoninë	8 738 486	8 738 486
Demokratët	1 989 786	1 989 786
Rodina Maqedoni	1 179 114	1 179 114
Partia jote	1 069 025	1 069 025
Partia punëtore	565 420,30	565 420,30
Lëvizja ZNAM	0	499 023
Desna	0	0

130 Përmbledhja e raporteve financiare është bërë në bazë të raporteve financiare që partitë politike i kishin paraqitur në organet shtetërore përkatëse përfundimisht me datën 7 gusht të vitit 2024.

Mediat

Fushata zyrtare për zgjedhjet parlamentare filloi më 18 prill dhe mbaroi më 6 maj, duke u përputhur kështu me rrethin e dytë të fushatës presidenciale që filloi më 4 prill. Kodi zgjedhor kërkon nga të gjitha mediat, duke i përfshirë edhe portalet informative onlajn, që të sigurojnë mbulim të drejtë dhe të balancuar të zgjedhjeve. Rezultatet e monitorimit të medimeve të Misionit ndërkombëtar vëzhgues për zgjedhjet të OSBE/ODIHR¹³¹ tregojnë se mbulimi me lajme lidhur me zgjedhjet në mediat radiodifuzive ishte përgjithësisht i balancuar dhe neutral në ton.

Në raport, që i referohet edhe fushatës për zgjedhjet parlamentare edhe fushatës për rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, tregohet se Kodi zgjedhor është ndryshuar në procedurë të përsheptuar jomjaftueshëm transparente dhe pa u konsultuar me publikun, gjë që nuk është në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe angazhimet e OSBE-së. Misioni ndërkombëtar për vëzhgimin e zgjedhjeve thotë se një sërë rekomandimesh kryesore të ODIHR-së dhe Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës kanë mbetur të pazgjydhura, duke i përfshirë edhe ato për rishikimin sistematik të Kodit zgjedhor, për sigurimin e qasjes së barabartë të mediave në fushatat zgjedhore dhe për rritjen e llogaridhënies dhe integritetit të financimit të fushatës.

Monitorimi i medimeve nga Misioni ndërkombëtar vëzhgues për zgjedhjet të ODIHR-së tregon se shërbimi radiodifuziv publik Radio Televizioni Maqedonas (RTM) siguroi mbulimin e të gjithë pjesëmarrësve të zgjedhjeve parlamentare në pajtim me dispozitat ligjore me të cilat vendoset korniza për ndarjen e kohës së partive politike në zgjedhjet, me çka kanë qenë të privilegjuar ata që tashmë kanë mandate në Kuvend.

Radiodifuzerët janë përqendruar në partitë e mëdha dhe në koalicionet, me ç' rast, në tërësi, LSDM, VMRO-DPMNE, BDI dhe VLEN ishin më së shumti të përfshira në terminet kryesore. Koalicionet e paraprirë nga LSDM dhe nga VMRO-DPMNE kanë dominuar te radiodifuzerët privat (me nga 24 dhe 27 përqind mbulim), që të dyja kryesisht me ton neutral. Monitorimi tregon se Alsat-M dhe Telma kanë siguruar mbulim më të balancuar për dallim nga radiodifuzerët tjerë të vëzhguar, Kanal 5 kryesisht është përqendruar në LSDM-në dhe VMRO-DPMNE-në në masë të madhe me ton neutral.

131 OSBE/ODIHR DEKLARATË PËR GJETJET DHE PËRFUNDIMET PRELIMINARE – Zgjedhjet parlamentare dhe rrethi i dytë i zgjedhjeve presidenciale, 8 maj 2024. Në dispozicion në <https://www.osce.org/files/f/documents/f/8/568321.pdf> (vizita e fundit: 13.6.2024).

Radiodifuzerët kanë qenë të obliguar të përshtatnin një edicion të emisioneve të tyre me lajme dhe një përmbajtje ditore lidhur me zgjedhjet për të përmbushur nevojat e personave me dëmtime shqisore. Sipas OSBE/ODIHR-së është pozitive se, në pajtim me ligjin, radiodifuzerët kombëtarë publikë dhe privatë që ishin vëzhguar nga misioni i vëzhgimit kanë pasur pjesë të përmbajtjeve të tyre në terminet kryesore me titra ose me gjuhën e shenjave gjatë tërë fushatës zgjedhore.

Agjencia Mediatike për Shërbime Audio dhe Audiovizuale (ASHMA)¹³² ka për detyrë që të monitorojë prezantimin zgjedhor të partive dhe të kandidatëve si dhe shërbimin programor të radiodifuzerëve, nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në përfundimin e votimit në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve.

Monitorimi i shërbimit radiodifuziv publik

Edhe te RTM 1 edhe te RTM 2, të dhënat e monitorimit tregojnë se detyrimet e dala nga neni 76-a paragrafët 2 dhe 3¹³³ nuk mundësojnë mbulim thelbësor të procesit zgjedhor.

Arsyeja kryesore për këtë gjë ishte produksioni. Kishte mungesë të stafit primar gazetaresk, gjegjësisht të rrjetit korrespondent plotësues, të përditësuar, të pozicionuar në mënyrë adekuate dhe të standardizuar teknikisht që do të mund të ndiqte me kohë trajektoren e përkthuar të planit promovues për karvanët zgjedhorë. Për gjendjen faktike të tillë, disa redaksi të caktuara e kanë njoftuar ASHMA-në qysh para fillimit të fushatës. Megjithatë, për të ofruar sa më tepër informacion, ato qëndruan të hapur ndaj marrëdhënies së komunikimit të kundërt, pasiv, domethënë çdo pjesëmarrës në procesin zgjedhor do ta dorëzonte materialin e vet promovues ose redaksitë do ta merrnin lirshëm prej profileve të tyre zyrtare në rrjetet sociale.

Monitorimi i ASHMA-së analizoi gjithsej 17 edicione të Ditarit në orën 19 e 30 minuta, gjegjësisht është analizuar materiali prej gjithsej 8 orë 34 minuta e 54 sekonda të emetuara në Shërbimin e parë programor (RTM 1).

132 Prezantimi mediatik zgjedhor në rrethin e dytë të fushatës zgjedhore – prej 25 prill deri më 6 maj –Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Në dispozicion në <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2024/05/ИЗВЕШТАЈ-ПАРЛАМЕНТАРНИ-Избори-2024-финален.pdf> (vizita e fundit: 13.6.2024).

133 Paragrafi 2 parasheh që gjatë kohës së fushatës zgjedhore Servisi radiodifuziv publik është i obliguar që të sigurojë qasje të barabartë në programin informativ me ç' rast 30% të kohës emetohet për ngjarjet ditore të vendit e botës, 30% të kohës për aktivitetet e partive politike në pushtet, 30% të kohës për aktivitetet e partive politike në opozitë dhe 10% të kohës për aktivitetet e partive politike që nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe për kandidatët e pavarur. Paragrafi 3 parasheh që koha për informimin e aktiviteteve të fushatës së partive politike do të shpërndahet konform parimeve për raportim të balancuar. – Kodi Zgjedhor. Në dispozicion në <https://drive.google.com/file/d/1ZJMrucqNI-yC5VuWSzpfT9BFekpHm5An/view>

Tabela 1: Përfaqësimi i subjekteve në lajmet
Burimi: ASHMA

	RTM 1	RTM 2
Koalicioni për të ardhmen evropiane	0:51:10	0:47:30
Koalicioni „Maqedonia Jote“ VMRO-DPMNE	0:23:41	0:25:07
Koalicioni Fronti evropian	1:03:40	1:06:00
Koalicioni VLEN	0:33:06	0:33:11
Lëvizja ZNAM - Për Maqedoninë tonë	0:16:29	0:07:14
Levica/E majta	0:33:49	0:32:05
Partia Desna/E djathta		
Alternativa e re Shkup	0:02:49	0:01:09
Koalicioni Trimërisht për Maqedoninë	0:32:54	0:31:56
Partia politike AVAJA	0:03:20	0:01:47
Partia e punës	0:06:40	0:02:14
Maqedonia e bashkuar		
DEMOKRATËT	0:04:31	0:02:53
Partia jote		
Rodina Maqedoni	0:01:04	0:00:18
Era e tretë maqedonase/Listat e pavarura maqedonase	0:01:24	0:00:45
Partia Lëvizja qytetare evropiane	0:00:58	0:04:13
Gjithsej	4:35:35	4:16:22

Për aktivitetet e partive të pushtetit, në lajmet qendrore të analizuara, RTM 1 ndau 2 orë dhe 30 minuta, ndërsa për aktivitetet e partive në opozitë 2 orë e 36 minuta. Duke pasur parasysh se fushata për Zgjedhjet parlamentare përputhet pjesërisht me fushatën për të dy rrethet e Zgjedhjeve presidenciale (filloi më 4 prill dhe zgjati deri më 6 maj), në kohën për partitë e pushtetit hynë aktivitetet për Zgjedhjet parlamentare të dy koalicioneve – Koalicioni për të ardhmen evropiane dhe Koalicioni „Fronti evropian“, të paraprirë nga LSDM dhe BDI, si dhe aktivitetet e kandidatëve për president të shtetit që ata i kanë mbështetur Stevo Pendarovski dhe Bujar Osmani. Aktivitetet e të dy kandidatëve ndërlidhen me mbarimin e rrethit të parë për Zgjedhjet presidenciale (prej 18 deri më 22 prill), por ato të Stevo Pendarovskit, duke pasur parasysh se ka marrë pjesë edhe në rrethin e dytë zgjedhor, janë përfshirë deri në fund të procesit zgjedhor.

Kohën për aktivitetet e partive opozitare të përfaqësuara në Kuvend (2 orë e 36 minuta) e përbëjnë promovimet zgjedhore të katër subjekteve politike që morën pjesë në Zgjedhjet parlamentare: Koalicioni „Maqedonia Jote“ – VMRO-DPMNE, Koalicioni VLEN, Koalicioni „Trimërisht për Maqedoninë“ dhe partia Levica. Në këtë termin kohor janë përfshirë edhe aktivitetet që i kanë pasur kandidatët presidencialë të cilët ata i kanë mbështetur, në periudhën prej 18 deri më 22 prill, kur përputheshin fushatat e rrethit të parë të Zgjedhjeve presidenciale me fillimin e fushatës për Zgjedhjet parlamentare. Në terminin kohor të partive politike në opozitë, hyn edhe koha për Gordana Siljanovska-Davkovën, kandidate për president të shtetit e mbështetur nga VMRO-DPMNE, e cila u plasua në rrethin e dytë zgjedhor.

Për aktivitetet e fushatave të partive politike që nuk janë të përfaqësuara në Kuvend, RTM 1 ka ndarë rreth 42 minuta në edicionin qendror të Ditarit. Kjo sasi e informacionit i përfshin raportimet për aktivitetet zgjedhore të tetë partive pjesëmarrëse në Zgjedhjet parlamentare: Lëvizja ZNAM – për Maqedoninë tonë; Partia e punës; Demokratët; partia politike AVAJA; Alternativa e re Shkup; Era e tretë maqedonase/Listat e pavarura maqedonase; Rodina Maqedoni dhe Lëvizja qytetare evropiane. Në një pjesë të kësaj kohe janë përfshirë edhe informacionet e fushatës zgjedhore të Maksim Dimitrievskit, kandidatit për president të mbështetur nga Lëvizja ZNAM, për shkak të përputhjes së pjesshme të fundit të fushatës për rrethin e parë të Zgjedhjeve presidenciale me fillimin e fushatës për Zgjedhjet parlamentare.

Në periudhën prej 18 prill deri më 6 maj për Koalicionin „Fronti evropian“ ishin ndarë 1 orë e 3 minuta, për Koalicionin për të ardhmen evropiane - 51 minuta. Për Levicën, Koalicionin Trimërisht për Maqedoninë dhe Koalicionin VLEN – ishin ndarë me nga 33 minuta, ndërsa për Koalicionin „Maqedonia Jote“, i paraprirë nga VMRO-DPMNE ishin ndarë 24 minuta.

Monitorimi i shërbimit të dytë programor (RTM 2) analizoi gjithsej 17 edicione të Ditarit në orën 18 e 30 minuta, gjegjësisht është analizuar material prej gjithsej 8 orë 26 minuta e 54 sekonda.

Për të dy koalicionet e paraprirë nga BDI dhe LSDM, respektivisht për partitë e pushtetit së bashku ishin ndarë - 1 orë 53 minuta e 30 sekonda, përkatësisht, veças – për Koalicionin për të ardhmen evropiane (LSDM) - 47 minuta e 30 sekonda, ndërsa për Koalicionin „Fronti evropian“ (BDI) - 1 orë e 6 minuta.

Për aktivitetet zgjedhore të fushatave të partive politike në opozitën parlamentare, respektivisht për katër subjekte, u ndanë gjithsej 2 orë 3 minuta e 8 sekonda, gjegjësisht: Koalicioni VLEN ka marrë - 33 minuta e 11 sekonda; Koalicioni „Maqedonia

Jote“ (VMRO-DPMNE) - 25 minuta e 7 sekonda; partia Levica - 32 minuta e 54 sekonda, ndërsa Koalicioni Trimërisht për Maqedoninë (GROM) - 31 minuta e 56 sekonda. Raportimi për aktivitetet e partive politike që nuk janë të përfaqësuara në Kuvend është përfshirë me kohë informative prej 22 minuta e 48 sekonda.

Monitorimi i mediave komerciale

Objekt i monitorimit i ASHMA-së ishin nëntë televizione kombëtare komerciale: TV Alsat-M, TV Alfa, TV Kanal 5, TV Sitel, TV Telma, TV 21-M, TV Klan, TV Shenja dhe TV 24 Vesti.

Raporti vë në dukje se asnjëra nga redaksitë informative nuk arriti plotësisht që ta përmbushë obligimin për mbulim të balancuar të procesit zgjedhor në bazë të parimit të proporcionalitetit sipas numrit të listave të vërtetuara të kandidatëve për deputetë të përshkruara në nenin 75-a paragrafi 1 pika 6 e Kodit zgjedhor (KZ). Vetëm TV Alsat-M ka informuar për aktivitetet e të gjithë 17 pjesëmarrësve në procesin zgjedhor.

Raportimi në TV Ditarët/lajmet për ngjarjet e përditshme në procesin zgjedhor, te të gjitha redaksitë informative ka qenë pothuajse identik: prezantim regjistruar ofertash politike, shpesh i ndarë në rubrikë të posaçme informative – përmbledhje poentash të nxjerra nga fjalimet e kandidatëve për deputetë.

Arsyeja kryesore për mosarritjen e raportimit mediatik proporcional të kushtëzuar ligjërishit ishte produksioni. Kishte mungesë të stafit primar gazetaresk, gjegjësisht të rrjetit korrespondent plotësues, të përditësuar, të pozicionuar në mënyrë adekuate dhe të standardizuar teknikisht që do të mund të ndiqte me kohë trajektorin e përshkruar të planit promovues për karvanët zgjedhorë.

Televizionet tjera raportimin e përqendruan kryesisht në katër koalicionet më të mëdha të pushtetit dhe të opozitës: Koalicioni për të ardhmen evropiane, Koalicioni „Fronti evropian“, Koalicioni „Maqedonia Jote“ – VMRO-DPMNE, dhe Koalicioni VLEN. ASHMA konkludon se nuk ka pasur dallime të mëdha në kohën që u është ndarë atyre, me përjashtim të TV Klan Macedonia që ka ndarë dyfish më shumë kohë për „Frontin evropian“ në raport me tre koalicionet tjera.

Tabela 2: Përfaqësimi i subjekteve në lajmet e radiodifuzerëve komercialë
Burimi: ASHMA

	TV Alsat - M	TV Alfa	TV Kanal 5	TV Sitel	TV Telma	TV 24 Vesti	TV Sonce	TV Klan Macedonia	TV 21- M
Koalicioni për të ardhmen evropiane	0:10:58	0:20:57	0:25:06	0:25:03	0:22:06	0:23:15	0:15:03	0:25:07	0:31:07
Koalicioni „Maqedonia Jote“ VMRO-DPMNE	0:16:54	0:30:42	0:33:09	0:33:52	0:28:21	0:20:35	0:11:54	0:27:43	0:35:25
Koalicioni Fronti evropian	0:15:19	0:18:11	0:19:04	0:18:15	0:23:48	0:09:42	0:02:19	0:52:07	0:55:41
Koalicioni VLEN	0:23:29	0:13:33	0:14:34	0:16:47	0:27:32	0:10:34	0:01:44	0:26:01	0:59:40
Lëvizja ZNAM - Për Maqedoninë tonë	0:09:09	0:09:31	0:13:01	0:11:14	0:23:50	0:12:48	0:03:43	0:09:54	0:10:30
Levica/E majta	0:06:46	0:08:04	0:02:53	0:07:17	0:10:20	0:08:25	0:01:59	0:05:04	0:03:42
Partia Desna/E djathta	0:05:01					0:01:07			0:00:24
Alternativa e re Shkup	0:05:16	0:04:35	0:02:27	0:00:41	0:04:36	0:01:42	0:03:55	0:01:30	0:02:45
Koalicioni Trimërisht për Maqedoninë	0:03:57	0:08:45	0:03:43	0:04:24	0:07:36	0:05:59	0:03:52	0:01:30	0:03:10
Partia politike AVAJA	0:04:57	0:03:13		0:00:28	0:01:08	0:00:35		0:00:22	0:02:35
Partia e punës	0:04:15	0:01:03		0:00:51		0:00:56			0:00:25
Maqedonia e bashkuar	0:05:35					0:00:34			
DEMOKRATËT	0:05:26	0:04:47		0:02:01	0:02:03	0:02:56	0:04:00	0:00:58	0:02:40
Partia jote	0:04:31	0:00:38							0:02:13
Rodina Maqedoni	0:05:33	0:01:05	0:00:25		0:01:15				
Era e tretë maqedonase/Listat e pavarura maqedonase	0:04:50	0:00:55							
Partia Lëvizja qytetare evropiane	0:04:50								0:00:46
Gjithsej	2:16:46	2:05:59	1:54:22	2:00:53	2:32:35	1:39:08	0:48:29	2:30:16	3:31:03

Në suaza të monitorimit, nga programi i TV Alsat-M u analizuan 17 edicione të Ditarit në orën 19 me kohëzgjatje prej 6 orë 55 minuta e 28 sekonda, nga të cilat për fushatën zgjedhore u ndanë 2 orë 16 minuta e 46 sekonda.

Më së shumti kohë informative në edicionet e ditarit të orës 19 tërhiqen aktivitetet e Koalicionit opozitar VLEN - 23 minuta e 29 sekonda; më tej Koalicioni i paraprirë nga VMRO-DPMNE „Maqedonia Jote“ - 16 minuta dhe 54 sekonda; Koalicioni „Fronti evropian“, i paraprirë nga BDI në pushtet - 15 minuta e 19 sekonda dhe Koalicioni për të ardhmen evropiane, i bashkuar përreth LSDM-së - 10 minuta e 58 sekonda. Të gjithë pjesëmarrësit tjerë në fushatën zgjedhore u përfaqësuan me minutazh njëshifror prej 4 deri në 9 minuta.

Lidhur me televizionin Alfa, monitorimi përfshiu 17 edicione të Ditarit në orën 17.30, me kohëzgjatje të përgjithshme 9 orë 9 minuta dhe 43 sekonda, nga të cilat 2 orë 5 minuta e 59 sekonda ishin kontribute për fushatën zgjedhore. Megjithatë, parë

në tërësi, në kohën e përgjithshme informative të ndarë për fushatën zgjedhore u përfaqësuan 14 oferta zgjedhore për deputetët e rinj të popullit, ndërsa në mesin e tyre, kohë dyshifrore për prezantimin zgjedhor kanë marrë koalicionet qeveritare dhe opozitare me numër më të madh „Maqedonia Jote“ nën udhëheqjen e VMRO-DPMNE-së 30 minuta e 42 sekonda, VLEN 13 minuta dhe 33 sekonda, E ardhmja evropiane e paraprirë nga qeveritarja LSDM 20 minuta e 57 sekonda dhe „Fronti evropian“ nën udhëheqjen e BDI-së 18 minuta dhe 11 minuta.

Objekt i monitorimit të televizionit Kanal 5 ishin Lajmet në orën 18, ku u analizuan 17 edicione me kohëzgjatje prej 6 orë 44 minuta e 49 sekonda. Prej tyre, 1 orë 54 minuta e 22 sekonda ishin kontributet për fushatën zgjedhore. Ky televizion raportoi për 9 nga gjithsej 17 oferta zgjedhore, ndërsa minutazhë më të madhe morën Koalicioni „Maqedonia Jote“ i udhëhequr nga VMRO-DPMNE 33 minuta dhe 9 sekonda, më tej Koalicioni për të ardhmen evropiane i udhëhequr nga LSDM 25 minuta e 6 sekonda, Koalicioni Fronti evropian i BDI-së mori 19 minuta dhe 4 sekonda, ndërsa VLEN-i 14 minuta e 34 sekonda.

Nga programi i televizionit Sitel u analizuan 17 edicione të Ditarit qendror në orën 19, me kohëzgjatje prej 9 orë 32 minuta e 35 sekonda nga të cilat 2 orë dhe 53 sekonda ishin për fushatën zgjedhore. TV Siteli në ditarin e orës 19 arriti t'i prezantojë 11 nga 17 pjesëmarrësit në periudhën e procesit zyrtar zgjedhor, ndërsa në mesin e tyre, minutazh më të rëndësishëm mediatik, morën, para së gjithash, koalicionet qeveritare dhe opozitare më të mëdha: „Maqedonia Jote“ (VMRO-DPMNE) 33 minuta e 52 sekonda, E ardhmja evropiane (LSDM) 25 minuta e 3 sekonda, VLEN 16 minuta e 47 sekonda dhe „Fronti evropian“ (BDI) 18 minuta e 15 sekonda.

Raporti i monitorimit e përfshin edhe televizionin Telma, ku janë analizuar 17 edicione të Lajmeve në orën 21:30, me kohëzgjatje prej 6 orë 28 minuta e 54 sekonda, nga të cilat 2 orë 32 minuta dhe 35 sekonda ishin kontribute për fushatën zgjedhore dhe procesin zgjedhor. Minutazh më të madh në këtë televizion mori Koalicioni „Maqedonia Jote“ VMRO-DPMNE - 28 minuta e 21 sekonda, më tej Koalicioni VLEN - 27 minuta e 32 sekonda, Koalicioni Fronti evropian - 23 minuta e 48 sekonda, për Lëvizjen ZNAM – Për Maqedoninë tonë u ndanë 23 minuta e 50 sekonda, e për Koalicionin e ardhmja evropiane të LSDM-së – 22 minuta e 06 sekonda.

Në kuadër të monitorimit, nga programi i televizionit 24 Vesti u analizua Ditari në orën 20, gjithsej 17 edicione me kohëzgjatje prej 4 orë 26 minuta e 51 sekonda, nga të cilat për fushatën zgjedhore u ndanë 1 orë 39 minuta e 8 sekonda. Më së shumti është raportuar për Koalicionin për të ardhmen evropiane të udhëhequr nga LSDM 23 minuta e 15 sekonda dhe për Koalicionin „Maqedonia Jote“ VMRO-DPMNE 20 minuta 35 minuta.

Rezultatet e zgjedhjeve të rregullta parlamentare në 2024

Në zgjedhjet e rregullta parlamentare, të cilat u mbajtën më 8 maj të vitit 2024, të drejtën e votës e shfrytëzuan gjithsej 1 006 436 votues prej 1 815 350 votuesve të regjistruar. Dalja në këto zgjedhje ishte 55,44%, që shënon rritje në krahasim me zgjedhjet e kaluara parlamentare në v. 2020 kur dalja ishte 52,02%.¹³⁴

Në këto zgjedhje morën pjesë gjithsej 11 parti politike, 1 listë e pavarur zgjedhësish dhe pesë koalicione me 84 lista¹³⁵ kandidatësh siç janë, koalicioni „Për të Ardhmen Evropiane“ i paraprirë nga LSDM, koalicioni „Maqedonia Jote“ i paraprirë nga VMRO-DPMNE, koalicioni „Trimërisht për Maqedoninë“ i paraprirë nga GROM, koalicioni „Fronti Evropian“ i paraprirë nga BDI, koalicioni „Vlen“, Levica-E Majta, Lëvizja ZNAM, Maqedonia e Vetme, Alternativa e Re - Shkup, Avaja, Lëvizja Qytetare Evropiane¹³⁶, Era e Tretë Maqedonase– Sovranët, Partia Jote, Rodina Maqedoni, Desna-E djathta, Demokratët dhe Partia punëtore.

Sipas rezultateve të shpallura nga KSHZ-ja¹³⁷, më së shumti vota në zgjedhjet e rregullta parlamentare më maj të vitit 2024 fitoi koalicioni „Maqedonia Jote“ i paraprirë nga partia opozitare VMRO-DPMNE ose 436 407, që është 43,36 % nga numri i përgjithshëm i votave. Me këtë, koalicioni fitoi 58 mandate deputetësh ose 14 mandate më shumë nga zgjedhjet e kaluara parlamentare.

Në vendin e dytë është koalicioni i paraprirë nga partia qeveritare LSDM, e cila fitoi gjithsej 154 447, gjegjësisht 281 960 vota më pak se VMRO-DPMNE, që është 15,35% nga numri i përgjithshëm i votave. Koalicioni „Për të Ardhmen Evropiane“ fitoi 18 mandate deputetësh kundrejt 46 mandateve të fituara në zgjedhjet e kaluara parlamentare. Për dallim nga zgjedhjet e fundit, nuk pati betejë të ngushtë ndërmjet dy partive më të mëdha të bllokut politik maqedonas, gjegjësisht partia LSDM humbi një numër të konsiderueshëm votash dhe fitoi 40 vende deputetësh më pak se koalicioni i paraprirë nga VMRO-DPMNE.

Në vendin e tretë është koalicioni „Fronti Evropian“ i paraprirë nga BDI. Koalicioni fitoi 137 690 vota, gjegjësisht 18 vende deputetësh. Partitë opozitare të bllokut politik shqiptar, gjegjësisht Lëvizja demokratike, Lëvizja BESA, Alternativa dhe një pjesë e partisë Aleanca për Shqiptarët, përmes koalicionit „Vlen“ synonin që ta mënjano-

¹³⁴ Për të gjitha të dhënat lidhur me rezultatet e zgjedhjeve parlamentare është përdorur faqja e internetit e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. Qasur në: <https://rezultati.sec.mk/> (vizita e fundit: 10 qershor 2024).

¹³⁵ Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2020 kishte 78 lista kandidatësh që është për 6 më pak se listat e parashtruara për zgjedhjet parlamentare në vitin 2024. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2020 morën pjesë 12 subjekte politike, gjegjësisht tre koalicione dhe nëntë parti politike.

¹³⁶ Lista e pavarur e zgjedhësve e paraprirë nga dr. Gjyle Çeliku.

¹³⁷ Rezultate në bazë të të dhënave të KSHZ-së përfundimisht deri më 10 qershor 2024.

nin BDI-në nga pushteti dhe që ta dobësonin fuqinë e saj politike si parti më e madhe në bllokun politik shqiptar. Ky koalicion fitoi 106 937 vota, gjegjësisht 14 vende deputetësh, dhe ndodhet në vendin e katërt sipas numrit të votave të fituara.

Partia politike „Levica” ndodhet në vendin e pestë sipas numrit të votave të fituara. Për listat e kandidatëve të kësaj partie votuan 68 637 votues, që paraqet 6,82% nga numri i përgjithshëm i votave, gjegjësisht 6 vende të fituara deputetësh, që paraqet një rritje domethënëse prej zgjedhjeve parlamentare të kaluara, kur fitoi 2 vende deputetësh.

Në vendin e gjashtë ndodhet partia e sapoformuar Lëvizja ZNAM, e udhëhequr nga kryetari i Kumanovës dhe kandidati në zgjedhjet presidenciale Maksim Dimitrievski. Lëvizja ZNAM për një kohë relativisht të shkurtër fitoi mjaft popullaritet si një parti e re dhe mori 56 232 vota, respektivisht 5,59% nga numri i përgjithshëm i votave dhe 6 mandate.

Partitë dhe koalicionet tjera, gjegjësisht koalicioni „Trimërisht për Maqedoninë” i paraprirë nga GROM fitoi 4522 vota (0,45 %), Alternativa e re – Shkup fitua 3 515 vota (0,35 %), AVAJA 2908 vota (0,29 %), Partia Jote 1794 vota (0,18 %), Maqedonia e Vetme fitoi 1688 vota (0,17%), Rodina Maqedoni fitoi 1 099 vota (0,11 %), Era e Tretë Maqedonase – Sovranët fitoi 966 vota (0,10 %), Partia politike Desna- E djathta fitoi 535 vota (0,05 %), Demokratët 912 vota (0,09%) Partia Punëtore fitoi 450 vota (0,04 %) dhe Lëvizja Qytetare Evropiane fitoi 241 vota (0,02%). Partitë e lartpërmendura nuk arritën të sigurojnë vende deputetësh në përbërjen e re të Kuvendit.

Kundërshtimet e parashtruara nga koalicioni i paraprirë nga VMRO-DPMNE dhe nga koalicioni „Vlen” KSHZ-ja i pranoi dhe u bë rivotimi në NJZ 5 dhe 6, në shtatë vendvotime, respektivisht në vendvotimin 1272 në komunën e Ohrit, 1194 dhe 1202 në Krushevë, 1470 dhe 1470/1 në Dollneni dhe 1844 në Strugë, gjersa në njësinë e gjashtë zgjedhore u bë rivotimi në vendvotimin 2101 në Zhelinë. 138 Pas rivotimit, koalicioni „Vlen” fitoi edhe një mandat në NJZ 6, përderisa koalicioni „Fronti Evropian” humbi një mandat në njësinë e njëjtë zgjedhore. Në NJZ 5 nuk kishte ndryshime në shpërndarjen e mandateve pas rivotimit. 139

Nga aspekti gjinor, 42,42 % nga numri i përgjithshëm i kandidatëve janë gra, 140 kjo përqindje është në pajtim me kuotën e paraparë minimale prej 40 % për pjesëmar-

138 “Rivotim në shtatë vendvotime për Zgjedhjet parlamentare 2024” Lider.mk, Në dispozicion në: <https://lider.mk/preglasuvanje-vo-sedum-izbirachki-mesta-za-parlamentarnite-izbori-2024/> (vizita e fundit: 30 maj 2024)

139 Konkluzion për shpalljen e rezultatetve përfundimtare dhe shpërndarjen e mandateve për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e RMV-së për NJZ 5 dhe 6 nga zbatimi i Zgjedhjeve parlamentare , Në dispozicion në: <https://www.sec.mk/parlamentarni-izbori-2024/> (vizita e fundit: 30 maj 2024)

140 Një e treta gra dhe vetëm dy të rinj në përbërjen e re të Kuvendit maqedonas” Radio MOF. Në dispozicion në: (<https://www.radiomof.mk/infografik-edna-tretina-zheni-i-samo-dvajca-mladi-vo-noviot-sostav-na-makedonskotosobranie/> vizita e fundit: 30 maj 2024)

rjen në listat e kandidatëve të gjinisë më pak të përfaqësuar. Në krahasim me zgjedhjet e mëparshme të parakohshme parlamentare në vitin 2020, kur përqindja e grave kandidatë për deputete ishte 43 %, në këto zgjedhje është vërejtur një zvogëlim minimal prej 1 përqind më pak.

Është vërejtur një rritje minimale, lidhur me numrin e grave bartëse të listave të kandidatëve. Me fjalë të tjera, në këto zgjedhje parlamentare 25% e bartësve të listave të kandidatëve për deputetë ishin gra (21 gra nga gjithsej 84 lista), përdërisa në zgjedhjet në vitin 2020 kjo përqindje ishte 24% (18 gra nga gjithsej 78 lista). Në anën tjetër, sipas rezultateve zgjedhore, 40 nga gjithsej 120 vende deputetësh u takuan grave (33%). Duke pasur parasysh se në zgjedhjet parlamentare në vitin 2020 u zgjodhën 43 gra për deputete (36%), mund të vërehet se përbërja e re parlamentare filloi me punë me 3 gra deputete më pak krahasuar me përbërjen e kaluar.¹⁴¹

Pasqyra tabelore e rezultateve të zgjedhjeve parlamentare 2024

Zgjedhës të regjistruar në Listën zgjedhore	Partia/Koalicioni	Vota gjithsej	Vota gjithsej %	Mandatet e fituara
1 815 350	Koalicioni Maqedonia Jote – VMRO-DPMNE	436 407	43,36%	58
	Koalicioni Për të Ardhmen Evropiane - LSDM	154 447	15,35%	18
	Koalicioni Fronti Evropian	137 690	13,68%	18
	Koalicioni VLEN	106 937	10,63%	14
	Levica-E majta	68 637	6,82%	6
	Lëvizja - ZNAM	56 232	5,59%	6
	Koalicioni Trimërisht për Maqedoninë - GROM	4 522	0,45%	0
	Maqedonia e Vetme	1688	0,17%	0
	Desna-E djathta	535	0,05%	0
	Demokratët	912	0,09%	0
	AVAJA	2 908	0,29%	0
	Era e Tretë Maqedonase - Sovranët	966	0,10%	0
	Alternativa e Re	3 515	0,35%	0
	Partia Jote	1 794	0,18%	0
	Rodina Maqedoni	1 099	0,11%	0
	Lëvizja Qytetare Evropiane	241	0,02%	0
	Partia Punëtore	450	0,04%	0

¹⁴¹ Misioni vëzhgues për zgjedhjet i OSBE/ODIHR-së (2024) Zgjedhjet e rregullta parlamentare 8 maj 2024 – Konkluzionet preliminare. Në dispozicion në: <https://www.osce.org/files/f/documents/f/8/568321.pdf> (vizita e fundit: 31 maj 2024)

Sipas njësive zgjedhore raporti i partive/koalicioneve të cilat siguruan hyrjen në Ku-vend është si më poshtë:

Njësia zgjedhore	Zgjedhës të regjistruar në Listën zgjedhore	Partia/Koalicioni	Vota gjithsej	Vota gjithsej %	Man-datet e fituara
NjZ 1	313 183	Koalicioni Maqedonia Jote	80 963	41,63%	10
		Koalicioni Për të Ardhmen Evropiane	27 164	13,97%	3
		Koalicioni Fronti Evropian	20 586	10,58%	2
		Koalicioni VLEN	21 627	11,12%	2
		Levica-E majta	20 989	10,79%	2
		Lëvizja - ZNAM	11 944	6,14%	1
Dalja	62,10%				
NjZ 2	321 087	Koalicioni Maqedonia Jote	66 422	37,72%	8
		Koalicioni Për të Ardhmen Evropiane	18 631	10,58%	2
		Koalicioni Fronti Evropian	30 625	17,39%	4
		Koalicioni VLEN	25 864	14,69%	3
		<i>Levica-E majta</i>	10 654	6,05%	1
		Lëvizja - ZNAM	16 264	9,24%	2
Dalja	54,84%				
NjZ 3	275 034	Koalicioni Maqedonia Jote	96 545	58,29%	14
		Koalicioni Për të Ardhmen Evropiane	33 605	20,29%	4
		<i>Levica-E majta</i>	13 404	8,09%	1
		Lëvizja - ZNAM	9 426	5,69%	1
Dalja	60,22%				
NjZ 4	278 721	Koalicioni Maqedonia Jote	96 551	56,67%	13
		Koalicioni Për të Ardhmen Evropiane	41 965	24,63%	5
		<i>Levica-E majta</i>	12 428	7,29%	1
		Lëvizja - ZNAM	8 416	4,94%	1
Dalja	61,13%				
NjZ 5	310 216	Koalicioni Maqedonia Jote	74 287	45,37%	10
		Koalicioni Për të Ardhmen Evropiane	26 668	16,29%	3
		Koalicioni Fronti Evropian	27 278	16,66%	4
		Koalicioni VLEN	10 793	6,59%	1
		Levica-E majta	9 850	6,02%	1
		Lëvizja - ZNAM	8 671	5,30%	1
Dalja	52,79%				

		Koalicioni Maqedonia Jote	21 639	15,90%	3
NjZ 6	317 109	Koalicioni Për të Ardhmen Evropiane	6 414	4,71%	1
		Koalicioni Fronti Evropian	53 731	39,48%	8
		Koalicioni VLEN	47 849	35,16%	8
Dalja	42,92%				

Mbrojtja e të drejtës zgjedhore

Kodi zgjedhor e garanton mbrojtjen e të drejtës zgjedhore. Sipas kodit zgjedhor, çdo parashtrues i listës së kandidatëve dhe çdo zgjedhës ka të drejtë të parashtrojë kundërshtim në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve nëse konsideron se e drejta e tij është shkelur. Kundërshtimet nga parashtruesit e listave mund t'i referohen procedurës së votimit, përmbledhjes dhe vërtetimit të rezultateve, ndërsa zgjedhësit mund të parashtrojnë kundërshtim nëse në procedurë u është shkelur e drejta zgjedhore. Procedura e udhëhequr për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore është urgjente, për ç 'shkak dorëzimi i kundërshtimit dhe i padisë në këtë rast nuk mund të dorëzohet me postë.

Kundërshtimet që parashtruesit e listave i dorëzojnë në KSHZ duhet t'i dorëzojnë në afat prej 48 orëve pas mbarimit të votimit, gjegjësisht pas shpalljes së rezultateve të para, ndërsa KSHZ obligohet në afat prej 48 orëve pas pranimit të kundërshtimit të marrë vendim. Për vendimin që e ka marrë KSHZ-ja e njofton parashtruesin e kundërshtimit me anë të postës elektronike, ndërsa vendimi konsiderohet i dorëzuar në afat prej pesë orëve nga dërgesa e shkresës elektronike. Parashtruesi i kundërshtimit, për të cilin është marrë aktvendim negativ në suaza të KSHZ-së, ka të drejtë në afat prej 24 orëve pas pranimit të aktvendimit të parashtrojë padi në Gjykatën administrative. Gjyqi duhet të sjellë vendim në afat prej 48 orëve pas pranimit të padisë. Gjykata administrative mund ta vërtetojë ose ta ndryshojë vendimin e KSHZ-së, me ç 'gjë vendimet e tij janë të plotfuqishme, gjegjësisht kundër tyre nuk mund të parashtrohet ankesë apo masë ligjore tjetër.¹⁴²

Në rast të shkeljes së të drejtës zgjedhore të zgjedhësit, ai mund të parashtrojë kundërshtim në KSHZ në afat prej 24 orëve, ndërsa KSHZ-ja është e obliguar të marrë vendim në afat prej 4 orëve pas pranimit të kundërshtimit. Vendimi i KSHZ-

142 Doracak për zgjedhjet presidenciale në Republikën e Maqedonisë 2019, botim i dytë i plotësuar. KAS dhe IDSCS, v. 2019. F. 61-62. Qasur në: https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2019/07/Belegexemplar_2019_The_Republic_of_Macedonia_s_2019_Presidential_Elections_Handbook_MKD.pdf (vizita e fundit: 4 qershor 2024)

së mund të ankimohej, kështu që në afat prej 24 orëve pas pranimit të aktvendimit do të dorëzohet padi në Gjykatën administrative. Nëse rrjedhin afatet dhe hasen ato gjatë procesit të votimit, ndërsa vendimi për zgjedhësin është pozitiv, atij do t'i mundësohet që ta realizojë të drejtën e vet të votës.¹⁴³

Në konkluzionet preliminare, Misioni vëzhgues ndërkombëtar i OSBE-së, zgjedhjet i vlerësoi si konkurruese dhe demokratike, por nënvizoi retorikën negative dhe sloganet nacionaliste si prishës të periudhës së qetë parazgjedhore. Po kështu, Misioni vëren se autoritetet, të personifikuara në KSHZ dhe në Gjykatën kushtetuese, jo çdo herë në mënyrë adekuate dhe transparente i zgjidhin kundërshtimet në lidhje me zgjedhjet, me çka kufizohet efektiviteti i ndihmës ligjore.¹⁴⁴

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, në ditën e zgjedhjeve, pranoi 490 kundërshtime¹⁴⁵ lidhur me regjistrimin e votuesve. Prej tyre, 283 janë zgjidhur plotësisht deri në mbylljen e vendvotimeve, 199 janë marrë parasysh, 68 janë refuzuar, ndërsa 16 janë shënuar si të pavlefshme. Pothuajse gjysma (195) e kundërshtimeve të parashtruara mbetën të pazgjidhura. Misioni vëzhgues theksoi mungesën e transparencës gjatë marrjes së vendimeve të KSHZ-së, për arsye se asnjë prej vendimeve nuk u shpall publikisht.¹⁴⁶

Për dallim nga Zgjedhjet presidenciale, për të cilat në rrethin e parë ishte parashtruar një kundërshtim, ndërsa në rrethin e dytë asnjë për shkeljen e procedurës së votimit, për Zgjedhjet parlamentare në KSHZ ishin dorëzuar madje 27 kundërshtime, para së gjithash nga partitë e bllokut opozitar. Koalicioni VLEN parashtroi dhjetë kundërshtime, Koalicioni „Maqedonia Jote“ i paraprirë nga VMRO-DPMNE tetë, Koalicioni „Për të ardhmen evropiane“ i paraprirë nga LSDM pesë gjithsej dhe partia politike „Levica“ katër kundërshtime.¹⁴⁷

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi gjashtë kundërshtime të parashtruara nga Koalicioni „Maqedonia Jote“ për vendvotimet 1272 në Komunën e Ohrit, 1194 dhe 1202 në Komunën e Krushevës, 1844 në Komunën e Strugës dhe vendvotimet 1470 dhe 1470/1 në Komunën e Dollnenit. Nga dhjetë kundërshtimet e parashtruara nga Koalicioni „Vlen“, KSHZ miratoi vetëm një kundërshtim që i përket vendvotimit 2101

143 Ibid.

144 OSBE, Misioni vëzhgues ndërkombëtar për zgjedhjet – Republika e Maqedonisë së Veriut – Zgjedhjet parlamentare dhe rrethi i dytë i zgjedhjeve presidenciale, 8 maj 2024. Qasur në: <https://www.osce.org/files/f/documents/f/8/568321.pdf> (vizita e fundit: 4 qershor 2024)

145 Duhet marrë parasysh se një pjesë e numrit të përgjithshëm të kundërshtimeve në ditën e votimit nuk janë vetëm për zgjedhjet parlamentare, por edhe për rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve nuk ka shpallur statistikë të saktë sa prej tyre janë në fakt për zgjedhjet parlamentare.

146 Ibid.

147 Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve – Zgjedhjet parlamentare 2024, Kundërshtime. Qasur në: <https://www.sec.mk/parlamentarni-izbori-2024/#tab-id-13> (vizita e fundit: 4 qershor 2024)

në Komunën e Zhelinës, në Njësinë zgjedhore 6.¹⁴⁸

Të pakënaqur nga vendimet, Koalicioni „Fronti Evropian“ shfrytëzoi të drejtën e garantuar dhe ankimoi vendimet e Komisionit në Gjykatën administrative, e cila mandej i refuzoi si të pabaza duke e vërtetuar vendimin e anëtarëve të KSHZ-së me çka anulohet i tërë procesi zgjedhor në vendvotimet e përmendura. Për arsye se numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në këto vendvotime, në nivelin e NjZ 5 dhe NjZ 6, mund të ndikonte në rezultatet e përgjithshme për zgjedhjen e deputetëve në Kuvend, përsëritja e procedurës zgjedhore në këto shtatë vende u përsërit në ditën e 14-të nga dita e votimit.¹⁴⁹ Variacioni në vota pas përsëritjes së procedurës zgjedhore në Njësinë zgjedhore 5 nuk solli ndryshime në numrin e mandateve kuvendare të partive. Por, rivotimi në vendvotimin 2101 në Zhelinë i barazoi mandatet e të dy koalicioneve - VLEN dhe Fronti Evropian në NjZ 6 në me nga tetë, me atë që rivotimi i solli VLEN-it një mandat plus në llogari të deputetit të nëntë të Koalicionit Fronti Evropian.¹⁵⁰

Vlerësimi i zgjedhjeve nga vëzhguesit

Për ndjekjen e zgjedhjeve parlamentare dhe rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale më 8 maj u akredituan gjithsej 1303 vëzhgues vendorë, 775 vëzhgues të huaj, 85 përkthyes, si dhe 83 gazetarë të huaj.¹⁵¹ Në këto zgjedhje numër më të madh të vëzhguesve nga organizatat vendore kishte Shoqata për zhvillimin e novacioneve shoqërore-sociale „UAKE UP“, me 966 vëzhgues. Fondacioni i romëve për demokraci kishte gjithsej 162 vëzhgues, ndërsa CIVIL-i – Qendra për liri kishte 82 vëzhgues. Organizatat tjera me vëzhgues të akredituar ishin Qendra për hulumtime të sigurisë me 46 vëzhgues, Instituti për strategji ekonomike dhe marrëdhënie ndërkombëtare – 20 vëzhgues, Qendra Kombëtare Rome – Kumanovë – 14 vëzhgues, Shoqata për promovimin dhe zhvillimin e shoqërisë gjithëpërfshirëse - Inkluziva Kumanovë – 12 vëzhgues dhe Qendra maqedonase për zhvillim kulturor – 1 vëzhgues. Në raport me zgjedhjet parlamentare në vitin 2020 të cilat u vëzhguan nga 2 551 vëzhgues vendorë, 102 vëzhgues të huaj, 56 përkthyes dhe 60 gazetarë të huaj, në këto zgjedhje numri i vëzhguesve vendorë është më i ulët, por është rritur numri i vëzhguesve

148 Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve – Zgjedhjet parlamentare – Aktvendime për përsëritjen e votimit. Qasur në: <https://www.sec.mk/parlamentarni-izbori-2024/#tab-id-12> (vizita e fundit: 5 qershor 2024)

149 Ibid.

150 Klijnčarovski, Petar. „BDI në minus, Vlen në plus mandat deputeti“, Radio Evropa e Lirë. Qasur në: <https://www.slobodnaevropa.mk/a/izbori-dui-vlen/32959660.html> (vizita e fundit: 5 qershor 2024)

151 Tabela e vëzhguesve të akredituar për Zgjedhjet për Deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 8.5.2024 <https://www.sec.mk/parlamentarni-izbori-2024/#av-tab-section-1-4-link> vizita e fundit 22.6.2024)

të huaj dhe gazetarëve të huaj.¹⁵² Rritja e interesit nga jashtë është kryesisht për faktin se zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale u mbajtën në të njëjtën kohë.

Nga misionet vëzhguese të huaja numër më të madh kishte OSBE/ODIHR-ja – misioni special për vlerësimin e zgjedhjeve me 411 vëzhgues, 14 ekspertë dhe 31 përkthyes, ndërsa Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës – komisioni ad-hok për vëzhgimin e zgjedhjeve presidenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut kishte 33 vëzhgues dhe 20 përkthyes.

Zgjedhjet i vëzhguan edhe Parlamenti Evropian, Instituti Demokratik Kombëtar i Punëve të Jashtme, Uashington SHBA – filiali Republika e Maqedonisë së Veriut, Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES), Iniciativa për dialog dhe demokraci Silba, Delegacioni EZAP – Kosovë, Qendra për zhvillimin e sistemeve zgjedhore, reforma dhe trajnime (qendër trajnimi) e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Gjeorgjisë, Qendra për trajnime të vazhdueshme në zgjedhje, Moldavi dhe Shoqata evropiane për dialog dhe demokraci– Bergen, Norvegji.

Ambasada e SHBA-së i vëzhgoi zgjedhjet me 69 vëzhgues, ndërsa me numër më të vogël vëzhguesish zgjedhjet i vëzhguan edhe ambasada e Holandës, e Hungarisë, e Shqipërisë dhe e Sllovakisë. Si plotësim, vëzhguesit e vet në zgjedhje i kishin edhe Komisionet Shtetërore të Zgjedhjeve të Kosovës, të Malit të Zi dhe të Ukrainës.

Procesin zgjedhor e ndoqën gjithsej 83 gazetarë të huaj të mediave rajonale dhe ndërkombëtare si dhe agjencitë e lajmeve, përkatësisht: Al Xhezira Ballkan, TRT Ballkan, TV N1 Serbi, Radio Televizioni Austriak, Televizioni Kombëtar Bullgar, Përva TV Serbi, Televizioni ZDR Gjermani, Televizioni ADR Gjermani, Klan Kosovë, Radio Televizioni i Kosovës, TRT (Shërbimi Publik i Republikës së Turqisë), TV IMEDI, Euronjuz Serbi, Euronjuz Shqipëri, Top Kanali (Top Channel) Shqipëri - seksioni i Kosovës, Agjencia e lajmeve Frans Pres, Agjencia e lajmeve Rojters, Asoshiejt Pres, Zyra Ballkani Perëndimor – Agjencia Frans Pres, ABC Njuz Shqipëri, Agjencia e informimit Kosova Pres, Shërbimi në shqip i Zërit të Amerikës, Agjencia Bullgare e Lajmeve, Zëri i Amerikës – redaksia maqedonase dhe Agjencia Evropiane Pres Foto – EPA.

Në raportin e tij preliminar¹⁵³ të vëzhgimit Misioni OSBE/ODIHR konkludoi se zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të mbajtura më 8 maj ishin konkurruese

152 Doracak për zgjedhjet presidenciale 2020 <https://idscs.org.mk/mk/2020/07/09/%d0%bf%d1%80%d0%b8%d1%80%d0%b0%d1%87%d0%bd%d0%b8%d0%ba-%d0%b7%d0%b0-%d0%bf%d0%b0%d1%80%d0%bb%d0%b0%d0%bc%d0%b5%d0%bd%d1%82%d0%b0%d1%80%d0%bd%d0%b8-%d0%b8%d0%b7%d0%b1%d0%be%d1%80%d0%b8-2020/> (vizita e fundit 22.6.2024)

153 Maqedoni e Veriut, Zgjedhjet parlamentare dhe zgjedhjet presidenciale – Rrethi i dytë, 8 maj 2024: Deklaratë nga gjetjet preliminare dhe konkluzionet - <https://www.osce.org/odihr/elections/north-macedonia/568270> (vizita e fundit 22.06.2024)

dhe liritë themelore u respektuan, edhe pse procesi mbetet i rregulluar në mënyrë të pamjaftueshme. Në këtë kontekst, në raport theksohet se legjislacioni zgjedhor siguron kornizë adekuate për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike, por jokonsekuenca e vazhdueshme, boshllëqet dhe dykuptimësitë e rrezikuan sigurinë juridike dhe kërkojnë revizionim. Shtrirja e gjithanshme dhe e thellë e fushatës në media u dha mundësi votuesve për të bërë zgjedhje të informuar, por retorika negative dhe sloganet nacionaliste prishën periudhën përndryshe të qëndrueshme parazgjedhore.

Transparenca dhe llogaridhënia e financimit të fushatave ishin dobësuar nga shkak i detyrimeve minimale për njoftim financiar dhe kapacitetit të kufizuar të organeve mbikëqyrëse, duke përfshirë edhe detyrimet për ndjekjen e shpërdorimit të burimeve administrative.

Lidhur me zbatimin e procesit zgjedhor, OSBE-ODIHR vlerësuan se autoritetet, përfshirë këtu Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Gjykatën administrative, jo gjithmonë i zgjidhën në mënyrë të përshtatshme dhe transparente kundërshtimet lidhur me zgjedhjet, me çka kufizuan efektivitetin e ndihmës ligjore. Si plotësim, theksohet se zgjedhjet u organizuan në mënyrë efektive, por pohimet e shpeshta për blerje votash në periudhën parazgjedhore para votimit ndikuan në besimin në proces. Në vendvotimet e vëzhguara, procesi i votimit ishte i rregullt, transparent dhe i vlerësuar pozitivisht, por, në disa raste, këshillat zgjedhorë nuk iu përmbajtën plotësisht procedurave të përcaktuara gjatë numërimit të votave.

Lidhur me kornizën ligjore që vendos bazën për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike, OSBE/ODIHR vlerëson se disa dispozita nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, ndërsa jokonsekuencat e vazhdueshme, boshllëqet dhe formulimet e dykuptimshme rrënojnë sigurinë juridike dhe duhet t'i nënshtrohen revizionimit të mëtejshëm. Vërehet me keqardhje se Kodi zgjedhor u ndryshua në mënyrë të drejtpërdrejtë para zgjedhjeve në procedurë të përshpejtuar dhe jomjaftueshëm transparente dhe pa pasur konsultime me publikun, gjë që nuk është në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe me angazhimet e OSBE-së. Megjithatë ndryshimet përfshinin disa nga rekomandimet e mëparshme të ODIHR-së dhe propozimet teknike të KSHZ-së, ato në masë të madhe nuk morën parasysh rekomandimet e grupit punues ndërinstitucional përgjegjës për reformat zgjedhore. Një sërë rekomandimesh kryesore të ODIHR-së dhe Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës mbetën të pazgjidhura, duke përfshirë edhe ato për rishikimin sistematik të Kodit zgjedhor, për sigurimin e qasjes së barabartë në media në fushatat zgjedhore dhe për rritjen e llogaridhënies dhe financimit të fushatës.

Lidhur me aktivitetet e Administratës zgjedhore, raporti vlerëson se i respektoi të gjitha afatet ligjore dhe gëzoi besimin e publikut nga pikëpamja e kapacitetit të saj

teknik. Gjatë periudhës parazgjedhore, KSHZ-ja mbajti seanca të rregullta të cilat ishin të hapura për publikun dhe u emetuan në internet, por nuk dha njoftime të vazhdueshme publike për seancat, kurse ndonjëherë i lajmëroi edhe më pak se një orë para fillimit.

Për listën zgjedhore vërehet se ekzistojnë mangësi në sistemet për regjistrimin e adresave të vendbanimit dhe për regjistrimin e popullatës, të cilat e zvogëlojnë saktësinë e të dhënave, ndërsa theksohet edhe se rekomandimet e mëparshme të ODIHR-së për përditësimin dhe revizionin e këtyre bazave të të dhënave nuk janë zbatuar.

Në lidhje me barazinë gjinore vlerësohet se të gjitha listat e regjistruara të kandidatëve i përmbushën kërkesat nga pikëpamja e përfaqësimit gjinor, konform kornizës ligjore e cila imponon përfaqësimin e së paku 40 përqind nga të dy gjinitë në çdo listë kandidatësh. Megjithatë, përmendet se edhe pse gratë përbënin 43 % nga të gjithë kandidatët për deputetë, ato shpeshherë u vendosën në pozitat më të ulëta të lejuara me ligj, gratë kandidate ishin bartëse të vetëm 25 përqind nga listat, ndërsa partitë politike me përjashtimin e dukshëm të një gruaje kandidate presidenciale, kishin pak gra folëse në ngjarjet e fushatës dhe çështjet lidhur me barazinë gjinore në masë të madhe munguan në diskursin e fushatës.

Në lidhje me fushatat, misioni vlerëson se ishin konkurreuese, ndërsa liritë themelore u respektovan. Megjithatë, misioni vlerëson se rregullimi i qasjes në hapësirat për zbatimin e fushatës, mediat dhe financimin e partive politike, u dhanë epërsi katër partive politike më të mëdha parlamentare në raport me kandidatët e tjerë.

Sipas vëzhguesve, temat kryesore në fushatën parlamentare dhe në fushatën për rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale ishte ekonomia, veprimtaritë për luftën kundër korrupsionit, anëtarësimi në Bashkimin Evropian (BE) dhe ndryshimet kushtetuese. Lidhur me tonin e fushatës, përfshirë edhe në internet, konstatohet se bëhej gjithnjë e më negativ para rrethit të parë të zgjedhjeve presidenciale dhe mbeti i tillë edhe në fushatën për zgjedhjet presidenciale para rrethit të dytë, si dhe për fushatën për zgjedhjet parlamentare. Partitë e shqiptarëve etnikë spikatnin dukshëm në fushatë. Megjithatë, përfaqësuesit e disa partive të pakicave etnike shprehën brengosje se shpërndarja e mjeteve shtetërore për fushatë sipas formulës së bazuar në përfaqësimin e partive në Kuvend pengoi aftësinë e tyre e të bërit fushatë në baza të barabarta.

Në raport theksohet se formula për shpërndarjen e mjeteve shtetërore për fushatë i vuri në pozicion më të pafavorshëm partitë më të vogla dhe jashtëparlamentare.

Vetëm 11 nga 17 pjesëmarrësit në zgjedhjet parlamentare parashtruan raporte të ndërmjetme për financimin e fushatës me kohë dhe në formatin e duhur. Kërkesat e njoftimit për raportet e ndërmjetme nuk përfshinin kërkesë për sigurimin e informacionit të detajuar për të ardhurat dhe nuk kërkonin njoftim për shpenzimet, kështu që në atë mënyrë është zvogëluar transparencja dhe llogaridhënia. Në këtë kontekst theksohet se kërkesat minimale për njoftim për financimin e fushatës, mangësitë dhe jokonsekuenca e kornizës ligjore, si dhe burimet e kufizuara dhe kapacitetet e organeve mbikëqyrëse, përfshirë edhe për ndjekjen dhe pengimin e shpërdorimit të burimeve administrative, zvogëluan ndjeshëm transparencën dhe llogaridhënien.

OSBE/ODIHR vlerëson se mjedisi mediatik është në përgjithësi i lirë. Monitorimi i mediave nga misioni vëzhgues për zgjedhjet (MVZ) i ODIHR-së tregoi se shërbimi radiodifuziv publik përfshiu pjesëmarrësit më të mëdhenj në garën parlamentare dhe presidenciale në pajtim me formulën për ndarjen e kohës së partive politike në zgjedhje, që i privilegjon partitë më të mëdha parlamentare. Lidhur me mediat private përmendet se në përgjithësi prezantuan informacion adekuat për të gjithë kandidatët, me ç'rast disa kanale televizive favorizuan lista të caktuara kandidatësh.

Me fjalë të tjera, misioni konstaton se kishte disa debate televizive në të cilat morën pjesë kandidatë nga koalicionet e mëdha të zgjedhjeve parlamentare, si dhe tre debate ndërmjet dy kandidatëve në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, që kontribuoi në mundësinë për të bërë votuesit zgjedhje të informuar. Theksohet nevoja e reformave të mëtejme në sektorin mediatik që të përmirësohet qëndrueshmëria e medias, të rregullohen mediat onlajn dhe të harmonizohet më tej korniza ligjore me legjislacionin e BE-së.

Lidhur me kornizën ligjore, OSBE/ODIHR vlerëson se nuk siguron qasje në mbrojtjen juridike në masë të mjaftueshme. Përkatësisht, në praktikë, KSHZ nuk siguroi ndihmë ligjore efikase për kundërshtimet e parashtruara në ditën e zgjedhjeve më 24 prill, duke lënë afërsisht gjysmën e tyre të pazgjidhura deri në mbylljen e vendvotimeve. Më tej, në pjesën më të madhe të vendimeve të saj për kundërshtimet të cilat kishin qasje për shqyrtim nga vëzhguesit, nuk është dhënë sqarimi, ndërsa shumë vendime u referoheshin akteve juridike të vjetërsuara dhe ndihmave ligjore joadekuate për ankesa. Gjykata administrative i respektoi afatet e shkurtra për vendimmarrje për ankesat. Gjykata kushtetuese nuk i shqyrtoi me kohë dy parashtrësit e pranuar lidhur me zgjedhjet, duke studiuar dhe hedhur poshtë njëjën prej tyre qyshkur dispozitat e kontestuara ishin zbatuar tashmë, ndërsa për të dytën ende nuk ishte marrë vendimi para ditës së zgjedhjeve më 8 maj, që gjykata ia referoi mungesës së afateve të përshpejtuara për shqyrtim nga Gjykata kushtetuese.

Dita e zgjedhjeve në raport është vlerësuar përgjithësisht e qetë dhe paqësore. Vëzhguesit i vlerësuan pozitivisht procedurat e votimit në shumicën dërrmuese të 1.340 vendvotimeve të vëzhguara, me masa mbrojtëse procedurale siç është identifikimi i votuesve, vulosja e fletëvotimeve nga OZ-të dhe nënshkrimi i listave zgjedhore në përputhje me dispozitat ligjore pothuajse në të gjitha vendvotimet. Megjithatë, në raport theksohet se u vërejtën disa raste të votimit grupor dhe familjar, ndërsa në disa raste, edhe pse kjo nuk është në kundërshtim me ligjin, u vërejt edhe mbajtja e evidencës për votuesit që kanë votuar. Vëzhguesit theksojnë se gati se në gjysmën e vendvotimeve nuk u respektua kërkesa ligjore që OZ-të t'i informojnë votuesit për procedurat e votimit, që është e rëndësishme për zvogëlimin e numrit të fletëvotimeve të pavlefshme. Në 16 nga 106 vendvotime të vëzhguara procesi i numërimit është vlerësuar si negativ, para së gjithash për shkak të gabimeve procedurale dhe lëshimeve për procedurat e numërimit dhe në masat e rëndësishme mbrojtëse, që në disa raste ndikuan në transparencë.

Megjithatë, përmbledhja e rezultatit në përgjithësi vlerësohet si efikase, por ceket se hapësira e kufizuar dhe tejmbushja kufizuan transparencën në disa raste, ndërsa në tre nga katër vëzhgime u vërejtën gabime ose mospërputhje në procesverbalet për rezultatet e vendvotimeve të vëzhguara.

Nga vëzhguesit vendorë, Shoqata e qytetarëve CIVIL – Qendra për liri në vlerësimin preliminar të monitorimit afatshkurtër që përfshin heshtjen zgjedhore dhe ditën e votimit, thekson se Zgjedhjet parlamentare të mbajtura më 8 maj kaluan në atmosferë të qetë dhe demokratike, pa incidente dhe pa parregullsi domethënëse. Në atë kontekst ceket se qytetarët dhe qytetarët me të drejtë vote kishin mundësi ta shprehin lirshëm vullnetin e tyre politik, në përputhje me Kodin zgjedhor dhe me parimet demokratike dhe standardet.¹⁵⁴

Megjithatë, duke pasur parasysh parimin Zero tolerancë për parregullsitë zgjedhore që CIVIL-i i ndjek në monitorimin e tij, shënohen disa lloje parregullsish që u vërejtën më 8 maj. CIVIL-i shënon se ato raste, të regjistruara në ditën e votimit, nuk ndikuan ndjeshëm në vlerësimin e përgjithshëm që është pozitiv.

Sipas CIVIL-it, hije në ditën e zgjedhjeve hodhën disa raporte që kanë të bëjnë me ngjarjet në vendvotime, duke vlerësuar se një pjesë e anëtarëve të këshillave zgjedhorë të mbarë vendit nuk kanë trajnim të mjaftueshëm sepse përmbushin agjenda politike, përmes agjitimit dhe ndikimit mbi një pjesë të votuesve. Më tej ceket se

¹⁵⁴ Deralla: Dita e zgjedhjeve kaloi në atmosferë të qetë dhe demokratike, por me më shumë lloje të parregullsive <https://civilmedia.mk/derala-izborniot-den-mina-vo-mirna-i-demokratska-atmosfera-no-so-poveke-vidovi-naneregularnosti/> (vizita e fundit 22.6.2024)

pavarësisht nga cili tabor politik janë angazhuar, disa anëtarë të këshilla zgjedhorë në vendvotimet e përfshira nga vëzhguesit e CIVIL-it, e mbështetën ose u përpoqën ta pengojnë bojkotin e Zgjedhjeve presidenciale. Gjithashtu, shënohen edhe raste të prishjes së heshtjes zgjedhore dhe shkeljes së sekretit të votës, ndërsa në një nga rastet, shënohet mosveprimi lidhur me prishjen e heshtjes zgjedhore nga vëzhguesit, partiakë ose qytetarë.

CIVIL-i thekson edhe informimin e pamjaftueshëm të qytetareve dhe qytetarëve për procedurën e votimit për president edhe për Kuvend, veçanërisht të forcuar me mosnjohjen e procedurave edhe nga këshillat zgjedhorë. Në atë kontekst ceket se rreth 50 thirrje nga qytetarët dhe qytetarët kishin të bëjnë me atë se nuk ishte e qartë vallë OZ-të kanë të drejtë që t'i pyesin votuesit se a do të marrin një apo dy fletëvotime. CIVIL-i konkludon se ky është një sinjal se procedurat dhe të drejtat zgjedhore nuk janë shpjeguar mjaft mirë në periudhën përgatitore, gjegjësisht në fushatën e KSHZ-së për edukim qytetar.

Përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Zhosep Borel dhe Komisionari evropian për zgjerim dhe politikë fqinjësore, Oliver Varhei, në deklaratën e përbashkët konstatojnë se sipas gjetjeve dhe konkluzioneve preliminare të Zyrës për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut të OSBE-së (ODIHR-së), zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare që u mbajtën më 8 maj u zhvilluan në atmosferë paqësore dhe demokratike. Zgjedhjet ishin konkurruese dhe u respektuan liritë themelore, por bëjnë të ditur se procesi zgjedhor edhe më tej mbetet i rregulluar në mënyrë të pamjaftueshme.¹⁵⁵

Vlerësimi i zgjedhjeve nga partitë politike

Partitë politike dolën me qëndrime të ndryshme rreth zbatimit të zgjedhjeve dhe vijimit të votimit. Një pjesë e partive vlerësuan se dita e zgjedhjeve kaloi qetësisht dhe në mënyrë të ndershme e demokratike, ndërkaq të tjerat akuzuan për një sërë parregullsish zgjedhore, ndër të cilat pengesa në votim, presione politike dhe inxhiniering zgjedhor. Pas numërimit të votave, rezultatet fillestare treguan se numër më të madh të mandateve kuvendare ka marrë koalicioni i paraprirë nga VMRO-DPMNE me 58 mandate. Pas tij janë Koalicioni i paraprirë nga LSDM dhe „Fronti Evropian” i paraprirë nga BDI me nga 18 mandate. Viojnë Koalicioni „Vlen” me 14, partia „Levica”

155 Ndryshimet kushtetuese përfunduan si rebus në deklaratën e Borelit dhe Varheit pas zgjedhjeve në Maqedoninë e Veriut <https://360stepeni.mk/ustavnite-izmeni-zavrshija-kako-rebus-vo-izjavata-na-borel-i-varheji-po-izborite-vo-s-makedonija/> (vizita e fundit 3.7.2024)

dhe Lëvizja „ZNAM – Për Maqedoninë Tonë“ me nga gjashtë mandate të fituara. Pas shpalljes së rezultateve, kryesitë e partive i ndanë përshtypjet e tyre në konferencat për shtyp, ndërsa një pjesë e tyre edhe festuan me anëtarësinë partiake dhe me simpatizantët. Në reagimet, krahas shpalljes së fitoreve dhe pranimit të humbjeve, ishte i pranishëm edhe rivaliteti mes partive, të cilat rezultatin dhe mandatet e fituara i interpretuan në lidhje me partitë të cilat i konsiderojnë kundërshtarë të tyre politikë.

Timço Muncunski, nënkryetari i VMRO-DPMNE-së, vlerësoi se zgjedhjet e dyfishta në përgjithësi kaluan në atmosferë të qetë, por janë shënuar edhe disa parregullsi. Një nga akuzimet më serioze për shkelje zgjedhore të cilat i parashtroi partia është se disa funksionarë të partisë qeveritare e kanë shkelur të drejtën zgjedhore të qytetarëve përmes ryshfetit dhe presioneve.¹⁵⁶ Pas shpalljes së rezultateve fillestare të zgjedhjeve, anëtarët dhe simpatizantët e VMRO-DPMNE-së kremtuan fitoren e dyfishtë para shtabit qendror në Shkup. Kryesia e partisë mbajti konferencë për shtyp ku e shpalli fitoren në zgjedhjet parlamentare dhe fitoren e kandidatës Gordana Siljanovska Davkova në zgjedhjet presidenciale. Kryetari i partisë, Hristian Mickoski, falënderoi votuesit dhe tregoi se qëllimi i VMRO-DPMNE-së është që populli të krenohet me shtetin i cili do të jetë i fuqishëm ekonomikisht dhe do të promovojë bashkëjetesën. Mickoski e bëri të ditur edhe se është koha që LSDM dhe BDI të shkojnë në opozitë, dhe deklaroi se populli në këto zgjedhje vendosi kundër krimit, korrupsionit, vlerave të rreme, shtetit të robëruar, tenderëve të kurdisur dhe nepotizmit. Ai theksoi edhe se duhet të ketë përgjegjësi për krimin dhe korrupsionin e kryer. Gjithashtu, Mickoski lajmëroi se shumë shpejt do të fillojnë negociatat me koalicionin VLEN me qëllim të formimit të qeverisë së re, por edhe se planifikon të bisedojë me kryesinë e lëvizjes ZNAM dhe partinë politike „Levica“, por kjo nuk do të thotë se do të jenë pjesë e qeverisë së re.¹⁵⁷

Shtabi zgjedhor i LSDM-së deklaroi se zgjedhjet ishin të drejta dhe demokratike. Ishin konstatuar parregullsi të caktuara, por jodomethënëse. Nga partia falënderuan qytetarët të cilët votuan duke thënë se treguan kapacitet demokratik, si dhe falënderuan institucionet të cilat treguan maturi për zbatimin e zgjedhjeve demokratike, të qeta dhe të denja.¹⁵⁸ Kryetari i partisë, Dimitar Kovačevski, mundësisë së zbatimit të zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike, në përputhje me standartet evropiane, ia atribuoi atmosferës së qëndrueshme politike të cilën LSDM si parti

156 „Mucunski: Presim rezultate ende më të mira se në rrethin e parë.“ Brif, 8.5.2024. Qasur në: <https://www.brif.mk/mucunski-ochekuvame-ushte-podobri-rezultati-od-prviot-krug/> (vizita e fundit: 3.6.2024)

157 „Hristijan Mickoski: Maqedonia fitoi, LSDM dhe BDI shkojnë në opozitë.“ TV Telma, 8.5.2024. Qasur në: <https://telma.com.mk/2024/05/08/hristijan-miczkoski-makedonija-pobedi-sdsm-i-dui-odat-vo-opozicija/> (vizita e fundit: 3.6.2024)

158 „Ditë zgjedhore e denjë dhe e suksesshme, zgjedhjet ishin të drejta dhe demokratikë“. LSDM, 8.5.2024. Qasur në: <https://sds.org.mk/pres-konferencii/84392> (vizita e fundit: 3.6.2024)

në pushtet e ka vendosur vitet e kaluara. Pas njoftimit të rezultateve, Kovaçevski e pranoi humbjen dhe dha zotim se LSDM do të jetë opozitë e përgjegjshme, parimore dhe shtetërore. Kovaçevski ia uroi fitoren VMRO-DPMNE-së dhe Gordana Siljanovska Davkovës. Ai shtoi se rezultati është dëshpërues për LSDM-në dhe për këtë gjë në periudhën e ardhme partia duhet të punojë në kthimin e besimit të qytetarëve. Në këtë drejtim, Kovaçevski lajmëroi zgjedhje brendapartiake në të gjitha organet partiake në nivelin qendror dhe lokal, duke filluar nga kryetari, udhëheqësia, e deri te organet tjera të partisë. Krahas kësaj, ai lajmëroi edhe rindërtimin e matricës ideologjike dhe të vlerave të partisë.¹⁵⁹ Pas shpalljes së rezultateve zgjedhore, një nga nënkryetarët e LSDM-së, Fatmir Bytyqi, paraqiti dorëheqjen nga funksioni partiak, duke vënë në dukje se dorëheqja do të ketë efekt të plotë kur edhe anëtarët e tjerë të kryesisë partiake do ta bëjnë të njëjtën. Bytyqi shtoi edhe se dorëheqja e kryesisë është një hap i domosdoshëm i rikthimit të besimit të qytetarëve dhe arritjes së suksesit politik, dhe është akt i shprehjes së përgjegjësisë personale dhe politike – diçka që për të cilën thotë se synon tërë karrierën e tij.¹⁶⁰

Lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, në konferencën për shtyp e shpalli koalicionin „Fronti Evropian“ fitues, duke thënë se në këto zgjedhje ata kanë garuar me VMRO-DPMNE-në. Ahmeti ia uroi fitoren Hristijan Mickovskit dhe VMRO-DPMNE-së, duke theksuar se pa marrë parasysh se me cilin do të negociojë VMRO-DPMNE-ja, përfaqësues i vetëm legjitim i shqiptarëve etnikë është „Fronti Evropian“, i cili shënoi fitoren ndaj opozitës shqiptare. Gjithashtu, Ahmeti i vlerësoi zgjedhjet si të drejta dhe demokratike dhe theksoi se sot, më tepër se kurrë, shtetit i duhet stabilitet, paqe, sundim të ligjit dhe anëtarësim në Bashkimin Evropian.¹⁶¹ Pas mbarimit të zgjedhjeve dhe afatit për parashtrimin e kundërshtimeve, shefi i shtabit zgjedhor të BDI-së, Arbër Ademi, akuzoi se disa parti të caktuara politike përpiqen që të bëjnë inxhiniering zgjedhor me qëllim që t’u merren mandatet Frontit Evropian. Ademi deklaroi se partitë, përmes marrëveshjeve joparimore dhe shkeljes së vullnetit të qytetarëve parashtruan kundërshtime që t’u marrin dy mandate Frontit Evropian në njësinë e pestë dhe të gjashtë zgjedhore, edhe përkundër asaj se nuk u konstatuan parregullsi gjatë votimit në këtë njësi zgjedhore. Ademi akuzoi se kundërshtimet u parashtruan në mënyrë tendencioze në vendet ku parashtruesi ka marrë më tepër vota

159 „Kovaçevski:LSDM dhe koalicioni do të jenë opozitë e përgjegjshme, e fuqjshme, parimore dhe shtetërore, procesi i rindërtimit të brendshëm duhet të jetë në të gjitha nivelet.“ LSDM, 8.5.2024. Qasur në: <https://sdsd.org.mk/pres-konferencii/84398> (vizita e fundit 3.6.2024).

160 „Bytyqi: Vendosa të paraqes dorëheqjen nga funksioni i nënkryetarit të partisë.“ Kanal 5 TV, 8.5.2024. Qasur në: <https://kanal5.com.mk/bitikji-odluchiv-da-podnesam-ostavka-od-funkcijata-potpredsdatel-na-partijata/a639283> (vizita e fundit 3.6.2024).

161 „Ali Ahmeti njoftoi nga Reçica e Vogël: Kundërshtari ynë ishte VMRO-DPMNE“. Plus Info, 8.5.2024. Qasur në: <https://plusinfo.mk/ali-ahmeti-se-oglas-i-od-mala-rechica-nash-protivnik-beshe-vmro-dpmne/> (vizita e fundit 3.6.2024).

me qëllim të marrjes së më shumë mandateve.¹⁶²

Mbështetësit e koalicionit „Vlen“, pas shpalljes së rezultateve zgjedhore kremtuan në sheshin e Tetovës. Lideri i Besës dhe kryetari i Tetovës, Bilall Kasami, para shtabit zgjedhor të koalicionit Vlen në Tetovë deklaroi se „Vlen“ është fitues te shqiptarët etnikë, ndërsa rezultatin e këtillë ia atribuoi ardhjes së mërgimtarëve të cilët votuan në zgjedhjet. Kasami theksoi se „Vlen“ është fitues absolut në të gjitha komunat me popullsi me shumicë shqiptare dhe se pret numër përfundimtar deputetësh njëjtë si rivalët e tyre politikë „Fronti Evropian“. Gjithashtu, Kasami njoftoi se që nga dita e nesërme do të fillojnë negociatat për koalicionin e ri qeveritar të përbërë nga VMRO-DPMNE dhe VLEN.¹⁶³

Shtabi zgjedhor i partisë politike „Levica“ pas mbylljes së vendotimeve akuzoi për parregullsi gjatë votimit. Parregullsitë e shënuara përfshijnë pamundësinë e realizimit të së drejtës zgjedhore të grupeve të rrezikuara të qytetarëve, prania e materialit promovues në vendvotime, si dhe votim i penguar. Gjithashtu, nga partia akuzuan edhe për presione ndaj aktivistëve të tyre nga strukturat e pushtetit aktual, por edhe nga partia më e madhe opozitare. Zëdhënësi i „Levicës“, Amar Mecinoviç, akuzoi se VMRO-DPMNE gënjeu në mënyrë eklatante se „Levica“ po bën thirrje për bojkotimin e zgjedhjeve.¹⁶⁴ Kryetari i „Levicës“, Dimitar Apasiev, pas shpalljes së rezultateve, deklaroi se „Levica“ e arriti qëllimin e saj në këto zgjedhje, ndërkaq ky është pasokizimi i LSDM-së dhe rrëzimi i borgjezisë së kuqe. Si fitoren e dytë domethënëse në këto zgjedhje, Apasievi e theksoi faktin që votat e fituara për lëvizjen e sapoformuar ZNAM pothuajse janë përgjysmuar, krahasuar me rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale. Gjithashtu, Apasiev hodhi vështrim edhe mbi sistemin zgjedhor, duke deklaruar se me këtë sistem „Levica“ humbi deputetë, sepse edhe pse në disa njësi zgjedhore Levica prin me vota para lëvizjes ZNAM, ata kanë fituar të njëjtin numër deputetësh.¹⁶⁵

162 „Fronti evropian akuzoi se ka përpjekje për inxhiniering zgjedhor që t’iu merren dy mandate deputetësh“. Puls24, 11.5.2024. Qasur në: <https://puls24.mk/европски-фронт-обвини-дека-има-оби/> (vizita e fundit 3.6.2024).

163 „Kasami: Prej nesër fillojnë negociatat për qeverinë e re ndërmjet VMRO-DPMNE-së dhe Koalicionit VLEN“. 360 Shkallë, 8.5.2024. Qasur në: <https://360stepeni.mk/kasami-od-utre-pochnuvaat-pregovorite-za-nova-vlada-megu-vmro-dpmne-i-koalitsijata-vredi/> (vizita e fundit 3.6.2024).

164 „Levica: Kishte parregullsi, tren bullgar, presione të pushtetit aktual dhe kërcënime për shkarkim pas zgjedhjeve nga opozita“. Točka, 8.5.2024. Qasur në: <https://tocka.com.mk/vesti/481080/levica-imase-neregularnosti-bugarski-voz-pritisoci-od-segasnata-vlast-i-zakani-za-otpustanje-po-izborite-od-opozicijata> (vizita e fundit 3.6.2024).

165 „Apasiev: I pret ferri në Kuvend, kemi gjashtë deputetë të sigurt, luftojmë për të shtatin“. 360 Shkallë, 8.5.2024. Qasur në: <https://360stepeni.mk/apasiev-gi-cheka-pekol-vo-sobrانيето-imame-sigurni-shest-pratenika-se-borime-za-sedmiot/> (vizita e fundit 3.6.2024).

Nga Lëvizja ZNAM deklaruan se e kanë shkruar historinë, duke thënë se këto zgjedhje do të jenë mësim për të gjitha subjektet politike. Lideri i ZNAM-it, Maksim Dimitrievski, u zotua për realizimin e premtimeve të fushatës zgjedhore dhe për të punuar në interesin e qytetarëve. Dimitrievski ua uroi fitoren VMRO-DPMNE-së dhe Gordana Siljanovska Davkovës¹⁶⁶ dhe tha se ZNAM-i do të shqyrtojë opsionet e koalicionimit me partitë tjera dhe do të jetë në dispozicion të çdo qeverie të ardhshme në interes të interesave kombëtare.¹⁶⁷

Konkluzione

Zgjedhjet e njëmbëdhjeta parlamentare nga pavarësia e shtetit, të cilat u mbajtën më 8 maj 2024, në ditën e njëjtë me rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, kaluan në atmosferë të ndershme dhe demokratike, pa incidente dhe parregullsi domethënëse. Në zgjedhjet parlamentare fitore të bindshme korri partia më e madhe opozitare VMRO-DPMNE dhe koalicioni me 58 mandate deputetësh të fituara. Pas fitores, u bë e qartë se lideri i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski, do të bëhet kryeministri i ri dhe do ta kryesojë qeverinë e re, e cila do të bazohet në tre postulate: eurointegrimet, zhvillimin e përshpejtuar ekonomik, luftën kundër krimit dhe korrupsionit dhe sundimin e ligjit. LSDM dhe koalicioni pësuan disfatë historike me 18 mandate të fituara, që paraqet rezultatin e tyre më të dobët deri më tani, për ç'gjë lideri i partisë Dimitar Kovaçevski dhe e tërë kryesia paraqitën dorëheqjet, për ç'gjë filluan procedurat brendapartiake për zgjedhjen e presidentit të ri. Më 30 qershor u mbajtën zgjedhjet e jashtëzakonshme brendapartiake dhe për kryetar të ri të LSDM-së u zgjodh ministri i mëparshëm i shëndetësisë dhe deputeti aktual, Venko Filipçe.¹⁶⁸ Në bllokun shqiptar, koalicioni Fronti evropian i paraprirë nga BDI fitoi 18 deputetë, ndërsa blloku opozitar shqiptar VLEN fitoi 14 deputetë. Rezultat të dukshëm korri edhe partia e re politike „ZNAM“ me 6 mandate deputetësh të fituara, si dhe partia „Levica“ e cila fitoi 6 mandate deputetësh, ndërsa në përbërjen e kaluar parlamentare kishte 2 deputetë.

166 „Dimitrievski: Konfirmuam grup parlamentar, do të jemi me qytetarët dhe do të punojmë për ta“. Veçer, 8.5.2024. Qasur në: <https://www.vecer.press/dimitrievski-potvrdivme-minimum-pratenichka-grupa/> (vizita e fundit 3.6.2024).

167 „Dimitrievski: Do t'i shqyrtoj opsionet më tej për koalicionim të mundshëm eventual me pushtetin“. Brif, 9.5.2024. Qasur në: <https://www.brif.mk/dimitrievski-dopolnitelno-ke-gi-razgledame-opciite-za-eventualno-mozhno-koalicirane-so-vlasta/> (vizita e fundit 3.6.2024).

168 Venko Filipçe u zgjodh kryetar i LSDM-së <https://sds.org.mk/pres-konferencii/85209> (vizita e fundit 2.7.2024)

Sipas raporteve të parashtruara financiare¹⁶⁹, më së shumti mjete financiare në fushatën zgjedhore ka shpenzuar koalicioni i paraprirë nga VMRO-DPMNE, gjegjësisht 143 253 905 denarë (2 329 332 euro). Koalicioni i paraprirë nga LSDM është në vendin e dytë me gjithsej 98 160 901 denarë të shpenzuara (1 596 112 euro). Vijnë koalicioni i paraprirë nga BDI, i cili shpenzoi gjithsej 58 899 636 denarë (957 717 euro). Partia „Levica” për këto zgjedhje shpenzoi gjithsej 15 752 857 denarë (256 144 euro), ndërsa Lëvizja ZNAM për fushatën zgjedhore shpenzoi gjithsej 499 023 denarë (8 114 euro). Koalicioni i paraprirë nga partia GROM mbledhi dhe shpenzoi gjithsej 8 738 486 denarë (142 089 euro), partia Demokratët shpenzoi 1 989 786 denarë (32 354 euro), Rodina Maqedoni shpenzoi 1 179 114 denarë (19 173 euro), Partia Jote shpenzoi 1 069 025 denarë (17 383 euro), ndërsa Partia punëtore shpenzoi 565 420,30 denarë (9 194 euro).

Lidhur me zgjedhjet presidenciale, nga VMRO-DPMNE përgëzuan mbarë popullin maqedonas për regjistrimin e arritur dhe vlerësuan se bojkoti i rrethit të dytë të zgjedhjeve presidenciale nga BDI ishte i pasuksesshëm. Me ç’rast, VMRO-DPMNE shprehu mirënjohjen për besimin e madh dhe mirënjohjen për atë që më 8 maj vendosi populli i cili dërgoi të vetmin mesazh se është koha për një kapitull të ri. Njëkohësisht, vlerësuan se dita e zgjedhjeve kaloi në atmosferë përgjithësisht të qetë, por edhe cekën se janë vërejtur disa parregullsi të veçuara të cilat duhen të zbardhen në periudhën e ardhshme. Përkatësisht, disa funksionarë të partisë së atëhershme në pushtet u kapën në veprimtari të paligjshme duke shkelur drejtën zgjedhore, duke bërë ryshfet dhe presione të cilët vetëm e kanë treguar karakterin jodemokratik të qeverisjes së pushtetit që u mund.¹⁷⁰

Nga LSDM zgjedhjet i vlerësuan si të ndershme dhe demokratike, me parregullsi jodomethënse, ndërsa qytetarët shprehën lirshëm vullnetin e tyre në ditën e zgjedhjeve të denja, të qeta dhe të suksesshme. Qytetarët treguan kapacitet demokratik, ndërsa institucionet treguan maturi që kontribuan për zgjedhje të lira, demokratike, të qeta dhe të denja.¹⁷¹

BDI në emër të Frontit evropian vlerësoi se procesi i zgjedhjeve është zhvilluar qetë dhe pa incidente, ndërsa i dënuan përpjekjet e opozitës që me lajme të rreme të

169 Përmbledhja për mjetet e shpenzuara në fushatën zgjedhore është bërë në bazë të raporteve financiare vetëm për ato parti politike të cilat i parashtruan në organet përkatëse shtetërore përfundimisht me datën 7 gusht të vitit 2024.

170 Mucunski: Është koha për kapitull të ri, elitat e pushtetit u mundën nga populli <https://vmro-dpmne.org.mk/%d0%bf%d1%80%d0%b5%d1%81-%d0%ba%d0%be%d0%bd%d1%84%d0%b5%d1%80%d0%b5%d0%bd%d1%86%d0%b8%d0%b8/%d0%bc%d1%83%d1%86%d1%83%d0%bd%d1%81%d0%ba%d0%b8-%d0%b2%d1%80%d0%b5%d0%bc%d0%b5-%d0%b5-%d0%b7%d0%b0-%d0%bd%d0%be%d0%b2%d0%be-%d0%bf%d0%be%d0%b3%d0%bb%d0%b0%d0%b2%d1%98%d0%b5-%d0%b5%d0%bb%d0%b8%d1%82> (vizita e fundit 22.06.2024)

171 Ditë zgjedhore e denjë dhe e suksesshme, zgjedhjet ishin të ndershme dhe demokratike <https://sds.org.mk/pres-konferencii/84392> (vizita e fundit 22.6.2024)

krijojë panik dhe frikë. Lidhur me vërejtjet për bojkotimin e zgjedhjeve presidenciale, nga BDI theksuan se Fronti evropian i la mbështetësit vetë të vendosin nëse do të votojnë për zgjedhjen e presidentit të shtetit dhe se sipas numrave për daljen vërehet dalje më e vogël në zgjedhjet presidenciale në raport me zgjedhjet parlamentare, por ajo nuk ishte vendimtare.¹⁷²

Nga Vlen e dënuan ashpër përpjekjen e BDI-së për bojkotimin e procesit zgjedhor dhe vlerësuan se ata janë faktori i ri politik i cili në mënyrë të denjë i përfaqëson interesat e shqiptarëve. Për ditën e zgjedhjeve vlerësuan se nuk ishte demokratike, duke pasur parasysh atë se institucionet shtetërore të cilat kishin detyrë që të garantojnë procesin përsëri u vunë në shërbimin e BDI-së, ndërsa në terren, veçanërisht në vendvotime, u vërejtën zëvendësministra, ministra, drejtorë dhe funksionarë të tjerë partiakë dhe prania e tyre ishte dokumentuar, për ç'gjë do të informohen përfaqësuesit ndërkombëtarë dhe misionet vëzhguese në vend.¹⁷³

Nga ZNAM-i theksuan se qytetarët treguan se janë shtetformues dhe me sigurimin e regjistrimit të nevojshëm për zgjedhjen e presidentit, nuk lejuan të ballafaqohet shteti me krizë institucionale. Njëkohësisht, shprehën kënaqësi që arritën gjatë fushatës t'i prezantojnë të gjitha masat e programit të tyre zgjedhor dhe falënderuan të gjithë qytetarët e vendit të cilët dolën në zgjedhje dhe votuan për ZNAM-in.¹⁷⁴

Nga „Levica” shprehën kënaqësinë e rezultateve zgjedhore, por drejtuan kritika për modelin zgjedhor duke konsideruar se numri i përgjithshëm i votave të fituara nuk është valorizuar në mandate deputetësh, gjegjësisht edhe pse kanë korrur numër më të madh votash nga ZNAM-i do të kenë numër identik deputetësh. Në atë kontekst, nga „Levica” njoftuan se një nga kërkesat e para do të jetë vendosja e një njësie zgjedhore në tërë territorin e shtetit.¹⁷⁵

Ministri i Punëve të Brendshme, Pançe Toshkovski, vlerësoi se janë mbajtur ndoshta zgjedhjet më të qeta dhe më demokratike që kanë ndodhur kurdoherë në vend, veçanërisht nga aspekti i sigurisë, duke theksuar se nuk u konstatuan shkelje më

172 Ademi: BDI i la mbështetësit vetë të vendosin nëse do të votojnë për zgjedhjet presidenciale <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32938586.html> (vizita e fundit 22.6.2024)

173 Vlen-i është faktori i ri politik i cili do t'i përfaqësojë interesat e shqiptarëve, porositi Mexhiti. <https://novamakedonija.com.mk/makedonija/politika/vredi-e-noviot-politichki-faktor-koj-kje-gi-zastapuva-interesite-na-albancite-poracha-medjiti/> (vizita e fundit 22.6.2024)

174 Memov: Qytetarët treguan se janë shtetformues, e zgjodhën presidentin e tyre të ri <https://telma.com.mk/2024/05/08/memov-graganite-pokazhaa-deka-se-drzhavotvorni-i-go-izbraa-svojot-nov-pretsedatel/> (vizita e fundit 22.6.2024)

175 Apasiev: LSDM-në e pasokizuam, ZNAM-in e përgjysmuam, ndërsa DPMNE-në e pret ferri në Kuvend <https://mkd.mk/apasiev-sdsm-go-pasokiziravme-znam-go-prepolovivme-a-dpmne-go-checka-pekol-vo-sobraniето/> (vizita e fundit 3.7.2024)

serioze të procesit zgjedhor gjatë tërë ditës së djeshme.¹⁷⁶

Misioni vëzhgues ndërkombëtar OSBE/ODIHR vlerësoi se procesi zgjedhor për zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale ishte konkurrues, u respektuan liritë themelore, edhe pse procesi mbetet i rregulluar në mënyrë të pamjaftueshme. Vërejtjet kryesore kanë të bëjnë me Kodin zgjedhor. Sipas misionit zgjedhjet u zbatuan mirë, nëse merret parasysh sfida për organizimin e dy zgjedhjeve të ndryshme në të njëjtën kohë.¹⁷⁷

Gjatë periudhës parazgjedhore partitë politike dhe koalicionet kishin mundësi t'i prezantojnë lirshëm programet e veta dhe të organizojnë takime me votuesit. Fushata zyrtare zgjedhore për zgjedhjet parlamentare filloi më 18 prill dhe mbaroi më 6 maj, me çka u përputh me periudhën e fushatës parazgjedhore që filloi më 4 prill. Partitë politike, si dhe kandidatët për deputetë dhe presidentë, mbajtën mitingje të mëdha, takime me qytetarët, agjituan derë më derë dhe shpërndanë fletushka, posterë, bilborde dhe përmbajtje digjitale. Temat dominuese të fushatës ishin ekonomia, lufta kundër korrupsionit, integritet evropiane dhe ndryshimet kushtetuese, energjetika, ndërsa ishin të pranishme edhe temat lokale lidhur me infrastrukturën. Fushatat zgjedhore u orientuan në përgjithësi në promovimin pozitiv të kandidatëve, ndërsa ishte e pranishme edhe retorika negative dhe polarizimi politik që vinte duke u forcuar veçanërisht pas rrethit të parë zgjedhor presidencial, rezultati i të cilit duke reflektuar disponimin e votuesve paralajmëroi në masë të madhe rezultatet zgjedhore përfundimtare.

Për rezultatet zgjedhore të zgjedhjeve parlamentare u parashtruan gjithsej 27 kundërshtime – nëntë nga koalicioni „Vlen“, tetë nga VMRO-DPMNE, pesë nga LSDM dhe katër nga Levica. KSHZ në seancën e 13 majit miratoi 7 kundërshtime. Një nga kundërshtimet ishte nga koalicioni Vlen, ndërsa gjashtë të tjerat ishin të koalicionit „Maqedonia Jote“ i paraprirë nga VMRO-DPMNE. Për një nga këto vendvotime parashtroi kundërshtim edhe Koalicioni „Për të Ardhmen Evropiane“ i paraprirë nga LSDM që do të thotë se për vendvotimin e njëjtë reagueshan ty dy koalicionet. Kundërshtimet e pranuar kishin të bëjnë me vendvotime të caktuara, gjegjësisht në njësinë zgjedhore 5 dhe 6. Koalicioni Fronti Evropian i paraprirë nga BDI akuzoi për inxhiniering zgjedhor dhe reagoi se oponentët e tjerë politikë përmes presionit

176 Toshkovski: Këto ishin ndoshta zgjedhjet më të qeta dhe më demokratike që kanë ndodhur kurdoherë <https://makfax.com.mk/makedonija/%D1%82%D0%BE%D1%88%D0%BA%D0%BE%D0%B2%D1%81%D0%BA%D0%B8-%D0%BE%D0%B2%D0%B0-%D0%B1%D0%B5%D0%B0-%D0%BC%D0%BE%D0%B6%D0%B5%D0%B1%D0%B8-%D0%BD%D0%B0%D1%98%D0%BC%D0%B8%D1%80%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%B8/> (vizita e fundit 22.6.2024)

177 Vlerësimi pozitiv preliminar i OSBE/ODIHR-së për ditën e djeshme të zgjedhjeve, vërejtje për ndryshimet e shpejta të Kodit zgjedhor <https://360stepeni.mk/preliminarna-pozitivna-otsenka-od-obse-odih-r-za-vcherashniot-izborenden-zabeleshka-za-brzite-izmeni-na-izborniot-zakonik/> (vizita e fundit 22.6.2024)

politik dhe kundërshtimeve në KSHZ pikërisht në këto njësi zgjedhore dëshirojnë t'u marrin deputetë.¹⁷⁸

Duke pasur parasysh pritjet se BDI pas 22 vjetësh do të shkojë në opozitë, në periudhën paszgjedhore mori hov retorika e tyre politike duke konsideruar se në pajtim me rezultatet zgjedhore ata janë përfaqësuesit legjitim të shqiptarëve në shtet dhe lajmëruan aktivitete për parandalimin e mazhorizimit të ri, duke u bërë thirrje qytetarëve t'u bashkohen në përpjekjen e tyre për mbrojtjen e Marrëveshjes së Ohrit. Vlen-i i bëri apel BDI-së që të sillen si opozitë e përgjegjshme dhe për interesa të ngushta partiake dhe personale të mos i sakrifikojnë perspektivat evropiane të Maqedonisë së Veriut.¹⁷⁹

KSHZ më 18 maj njëzëri e miratoi propozimin që të përsëritet votimi në shtatë vendvotime, pas vendimeve të sjella nga Gjykata administrative. Votimi u mbajt të mërkurën, me datë 22 maj 2024. U rivotua në njësinë zgjedhore pesë në vendvotimet 1470/1 dhe 1470 në Komunën e Dollnenit, 1194 dhe 1202 në Komunën e Krushevës, 1844 në Komunën e Strugës dhe 1272 në Komunën e Ohrit, si dhe në njësinë zgjedhore gjashtë në vendvotimin 2101 në Komunën e Zhelinës.¹⁸⁰

Pas rivotimit më 22 maj në shtatë vendvotime në dy njësitë zgjedhore, BDI humbi një mandat deputeti në njësinë zgjedhore gjashtë, të cilin e mori koalicioni Vlen, ndërsa në njësinë e pestë zgjedhore situata me mandatet e deputetëve mbeti e pandryshuar.¹⁸¹

Më 30 maj, KSHZ-ja miratoi konkluzion për përfundimin e zgjedhjeve parlamentare. Në seancë u shpallën përfundimtare rezultatet e zgjedhjeve në njësinë e gjashtë zgjedhore, pasi që Gjykata administrative rrëzoi padinë e Frontit Evropian për rivotim në një vendvotim në fshatin Llarcë, Zhelinë.

Sipas rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, në përbërjen e re parlamentare hyjnë deputetë nga listat e gjashtë subjekteve politike që morën pjesë vetë ose në koalicion në zgjedhjet parlamentare, me lista të tyre në gjashtë njësitë zgjedhore.

178 KSHZ pranoi 7 nga 27 kundërshtime të parashtruara – një nga koalicioni „Vlen“ dhe gjashtë nga VMRO-DPMNE <https://24.mk/details/dik-prifati-7-od-27-podneseni-prigovori-eden-od-koalicija-vlen-i-shest-od-vmro-dpmne> (vizita e fundit 22.6.2024)

179 VMRO-DPMNE dhe VLEN: BDI të jetë një opozitë e përgjegjshme “ky është vullneti i shumicës” - <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32971004.html> (vizita e fundit 22.6.2024)

180 KSHZ: Rivotim në shtatë vendvotime më 22 maj <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32952869.html> - (vizita e fundit 22.6.2024)

181 BDI në minus, Vlen me plus mandat deputeti <https://www.slobodnaevropa.mk/a/izbori-dui-vlen/32959660.html> (vizita e fundit 22.6.2024)

Rezultatet përfundimtare të KSHZ-së: Koalicioni “Maqedonia Jote” VMRO-DPMNE fitoi 436.407 vota ose 43,36% nga numri i përgjithshëm i votave; Koalicioni „Për të Ardhmen Evropiane” – LSDM fitoi 154.447 vota ose 15,35% nga numri i përgjithshëm i votave; Koalicioni „Fronti Evropian” i paraprirë nga BDI fitoi 137.690 vota ose 13,68% nga numri i përgjithshëm i votave; Koalicioni VLEN fitoi 106.937 vota ose 10,63% nga numri i përgjithshëm i votave; partia politike „Levica” fitoi 68.637 vota ose 6,82% nga numri i përgjithshëm i votave, ndërsa Lëvizja ZNAM – Për Maqedoninë Tonë fitoi 56.232 vota ose 5,59% nga numri i përgjithshëm i votave. Shprehur në mandate deputetësh, në Kuvend Koalicioni „Maqedonia Jote” – VMRO-DPMNE ka 58 deputetë, koalicionet „Për të Ardhmen Evropiane” – LSDM dhe „Fronti Evropian” kanë me nga 18 deputetë, koalicioni „Vlen” ka 14 deputetë, ndërsa partitë „Levica” dhe ZNAM me nga 6 deputetë.¹⁸² Dalja në zgjedhjet parlamentare më 8 maj ishte 55,10%, që është përrreth 3% më e lartë nga zgjedhjet parlamentare që u mbajtën në vitin 2020.¹⁸³

Shumica e re parlamentare në Kuvend numëron 78 deputetë – 58 nga Koalicioni VMRO-DPMNE, 14 nga Vlen dhe 6 nga ZNAM.

Menjëherë pas shpalljes së rezultateve fillestare të zgjedhjeve, lideri i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski, paralajmëroi formimin e shpejtë të qeverisë së re reformuese së bashku me koalicionin VLEN, pas kësaj filluan negociatat ndërmjet partive. Në procesin e negociatave politike për formimin e qeverisë së re, u kyç edhe partia ZNAM. Negociatat vazhduan në mënyrë konstruktive dhe shumë shpejt u arrit marrëveshja, me të cilën VLEN-i mori pozitën e kryetarit të Kuvendit, që ishte një nga kërkesat kryesore të tyre, dhe gjashtë poste ministrore, ndërsa ZNAM-i mori dy poste ministrore. Të dyja palët marrin edhe poste drejtorësh dhe pozita të tjera drejtuese.

Mandatori Mickoski theksoi se koalicioni qeveritar i përbërë nga VMRO-DPMNE, koalicioni VLEN dhe ZNAM, u bashkua rreth katër shtyllave, përkatësisht luftës kundër korrupsionit dhe krimit, përmirësimit të standardit të qytetarëve, përshtetimit të procesit të integriteteve evropiane dhe zhvillimit të ekuilibruar.¹⁸⁴

Më 28 maj 2024 u mbajt seanca konstituive e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në të cilën u verifikuan mandatet e 118 deputetëve të sapozgjedhur dhe u verifikua përbërja e re të Kuvendit, konform Raportit të Komisionit verifikues.

182 Zgjedhjet parlamentare – rezultate <https://rezultati.sec.mk/mk/parl/r> (vizita e fundit 22.06.2024)

183 Zgjedhjet parlamentare – dalje <https://rezultati-prv.sec.mk/mk/parl/t6> (vizita e fundit 22.06.2024)

184 Mandatori pret një debat konstruktiv për zgjedhjen e Qeverisë së re, koalicioni është i bashkuar rreth katër shtyllave <https://novamakedonija.com.mk/makedonija/mandatarot-ochekuva-konstruktivna-debata-za-izbor-na-novata-vlada-koalicijata-e-obedineta-okolu-chetiri-stolba/> (vizita e fundit 22.6.2024)

Dy mandatet tjera u vërtetuan më tej. Me seancën konstituive kryesonte Merita Kolçi Kohxhaxhiku, si deputete më e moshuar në këtë përbërje parlamentare.

Afrim Gashi nga VLEN është kryetari i ri i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Me propozim të 75 deputetëve, Gashi u zgjodh në këtë funksion, pas verifikimit të mandatit të deputetëve nga përbërja e re e Kuvendit. Për zgjedhjen e Gashit kryetar të Dhomës Ligjvënëse votuan 76 deputetë, ndërsa gjashtë ishin “kundër”.

Pas zgjedhjes dhe dhënies së deklaratës solemne, Gashi falënderoi qytetarët për besimin në zgjedhjet parlamentare, e më pas edhe deputetët për mbështetjen për udhëheqjen e Dhomës Ligjvënëse.¹⁸⁵

Presidentja Gordana Siljanovska-Davkova më 6 qershor i ndau mandatin për formimin e Qeverisë liderit të VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoskit. Duke iu referuar rezultatit zgjedhor dhe shpërndarjes së forcave në Kuvend, presidentja tha se besimi i mandatit Mickoskit ishte një hap i vërtetë juridik dhe politik.¹⁸⁶

Me qëllim të realizimit efikas të programit parazgjedhor, dhe para formimit të Qeverisë së re, VMRO-DPMNE parashtrroi ndryshime dhe plotësime në Ligjin për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore. Më 8 qershor, me procedurë të shkurtuar, me 88 vota “pro” dhe 22 “kundër”, Kuvendi miratoi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore.

Shumica e dy të tretave të domosdoshme për miratimin e ndryshimeve të ligjit sistemor u sigurua pas takimit të përfaqësuesve të VMRO DPMNE-së dhe Frontit Evropian, të cilët njoftuan se arritën marrëveshje për mbështetje për ndryshimet, si dhe për formimin e komisionit ad-hok në Kuvend për përfaqësim të drejtë.¹⁸⁷ Në kuadër të takimit u diskutua edhe për dialogun e ndërsjellë mes qeverisë dhe opozitës, ku u pranua kërkesa e koalicionit të Frontit Evropian që Kuvendi në një kohë të afërt të formojë një komision ad-hok me Kryetar të propozuar nga opozita, e cila do të monitorojë përfaqësimin e drejtë të të gjitha bashkësive etnike në organet e administratës shtetërore dhe do ta informojë Kuvendin për punën e saj dy herë në vit.¹⁸⁸

185 Konstituohet përbërja e 11-të e Kuvendit, Afrim Gashi zgjidhet kryetar <https://www.sobranie.mk/ns-newsarticle-se-konstituira-11-sostav-na-sobranieto-afrim-gasi-izbran-za-pretsedatel.nspix> (vizita e fundit 22.6.2024)

186 Mandati të Mickoski, ministrat dhe shumica e dy të tretave të sigurt <https://www.slobodnaevropa.mk/a/mandatot-mickoski-ministri-premier/32980451.html> (vizita e fundit 22.06.2024)

187 U miratua ligji për riorganizimin e ministrive <https://www.dw.com/mk/usvoen-zakonot-za-reorganizacija-na-ministerstvata-namesto-16-ke-ima-20/a-69309528> (vizita e fundit 22.6.2024)

188 Fronti Evropian do të mbështesë riorganizimin e qeverisë, në këmbim do të marrë komisionin parlamentar ad-hok <https://fokus.mk/evropskiot-front-ke-ja-poddrzhi-reorganizatsijata-na-vladata-zavovrat-dobiva-sobraniska-ad-hok-komisija/> (Qasur së fundi 3.7.2024)

Sipas ndryshimeve ligjore formohen ministrinë e të reja dhe transformohen të vjetrat. Ministrinë për Ekonomi iu shtua segmenti punë, kurse e deritashmja Ministri për Punë dhe Politikë Sociale u bë Ministri për Politikë Sociale, Demografi dhe Rini. Agjencia për Rini dhe Sport nuk do të ekzistojë dhe u bë Ministri për Sport më vete. Një pjesë të kompetencave që ka pasur më parë Ministria e Ekonomisë në fushën e minierave dhe energjisë tani janë pjesë e kompetencave të Ministrisë për Energjetikë, Miniera dhe Lëndë Minerale, kompetencat për turizmin nga Ministria e Ekonomisë janë transferuar në Ministrinë e re për Kulturë dhe Turizëm. Ministria për Punë të Jashtme merr më shumë kompetenca ekonomike dhe do të jetë Ministri për Punë të Jashtme dhe Tregti të Jashtme. Ministria aktuale për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive do të jetë vetëm Ministri për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive. Gjithashtu, u krijua Ministria për Digjitalizim, e cila trashëgoi përgjegjësitë e Ministrisë së mëparshme të Teknologjisë Informative dhe Administratës, ndërsa është e re edhe Ministria për Administratë. Ndërsa, Sekretariati për Çështje Evropiane u zhvillua në Ministri për Çështje Evropiane.¹⁸⁹

Qeveria e re e propozuar nga Mickoski ka 24 anëtarë. Krahas kryeministrit, do të ketë edhe 23 zëvendëskryeministra dhe ministra, prej të cilëve 20 me portofol. Pesëmbëdhjetë anëtarë janë nga koalicioni i paraprirë nga VMRO-DPMNE, gjashtë nga koalicioni VLEN dhe dy nga ZNAM.

Me rastin e dorëzimit të propozimit në Kuvend, Mickoski tha se anëtarët e propozuar të Qeverisë janë të motivuar që menjëherë të arrijnë rezultate, të investojnë maksimalisht kapacitetin e tyre, sepse qytetarët kanë pritshmëri të mëdha. Mandatori tha se Qeveria do të bëjë një luftë të pakompromis kundër krimit dhe nuk do të ketë tolerancë ndaj askujt, pavarësisht se nga cila parti vjen keqpërdorimi. Ceku edhe se të rinjtë do të jenë në fokusin e punës së Qeverisë së re.¹⁹⁰

Me votimin e përbërjes së re qeveritare në Kuvend më 23 qershor të vitit 2024, Hristijan Mickovski u bë kryeministri i 13-të dhe kryeson qeverinë e 20-të nga pavarësia e shtetit.

189 Me mbështetjen e BDI-së, pas mesnate u votua riorganizimi i ministrive <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32984203.html> (vizita e fundit 3.7.2024)

190 Në Kuvend fillon seanca për zgjedhjen e qeverisë së re të kryesuar nga Hristijan Mickovski <https://telma.com.mk/2024/06/22/vo-sobranie-pochnuva-sedniczata-za-izbor-na-nova-vlada-predvodena-od-hristijan-miczkoski/> (vizita e fundit 22.6.2024)



6

**Arkivi zgjedhor i zgjedhjeve
në Republikën Maqedonisë
së Veriut nga viti
1990 e deri më sot**

6. Arkivi zgjedhor i zgjedhjeve në Republikën Maqedonisë së Veriut nga viti 1990 e deri më sot

Fondacioni Konrad Adenauer, zyra përfaqësuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe Instituti për demokraci „Societas Civilis“ – Shkup (IDSCS), që nga muaji mars i vitit 2016 janë duke e zbatuar projektin e përbashkët „Arkivi zgjedhor i zgjedhjeve në Maqedoninë e Veriut nga viti 1990 e deri më sot“. Qëllimi i projektit është monitorimi gjithëpërfshirës i proceseve zgjedhore në Republikën e Maqedonisë së Veriut duke filluar nga viti 1990 e deri më sot. Në kuadër të këtij projekti janë përfshirë të gjitha zgjedhjet e organizuara deri më tani, presidenciale, parlamentare dhe lokale, me ç'rast janë mbledhur në një vend të gjitha dokumentet e dhëna në dispozicion për proceset zgjedhore.

Nevoja e zbatimit të një projekti të këtillë rrjedh nga mospasja e një arkivi zyrtar shtetëror me të gjitha dokumentet dhe të dhënat për ciklet zgjedhore nga shpallja e pavarësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Arkivi zgjedhor i grupon dokumentet në shtatë seksione:

1. Dokumenti për shpalljen e zgjedhjeve
2. Lista zgjedhore
3. Listat e kandidatëve
4. Rezultatet e zgjedhjeve
5. Raporti i zgjedhjeve
6. Raportet e vëzhgimit të organizatave ndërkombëtare dhe vendore
7. Kodi zgjedhor

Paralelisht me organizimin e zgjedhjeve, Arkivi zgjedhor përditësohet dhe bashkëngjiten të gjitha dokumentet relevante në seksionet e lartpërmendura. Pjesë përbërëse e Arkivit zgjedhor janë edhe doracakët për zgjedhjet (presidenciale, parlamentare dhe lokale) të cilët përgatiten paralelisht me organizimin e zgjedhjeve, përkatësisht në bashkëpunim me Fondacionin Konrad Adenauer dhe Institutin për demokraci „Societas Civilis“ – Shkup.

Deri më tani janë përgatitur tetë doracakë, përkatësisht për zgjedhjet lokale të vitit 2013, 2017 dhe 2021, për zgjedhjet presidenciale të vitit 2014 dhe 2019 dhe për zgjedhjet parlamentare të vitit 2014, 2016 dhe 2020. Të gjithë doracakët janë në dispozicion në ueb faqen e Arkivit zgjedhor (izbornaarhiva.mk) në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze.

